

DITURIA ISLAME

REVISTË MUJORE FETARE, SHKENCORE E KULTURORE • Nr. 416 • KORRIK 2025



**HIXHRETI — UDHËTIMI
NGA SHTYPJA DREJT LIRISË**

LUFTA KUNDËR URISË

NËNA, HEROINA QË NUK PRET
ASGJË NË KËMBIM

KAUZA PËR ATDHEUN

URIMI I MYFTIUT TË KOSOVËS, NAIM EF. TËRNAVA, ME RASTIN E FESTËS SË KURBAN BAJRAMIT – 2025

Të dashur besimtarë,

Vëllezër dhe motra,

Paqja dhe mëshira e Zotit qoftë mbi ju dhe mbi familjet tuaja!

Në këtë natë të madhe të Kurban Bajramit, kur zemrat dridhen nga madhështia e sakrificës dhe kur shpirti kërkon edhe më shumë afërsinë me Zotin, ju drejtohem me përlulësi të thellë dhe dashuri të sinqertë në emër të Bashkësisë Islame të Republikës së Kosovës, në emër të institucioneve të saj dhe në emrin tim si Myfti i Republikës, për t'ju përcjellë për këtë festë kaq madhështore, festën e Kurban Bajramit, urimet më të përzemërta, duke e lutur Zotin e Madhërishtëm që kjo ditë e bekuar t'ju gjejë me zemra të qeta, me shëndet dhe mirëqenie, me familje të bashkuara dhe me besim të thelluar në vlerat më të larta shpirtërore.

Kurban Bajrami është përkujtim i sakrificës profetike të Ibrahimit a.s., i cili ishte i gatshëm që ta flijonte më të dashurin e tij për hir të Zotit të Madhërishtëm, dhe i cili na mësoi se besimi i vërtetë nuk njeh kufij dhe as frikë nga sprovat, por gjen kuptimin më të lartë pikërisht në dorëzimin e plotë ndaj vullnetit hyjnor të Zotit xh.sh..

Në këtë ditë, zemrat e besimtarëve mbushen me mirënjohje dhe përkushtim, ndërsa duart e tyre shtrihen në ndihmë dhe bujari, ngase kjo festë është një akt që mishëron frymën e afërsisë me Zotin dhe përgjegjësisë ndaj shoqërisë.

Me bindjen dhe nënshtrimin ndaj Zotit, flijimin, përkushtimin, solidaritetin dhe ndarjen me të varfrit, dashurinë dhe unitetin familjar dhe shoqëror për hir të dashurisë hyjnore, Zoti i Madhërishtëm thotë: "Andaj, falu (vetëm) për Zotin tënd dhe ther kurban!" (Kevther, 2).

Sot, kur miliona besimtarë janë në tokën e shenjtë të Mekës dhe ku do ta kalojnë këtë ditë në rrafshnaltën e Arafatit, e në mesin e tyre gjenden edhe haxhilerët nga Kosova, të cilët janë duke e përjetuar haxhin – udhëtimin e jetës me lutjet e tyre drejtuar Krijuesit për falje gabimesh, shëndet dhe mirëqenie për familjet e tyre, për popullin tonë dhe siguri për vatanin tonë.

Në përbushjen e kësaj thirrje hyjnore që zë fill që nga koha e Ibrahimit a.s., i cili na e kujton rrugëtimin e shpirtit në kërkim të pastrimit, përluljes dhe bashkimit me të gjithë myslimanët e botës në një akt universal adhurimi dhe barazie. Çdo hap i bërë në tokën e shenjtë, çdo lutje në Arafat, është një thirrje



për mëshirë dhe një betim për një jetë të ndershme, në shërbim të së drejtës dhe drejtësisë.

Zoti i Madhërishtëm thotë: "Nuk është gjynah të kërkonin nga Zoti juaj ndonjë të mirë. E, kur të ktheheni nga Arafati, përmendni Allahun në vendet e shenjta! Përmendni Atë që ju ka udhëzuar në rrugën e drejtë, sepse ju më parë ishit të humbur" (El Bekare, 199).

Të dashur qytetarë,

Vëllezër e motra!

Kurban Bajrami është një festë fetare, por megjithatë ajo bartë në vete edhe mesazhe të thella shoqërore dhe atdhetare. Festa e Bajramit nuk kufizohet vetëm në adhurim, por ajo kontribuon në forcimin e vlerave që ndërtojnë shoqërinë dhe e forcojnë atdheun. Prandaj themi se kjo festë forcon ndjenjën e bashkësisë dhe vëllazërisë ndërmjet nesh, e që është bazë për një shoqëri të shëndoshë dhe një shtet të qëndrueshëm.

Në këtë natë të kësaj feste të bekuar, nuk mund të mos ndalemi dhe të reflektojmë mbi sakrificat e popullit tonë, të cilat i përngjajnë sakrificës së Ibrahimit a.s.. Ne kemi njohur dhimbjen, kemi kaluar sprovat të rënda, kemi dhënë më të dashurit tanë për një të ardhme më të mirë dhe për një jetë me dinjitet dhe liri.

Përmes flijimit, durimit dhe besimit të palëkundur, populli ynë ka ngritur themelet e ekzistencës së vet mbi vlerat e sakrificës dhe të së drejtës.

Le ta ndërlidhim këtë festë të bekuar me kujtesën tonë kolektive dhe me përgjegjësinë që kemi për të jetuar me nder, për ta ruajtur lirinë që u arrit me mund dhe gjak, si dhe për të qenë gjithmonë zë i drejtësisë, i paqes dhe i vlerave hyjnore.

Në prag të çdo feste të risjellim në kujtesën tonë, të kaluarën tonë, të qëndrojmë me zemra të mbushura me mirënjohje dhe me krenari para sakrificës sonë, të kujtojmë ditët tona të flijimit dhe të sakrificës, kohërat tona të vuajtjes, vendet tona të flijimit, netët tona të lutjeve në errësirë, gjithëherë me shpresën në Zotin Një për lirinë dhe pavarësinë e vendit tonë.

Kjo natë është edhe përkujtim i përjetshëm i dëshmorëve tanë, i nënave që ende nuk gjetën eshtrat e bijve dhe bijave të tyre, i fëmijëve që u rritën pa përqaftimin e prindit, por me krenarinë se ata ishin pjesë e një sakrifice të shenjtë për liri. Sot, kur ne

therim kurbanin, e dimë se çdo pikë gjaku që rrjedh nga kurbanin është betim për të qenë më të drejtë, më të mëshirshëm dhe më të përkushtuar ndaj Zotit dhe ndaj njëri-tjetrit.

Bajrami nuk është thjesht vetëm një festë, është kulmi i besimit, i sakrificës dhe i mirësisë. Bajrami është urë që bashkon njerëzit me mëshirën e Allahut dhe me njëri-tjetrin në paqe dhe dashuri.

Në ditën e Bajramit, le t'i hapim dyert e zemrës, jo vetëm për të afërmit, por edhe për nevojtarët, të vetmuarit dhe të harruarit. Në këtë ditë të bekuar le t'i falim të tjerët ashtu siç dëshirojmë që të na falë Zoti ne.

Le të përqafojmë, ashtu siç shpresojmë që të na përqafojë mëshira dhe falja e Zotit të Madhërishtëm.

Le të jetë kjo festë një thirrje për më shumë mirësi ndër ne, për bashkim rreth vlerave që na mbajtën gjallë ndër shekuj, siç janë: besimi, dinjiteti, drejtësia dhe solidariteti.

Le ta shndërrojmë besimin në vepër, fjalën në shërbim, kujtimin në përgjegjësi, për të falur, për t'i afruar zemrat dhe për t'i përforcuar familjet dhe shoqërinë me dashuri, mëshirë, paqe dhe drejtësi. Kjo ngase, Zoti i Madhërishtëm nuk e ndryshon gjendjen e një populli, derisa ai popull të mos ta ndryshojë vetveten.

Zoti e ruajt popullin tonë dhe i faltë paqe dhe begati vendit tonë!

Me fat festa e Kurban Bajramin!

Myftiu Naim ef. Tërnavë

Prishtinë, më 5 qershor 2025

EDITORIAL

4 Hixhreti – udhëtimi nga shtypja drejt lirisë

5 “Sakrifica dhe nataliteti – garanci për të ardhmen”

Hytbeja e Myftiut me rastin e Kurban-Bajramit

FETARE

8 Singeriteti, ky munguar adhurim i

Hfz. Arif Emini

11 Modestia si virtyt me vlerë në jetën e besimtarit

Mr. Sead Paqarizi

14 Lufta kundër urisë

Dr. Jusuf el Kardavi

17 Një fjalë që ndryshoi gjithçka – një emër i shkruar një qiell

Bajram Zeqiri

21 Doracakët më të njohur të fikhut hanefi (7)

Hazir D. Selmani

24 MOSHA E MARTESËS

Hajrudin S. Muja

INTERVISTË

29 “Debati për shaminë në Evropë është shumë më tepër se një çështje lirie personale apo të drejtash fetare.”

Intervistë me Arlinda Amiti

FAMILJE & EDUKIM

33 Nëna – heroina që nuk pret asgjë në këmbim

MSc. Zamira Bushati – Puka

35 Kauza e dashurisë ndaj atdheut në paqe dhe në liri

Murtezan Idrizi

KULTURË

38 Specifikat e përkthimit të Kuranit nga h. Sherif Ahmeti

Dr. Azmir Jusufi

41 “Historia është regjistruese e ngjarjeve në kohë dhe transmetuese e tyre për brezat që do të vijnë.”

Prof. asoc. dr. Shkodran Imeraj

44 Mulla Fejzullah ef. Guri (1927–2013) – një jetë, një veprimtari, një trashëgimi

Blertona Kriva

48 Hani me dy porta

Artan Sadiku

50 Ebul-Kasim Halef b. Abbas el Zahravi – dijetari i madh i mjekësisë

Sead Ahmetaj

HISTORI & CIVILIZIM

53 Masakra e Srebrenicës e vitit 1995 në Bosnje e Hercegovinë në dritën e shtypit shqiptar në Kosovë (1)

Nuridin Ahmeti

57 Muhaxhirët – bartës të historisë dhe kulturës


Refik Gërbeshi

REPORTAZH

60 Haxhi - përjetime dhe emocione të paharrueshme të besimtarëve nga Kosova

AKTIVITETE

62 Besimtarët myslimanë festuan Kurban Bajramin



DITURIA ISLAME

Revistë mujore fetare,
shkencore e kulturore
Nr. 416• viti 39 • Korrik 2025
• Muharrem 1447
• Çmimi 1 €

Boton

Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës,
Prishtinë

Redaksia

Kryeredaktor: Mr. Driton Arifi
Anëtarë:
Dr. Ejup Haziri, Merita Boroci,
Mr. Muharrem Tërnavi,
Mr. Vedat Shabani.

Sekretar & lektor: Bajram Zeqiri
Redaktor artistik & teknik:
Bashkim Mehani

Adresa

"Dituria Islame",
rr. "Bajram Kelmendi", nr. 182,
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +384 38 224 024
E-mail: redaksia@dituriaislame.net
www.dituriaislame.net
Shtypi:
"Printing Press", Prishtinë.



“A nuk ishte e gjerë toka e Allahut e të migroni në të? (e ta praktikoni lirisht fenë e Zotit)...”.

(En Nisa, 97)

Hixhreti – udhëtimi nga shtypja drejt lirisë

Përderisa i Dërguari i Allahut, *paqja dhe shpëtimi i Zotit qofshin mbi të*, ndjeu barrën e rëndë të Shpalljes që posa kishte pranuar nga Zoti i tij, i shqetësuar shkoi për të gjetur pak ngushëllim te ‘miku’ i tij, Vereka ibën Neufeli. Ai ishte nga ata pak që ende kishin mbetur në “fenë monotesite”, në një rreth politeistësh, që kishin lajthitur skajshmërisht rrugën e vërtetë. Njihte shumë mirë edhe rrëfimet e pejgamberëve të mëhershëm dhe sigurisht se kishte diç për t’i thënë edhe Muhamedit a.s. në shqetësimin e tij të ri. Posa dëgjoi atë që i kishte ndodhur të Dërguarit të Zotit, Vereka i tha: “Ah sikur të isha i ri, dhe të isha gjallë kur populli yt do të të nxjerrë (nga vendi yt), do të kisha dalë krahë për të të ndihmuar!” Muhamedi a.s. me një pëshpëritje të mekur, krejt pafajësisht pyeti: “A vërtet do të më dëbojë populli im mua?!” Ai iu përgjigj: “Po! Nuk ka ardhur kurrë askush me atë që ti ke ardhur, përveçse është sulmuar nga populli i vet.” (Muslim, 160). Logjika ishte e thjeshtë, kushdo që ecën në të njëjtën rrugë, do të përjetojë gjithë vuajtjet që ka përjetuar secili që para tij eci në rrugën e tij. Nuk e ka gëzuar asnjëri privilegjin e luksit, ose i të qenit i kursyer nga ato vuajtje. E po, shpërngulja vërtet ndodhi 13 vjet më vonë, veçse aromën e saj të hidhur, Muhamedi a.s. e ndjeu qysh herët, madje ende pa e kuptuar në tërësi krejt peshën e misionit të tij.

Në një ambient ku qe ngrysur qielli i lirisë dhe ku ishte ngulfatur zëri i së vërtetës, vazhdimi i një misioni të dëlirë nga i Dërguari i Allahut, *paqja dhe shpëtimi i Zotit qofshin mbi të*, u bë i pamundur. Slogani i proklamuar kuranor: “*A nuk ishte e gjerë toka e Allahut e të migroni në të? (e ta praktikoni lirisht fenë e Zotit)...*” (En Nisa, 97), para se t’iu thuhej cilitdo besimtar që jeton në rrethana të vështira me fenë e tij, në të vërtetë disi do t’i thuhej vetë Muhamedit a.s. në Mekë, por edhe shokëve të tij. Ajo që duhej ruajtur ishte më e çmueshme e më e shenjtë se vetë shenjtëria e Mekës, ishte pra feja e Zotit të Madh. Andaj, ligjet e Zotit dhe premtimi i Tij për ta ndihmuar fenë e Tij, doemos kthejnë mbrapsht pa kursyer gjithë kurthet e pabesitë ndaj atij misioni të dëlirë. Andaj hixhreti s’mund të jetë ndryshe veçse “...nga bukuritë e Islamit, me të cilin u ruajt bastioni i fesë, u ndal derdhja e gjakut dhe u përhap thirrja.” (El Maverdi, Ahkam es Sultaniye, 24).

Kujtojeni një fakt se sa u përpëliti i Dërguari i Allahut, *paqja dhe shpëtimi i Zotit qofshin mbi të* dhe sa gjatë duroi atë dramë famëkeqe të shtypjes, abuzimit të sinkronizuar nga ata që ia vunë detyrë vetes eliminimin e tij dhe shkuljen me rrënjë të fesë së tij. Ai insistonte për të mos braktisur me asnjë çmim truallin e lindjes së tij. Atë truall që kishte qëlluar të ishte edhe vendi më i bekuar mbi faqen e dheut. Aty ishte ngritur faltorja e parë monoteiste në historinë njerëzore.

Fati i misionit të Muhamedit a.s. në atë moment historik ndërli dhej disi me vetë shpëtimin ose jo të tij. E donin atë të vdekur, paçka se do të fikej e do të përfundonte pastaj përjetësisht edhe misioni i tij. Duket se antagonistët nuk gjetën kohë të dëgjonin zërin kumbues të së vërtetës: “*Me të vërtetë, Zoti yt i pret ata në pusi (i përcjellë punët e tyre).*” (El Fexhr, 14). Andaj, periudhën e shtypjes së egër po e përmbyllte Muhamedi a.s., për të gjetur një oazë lirie ku feja e Zotit do të merrte frymë lirshëm e do të kalonte nga dobësia në fuqi. Kjo do të përbënte arsye të mjaftueshme që të kuptojmë se “hixhreti nuk ishte ikje, por planifikim për ndërtimin e një shteti, përgatitje për ngritjen e një ymeti dhe një mesazhi për tërë njerëzimin.” (J.Kardavi, *Fikh el Hixhreh*, 21).

Andaj asgjë nuk ishte aksidentale që Omeri r.a. në epokën e hilafetit të tij, por edhe shumica e sahabëve ranë dakord që fillimi i vitit islam të llogaritet nga hixhreti i Profetit a.s. nga Meka në Medine. Si të mos ishte fillim i një historie kur Islami, nga një thirrje individuale dhe e përndjekur, u shndërrua në një shtet që ishte i bazuar në rend e ligj. Për më tepër, u bë edhe ymet premtues për përndritje dhe udhëzim edhe i atyre që e sulmonin me mëri. Kjo ngjarje përbënte atë kthesën historike që misioni profetik, nga ideja kaloi në dinamikë dhe në realitet. Andaj, kjo ngjarje ishte edhe një fillim i ri.

Mr. Driton Arifi



Hytbeja e Myftiut të Kosovës, Naim ef. Tërnavë, me rastin e festës së Kurban Bajramit – 2025

“Sakrifica dhe nataliteti – garanci për të ardhmen”

***Të nderuar qytetarë,
Vëllezër dhe motra!***

Falënderimi i takon Zotit të botëve, i Cili na mundësoi që ta arrijmë këtë ditë të madhe feste, me shëndet, me zemër të pastruar dhe me shpresë të ripërtërirë për Kurban Bajram. Paqja dhe mëshira e Tij qofshin mbi të Dërguarin tonë, Muhamedin a.s., mbi familjen dhe shokët e tij, si dhe mbi të gjithë besimtarët që ndjekin rrugën e drejtë.

Festa e Kurban Bajramit është ditë gëzimi, por edhe reflektimi. Është ditë kur rikujtojmë mëshirën e Zotit, faljen dhe begatinë që Ai na dhuron. Është ditë kur ne si besimtarë, por edhe si shoqëri, i kthejmë sytë edhe më shumë drejt njëritjetrit me dhembshuri, solidaritet dhe përgjegjësi.

Kurban Bajrami është ditë e madhe, ditë adhurimi, sakrifice dhe solidariteti. Është kujtim i gjallë i sakrificës së madhe të pejgamberit Ibrahim a.s., i cili, me bindje të plotë ndaj urdhrit të Zotit, ishte i gatshëm që ta flijonte djalin e tij Ismailin a.s..

Në lidhje me këtë, Zoti në Kuran thotë:

كَذَلِكَ نَجْزِي الْمُحْسِنِينَ إِنَّهُ مِنْ عِبَادِنَا الْمُؤْمِنِينَ

“Ja, kështu, Ne i shpërblejmë punë mirë. Ai ka qenë vërtet një nga robërit Tanë besimtarë.” (Es Safat, 111).

Kur ata të dy, babë e bir, iu nënshtruan urdhrit të Zotit, Ai e zëvendësoi Ismailin a.s., me një kurban të madh. Zoti i Madhërisëm thotë:

إِنَّ هَذَا لَهُوَ آَبَلَاؤُا الْمُبِينُ وَقَدْ يَنْحُ عَظِيمُ

“Kjo, me të vërtetë ka qenë një sprovë e qartë! Dhe Ne e zëvendësuam atë (Ismailin) me një kurban të madh.” (Es Safat, 107)

Sot, ne jemi mbledhur në këtë xhami dhe në të gjitha xhamitë e tjera të vendit tonë të lirë, jo vetëm për t’u falur dhe festuar këtë ditë të madhe për besimtarët, ditë e cila bashkon sakrificën me përkushtimin, por edhe për të prekur një ndër vlerat më të thella të besimit islam, thellësitë më të ndritura të besimit tonë. Kjo është një ditë që nuk e kufizon gëzimin në formë, por e rrënjos në zemër – aty ku sakrifica, falja dhe devotshmëria bashkohen në një kulm të lartë shpirtëror, për ta jetësuar më të dashurën për hir të së vërtetës hyjnore.



Prandaj, për haxhin mund të themi se është një rikthim te burimi i jetës, një udhëtim kah vetja e thellë, kah ajo pjesë e shpirtit që përkulet para Zotit me përlulesi dhe ngrihet me dinjitet.

Është akti suprem i pastrimit shpirtëror dhe i besimit që shndërrohet në përjetësi. Andaj nuk ka gjë më të bukur sesa të jesh në vendin ku shpirti gjen qetësinë e përjetshme.

Sot, haxhilerët tanë të dashur, burra dhe gra nga Kosova dhe trojet e tjera shqiptare kthehen nga Arafati në Meken e shenjtë me ballin lart dhe zemrën e lehtësuar, ngase ata përfunduan edhe një obligim jetësor për Zotin xh.sh., duke e vendosur haxhin si një akt kulmor të pastrimit moral dhe shpirtëror.

Muhamedi, paqja dhe mëshira e Zotit qofshin mbi të, ka thënë:

الحج المبرور ليس له جزاء إلا الجنة

“Haxhi i pranuar nuk ka shpërblim tjetër përveçse Xhenetit.” (Buhariu dhe Muslimi).

Le të kumbojë ky Bajram si një thirrje e qartë për më shumë dashuri, për më shumë drejtësi dhe për më shumë unitet. Le të jetë një ditë që nuk mbetet vetëm kujtim solem, por një nxitje e gjallë për të jetuar me vlera, për të ndërtuar me besim dhe për të qëndruar me dinjitet, në emër të paqes, besimit dhe së mirës.

Të dashur qytetarë,

Kurban Bajrami na mëson se feja jonë kërkon sakrificë jo vetëm në aspektin material, por edhe në përpjekje për ta përmirësuar shoqërinë, për ta ruajtur atdheun, për ta forcuar familjen dhe për ta mbrojtur të ardhmen tonë.

Sakrifica që kërkohet prej nesh sot nuk është ajo e pejgamberit Ibrahim a.s., por është sakrifica për ta ruajtur moralin, kulturën, gjuhën dhe vetë ekzistencën tonë si komb. Sot sakrifica është që t'i qëndrojmë afër familjes, t'i edukojmë fëmijët në frymën e drejt fetare dhe kombëtare, si dhe të kontribuojmë për të ardhmen e vendit tonë.

Ne duhet ta mbrojmë Kosovën jo vetëm me fjalë, por me vepra konkrete, e njëra ndër to është edhe forcimi dhe edukimi i familjes si bërthamë e shoqërisë. Ne jemi vëllezër dhe motra mes vete, prandaj duhet të jemi mbështetje për njëri-tjetrin, veçanërisht për ata që kanë zgjedhur të kenë familje të madhe, sepse ata po e mbajnë gjallë kombin dhe besimin.

Në këto kohë, Kosova po përballet me një rënie serioze të natalitetit. Familjet e reja ngurrojnë të lindin më shumë se një apo dy fëmijë për arsye të ndryshme, shpesh ekonomike, por edhe për shkak të frikës dhe pasigurisë. Disa po migrojnë nga Kosova dhe vendet e tjera shqiptare, disa edhe në këtë kohë kur ne po flasim, në shtetet përreth nesh po asimilohen duke

e humbur gjuhën shqipe si gjuhë të nënës, dhe ne kemi ngelur vetëm si spektatorë pasivë.

Por le të kujtojmë se parimet e fesë sonë nxisin që ne të kemi familje të madhe dhe të mos frikësohemi për riskun e tyre, ngase atë e ka garantuar Krijuesi ynë.

Zoti i Madhërishëm në Kuran thotë:

﴿وَمَا مِنْ دَابَّةٍ فِي الْأَرْضِ إِلَّا عَلَى اللَّهِ رِزْقُهَا وَيَعْلَمُ مُسْتَقَرَّهَا وَمُسْتَوْدَعَهَا كُلٌّ فِي كِتَابٍ مُبِينٍ﴾

“S’ka asnjë gjallesë në Tokë që të mos i ketë mjetet e jetesës prej Tij. Ai di vendbanimin e saj dhe vendin e vdekjes. Të gjitha këto janë (të shënuara) në Librin e qartë.” (Hud, 6).

Muhamedi, paqja dhe mëshira e Zotit qofshin mbi të, ka thënë:

تزوجوا الودود الولود، فإني مكاثر بكم الأمم يوم القيامة

“Martohuni me gra që lindin shumë dhe që janë të dashura (me burrat), sepse unë do të krenohem me numrin tuaj përpara pejgamberëve në Ditën e Kiametit.”

Ky ajet dhe hadithi i cekur më lartë na ftojnë ta shohim familjen e madhe jo si barrë dhe frikë nga risku, por si bekim dhe kontribut për shoqërinë dhe për kombin. Kosova ka nevojë për më shumë fëmijë, për më shumë të rinj, për jetë më të mirë. Kombi ynë po zbehet në numër, ndërkohë që shumë familje shqiptare në të kaluarën i kanë rritur edhe nga dhjetë apo më shumë fëmijë, në kushte shumë më të vështira sesa sot, atëherë kur ishin të okupuar me një okupim klasik nga Serbia.

Nataliteti si strategji kombëtare dhe fetare për mbrojtjen e atdheut dhe fesë, ndërlidhet me mbijetesën kombëtare, identitetin fetar dhe sigurinë shtetërore. Historia e kombit tonë ka kaluar nëpër sprova të rënda, një ndër sfidat më të mëdha në ato kushte okupimi ka qenë mbijetesja, jo vetëm fizike, por edhe shpirtërore, kulturore dhe identitare. Në këtë kontekst, nataliteti apo lindshmëria, nuk ishte thjesht një fenomen biologjik e statistikor, por një strategji jetike, që prekte në rrënjë sigurinë, zhvillimin dhe vazhdimësinë e kombit dhe fesë.

Vatani nuk mbrohet vetëm me armë, por mbi të gjitha mbrohet me popullsi të shëndoshë, të arsimuar dhe të ndërgjegjshme. Në këtë kuptim, nataliteti është një lidhje e fortë strategjike për mbijetesën kombëtare, sidomos në rajonet ku shqiptarët janë pakicë ose të rrezikuar nga asimilimi. Në këto kushte, rënia e natalitetit është një alarm kombëtar. Shteti duhet të reagojë me shpejtësi të madhe, të mbështesë familjet me politika pro natalitetit, siç janë: punësimi i dy prindërve, lehtësimet ekonomike, mbështetja për nënat shtatzëna, kujdesi për fëmijët etj. Shteti duhet të ketë strategji konkrete për ndihmë ekonomike, arsimore, shëndetësore dhe sociale për këto familje dhe këta fëmijë,

dhe çdo çifti, të cilët kanë katër e më shumë fëmijë i propozoj qeverisë që t'ua dhuroj nga një banesë.

Kjo nuk është thjesht vetëm nevojë ekonomike për këto familje, por është edhe përgjegjësi morale, fetare dhe kombëtare, sepse duke përkrahur familjen e madhe, ne ndërtojmë një shoqëri të shëndoshë dhe një të ardhme të qëndrueshme. Duke e pasur bindjen se këto familje nuk janë barrë për shoqërinë tonë, por ato janë garanci për të ardhmen e sigurt të vatanit tonë të dashur.

Kur një segment i popullatës është në nevojë, dhe veçanërisht kur ata përfaqësojnë të ardhmen biologjike dhe morale të kombit, atëherë intervenimi institucional bëhet obligim moral dhe civilizues. Familjet me shumë fëmijë e ruajnë edhe më shumë gjuhën, fenë, kulturën dhe rendin natyror të jetës. Prandaj, përkrahja e tyre është një investim në të ardhmen kombëtare dhe një përmbushje e urdhëresave hyjnore për drejtësi dhe përkujdesje sociale.

Vëllezër dhe motra,

Në këtë ditë të bekuar, kujtojmë të varfrit, jetimët, të sëmurët, të vetmuarit dhe njerëzit në nevojë. Begatimi i sofrës për njerëzit në nevojë, në ditën e Bajramit, përbën një akt të lartë solidariteti dhe humanizmi, që mishëron thelbin etik dhe shpirtëror të kësaj feste.

Zoti i Madhërishtëm na urdhëron:

﴿ إِنَّ اللَّهَ يَأْمُرُ بِالْعَدْلِ وَالْإِحْسَانِ وَإِيتَايَ ذِي الْقُرْبَىٰ وَيَنْهَىٰ عَنِ الْفَحْشَاءِ وَالْمُنْكَرِ وَالْبَغْيِ يَعِظُكُمْ لَعَلَّكُمْ تَذَكَّرُونَ ﴾

“Në të vërtetë, Allahu urdhëron drejtësinë, mirësinë dhe ndihmën për të afërmit, si dhe ndalon imoralitetin, veprat e shëmtuara dhe dhunën. Ai ju këshillon, në mënyrë që ju t'ia vini veshin.” (En Nahl, 90).

Ky gjest nuk është thjesht bamirësi, por një manifestim i drejtësisë sociale dhe i ndërgjegjes kolektive, ku pasuria ndan kuptimin me varfërinë dhe gëzimi bëhet i përbashkët. Në një ditë kur besimtari falënderon Zotin për mëshirën dhe begatinë, ndarja e bukës me të tjerët është shprehje konkrete e devotshmërisë, e përlulesisë dhe e dashurisë ndaj tjetrit. Ky nuk është vetëm detyrim fetar, por edhe akt qytetarie dhe përgjegjësie morale ndaj trupit të përbashkët shoqëror.

Pejgamberi, paqja dhe mëshira e Zotit qofshin mbi të, ka thënë:

ليس المؤمن الذي يشبع وجاره جائع

“Nuk është besimtar ai që fle i ngopur, ndërsa fqinji i tij është i uritur.”

Të dashur besimtarë,

Në këtë ditë të festës së Kurban Bajramit, le ta falënderojmë Zotin e Madhëruar për gjithçka që na ka dhënë.



Le ta mbajmë gjallë sakrificën, dashurinë për njëri-tjetrin, për vatanin, si dhe të punojmë për një Kosovë me më shumë jetë, me më shumë fëmijë dhe me më shumë shpresë.

Le të jetë ky Bajram një thirrje për më shumë drejtësi sociale, për ndihmë të ndërsjellë, për bashkim dhe dashuri ndërmjet njerëzve, për më shumë ndërgjegje, për ta bashkuar mendjen me zemrën, dijen me përgjegjësinë dhe suksesin në shërbim për të mirën e përbashkët të vendit tonë.

Zoti e bekoftë popullin tonë!

Zoti e ruajt Kosovën!

Zoti i bekoftë familje tona dhe na udhëzoftë në rrugën e drejtësisë dhe të mëshirës!

Me fat festa e Kurban Bajramit!

Myftiu Naim ef. Tërnavë

Prishtinë, më 6 qershor 2025

DUAJA E KURBAN BAJRAMIT

O Zot, bëje këtë Bajram festë të begatë për ne dhe familjet tona!

O Allah, na i prano veprat e mira, na i fal mëkatet!

O Zot i Gjithëmëshirshëm dhe i Gjithëditur,
në këtë ditë të madhe sakrifice dhe përkushtimi,
na i pastro zemrat nga çdo dyshim dhe çdo ego!

Na i mbush shpirtat me devotshmëri, falënderim dhe durim!

Na bëje nga ata që i kuptojnë thellësitë e fesë!

Na e prano haxhin, kurbanin, sikurse ia pranove Ibrahimit të dashur dhe Ismailit të bindur!

Bekoji familjet tona, fëmijët tanë, vendin tonë,
dhe besimtarët tanë kudo që ndodhen, me paqe, begati dhe dritë!

Urime festa e Kurban Bajramit

Sinqueriteti, ky adhurim i munguar

Hfz. Arif Emini

Ç'ËSHTË SINQERITETI, CILI ËSHTË DEFINICIONI I TIJ, CILA ËSHTË E VËRTETA E TIJ?

Le të fillojmë nga aspekti terminologjik. Fjala “ihlas” është e marrë prej “halusa shejë min...”, shpëtim i diçkaje nga asgjësimi, nga prishja, gjegjësisht mbetja e diçkaje e shëndoshë, e pa gjymtuar. Thuhet se uji shpëtoi nga papastërtia, d.m.th., u filtrua.

Këtë shprehje e gjejmë edhe në Kuranin famëlartë, ku Allahu Fuqplotë thotë: “...mes ushqimit të tyre dhe gjakut ju japim të pini qumësht të pastër, të shijshëm për ata që e pinë.”¹ Pra, pastërtia e qumështit nënkupton që të mos jetë i përzier me gjak dhe ushqim dhe me çdo gjë tjetër që mund të përzihet me të. Kur thuhet që dikush ka bërë një punë të mirë me sinqeritet, d.m.th., se ka vepruar për hir të Allahut xh.sh., dhe qëllimin e tij e ka pastruar nga ato që mund të asgjësojnë vlerën e veprës, siç është syfaqësia, hipokrizia e të ngjashme me to, dhe ky është kuptimi i dëshiruar që ne kemi për qëllim ta shtjellojmë.

Në këtë kontekst e gjejmë edhe fjalën e Allahut Fuqplotë ku thotë: “E duke qenë se ata nuk ishin urdhëruar me tjetër pos që të adhuronin Allahun me një adhurim të sinqertë ndaj Tij, që të largohen prej çdo besimi të kotë, të falin namazin, të japin zekatin se ajo është feja e drejtë.”²

“E duke qenë se ata nuk ishin urdhëruar me tjetër pos që të adhuronin Allahun me një adhurim të sinqertë ndaj Tij, që të largohen prej çdo besimi të kotë, të falin namazin, të japin zekatin se ajo është feja e drejtë.”

(El Bejneh, 5)

Njerëzit pra janë të urdhëruar ta adhurojnë Allahun Fuqplotë, por janë të obliguar që edhe të jenë të sinqertë në adhurimin ndaj Tij. Imam Kurtubiu rreth këtij ajeti flet se këtu gjejmë argumentin e qartë për obligueshmërinë e nijetit në adhurime, kurse sinqeriteti është çështje e zemrës me të cilin dëshirohet të arrihet kënaqësia e Zotit dhe ibadetet të bëhen vetëm për hir të Tij dhe për hir të askujt tjetër.³

Nga kjo kuptojmë se sinqeriteti është një virtyt dhe karakteristikë morale me të cilin një person shfaq mendimet, veprat dhe adhurimet pa syfaqësi, pa hipokrizi, pa shtirrje, pa



dëshirën e ekspozimit, lavdërimit apo hiperbolizimit të diçkaje.

SI E KANË DEFINUAR SINQERITETIN NJERËZIT E URTË?

Disa nga njerëzit e urtë kanë thënë se: Sinqeriteti është sekret mes Allahut dhe robrit, të cilin nuk e dinë as melaqet që ta regjistrojnë, as djajtë që ta prishin, e as nefs i që t'ia asgjësojë vlerën. Fadil ibën Ijad ka thënë: “Lënia e ndonjë veprë për shkak të njerëzve është syfaqësi, veprimi i ndonjë veprë për shkak të njerëzve është shirk, kurse sinqeritet nënkupton që Allahu të të ruaj prej të dyja veseve.”

Përcillet se havarijunët e kanë pyetur Isain a.s., se çështje sinqeriteti në vepra? Ai është përgjigjur: “Vepra që bëhet për Allahun e Madhëruar e për të cilën nuk ke dëshirë që të të lavdërojë askush.”

Ka shumë thënie që janë përcjellë për sinqeritetin nga e kaluara jonë e ndritur, por më së miri sinqeritetin e ka definuar i Dërguari i Allahut a.s., atëherë kur Sufjan ibën Abdullah eth Thekafiju kërkoi këshillë prej tij duke i thënë: “O i Dërguari i Allahut, me trego në Islam një fjalë për të cilën nuk do e pyes askënd përpos teje?” Muhamedi a.s., i qe përgjigjur: “Thuaj: Besoj Allahun, e pastaj përqendrohu!”⁴

Po ashtu, në një hadith kudsij, Muhamedi a.s., thotë: “Allahu i Madhëruar thotë: Sinqeriteti është sekret prej sekreteve të Mia, e kam deponuar në zemrën e atij që e dua nga robërit e Mi.”

SINQERITETI NË ADHURIM

Allahu Fuqiplotë i ka urdhëruar robërit e Tij të jenë të sinqertë në adhurim dhe në lutjet drejtuar Madhërisë së Tij duke thënë: “Thuaj: Zoti im urdhëron drejtësi. Drejtohuni vetëm nga Ai në çdo xhami, e lutuni Atij sinqerisht, me besim të pastër e të vërtetë! Siç ju ka krijuar së pari, ashtu do t'ju ringjallë.”⁵

Këtu nënkuptojmë se jo vetëm veprën, por edhe qëllimin duhet ta pastrojmë, dhe se qëllimi i pastër i një veprimi është kusht prej kushteve të pranimi të asaj veprë tek Allahu Fuqiplotë. Në këtë kuptim Allahu i Madhëruar në një hadith kudsij thotë: “Unë nuk jam

Përcillet se havarijunët e kanë pyetur Isain a.s., se çështje sinqeriteti në vepra? Ai është përgjigjur: “Vepra që bëhet për Allahun e Madhëruar e për të cilën nuk ke dëshirë që të të lavdërojë askush.”

nevojtar për ortak, e kush bën një punë për Mua duke më shoqëruar me dikë tjetër, po Unë jam i pafajshëm për të, kurse ajo veprë do të ngelet për atë me të cilin më ka shoqëruar.”⁶

Kur ndonjë veprim është i përzier me syfaqësi apo hipokrizi, ajo nuk pranohet, përkundrazi refuzohet dhe do t'i kthehet pronarit të tij dhe do t'i thuhet të kërkojë shpërblim nga ata për hir të të cilëve ka vepruar.

Kujdesi i gjeneratave të para që çdo adhurim dhe punë e mirë të mbetet me qëllim të mirë e të pastër ka qenë shumë i madh. Përcillet se Ibrahim en Nehaiu kur ka lexuar Kuran, nëse ka trokitur dikush në derë, ai e ka mbuluar Kuranin që të mos e prishë nijetin e tij kur të hyjë brenda vizitori. Nga ana tjetër, prishja e qëllimit të pastër ngërthen rrezik për humbjen dhe asgjësimin e shpërblimit. Nga Muxhahidi përcillet se ka thënë: “Ka ardhur një njeri te Pejgamberi a.s., dhe e ka pyetur: “O i Dërguari i Allahut, unë jap lëmoshë, e mbaj farefisninë dhe këtë e bëj vetëm për Allahun e Madhëruar, këtë mua ma rikujtojnë të tjerët dhe më lavdërojnë për të, e ajo mua më gëzon dhe më bën krenar.” I Dërguari i Allahut heshti dhe nuk foli gjë, atëherë Allahu Fuqiplotë ka shpallur ajetin: “E kush është që shpreson takimin e Zotit të vet, le të bëjë veprë të mirë, e në adhurimin ndaj Zotit të tij të mos i cilësojë askënd.”⁷

DOBITË E SINQERITETIT

Sinqeriteti në vepra është mbrojtje nga mundësia e nxitjeve të djallit dhe devijimeve të tij. Allahu Fuqiplotë në Kuran thotë: “*Ai tha: Beto hem në madhërinë Tënde se unë do t'i mashtroj ata të gjithë, përveç robërve Tu të sinqertë!*”⁸

Sinqeriteti të bën të trashëgosh mirësitë e Xhenetit. Allahu Fuqiplotë thotë: “*Kurse robërit e sinqertë të Allahut, do të kenë furnizim të njohur, fruta të ndryshme e do të jenë të respektuar, në kopshtet e lumturisë, në kolltukë përballë njëri-tjetrit...*”⁹

Sinqeriteti e pasturon zemrën e njeriut nga urrejtja, mashtrimet dhe tradhtia. Transmeton Ahmedi dhe Ibën Maxheh nga Zejd ibën Thabit r.a., se i Dërguari i Allahut a.s., ka thënë: “Në tri gjëra zemra e myslimanit nuk mashtrohet, sinqeriteti në vepra për hir të



Zotit, këshilla e udhëheqësve ndaj myslimanëve, dhe besnikëria ndaj xhematit, sepse lutjet e tyre iu vijnë nga pas.”¹⁰

Sinqueriteti është çelësi i suksesit dhe fitoreve. Transmetoi Nesaiu, me zinxhirë transmetuesish të saktë, nga Seid ibën Ebi Vekasi r.a., se i Dërguari i Allahut a.s., ka thënë: “Vërtet Allahu do ta ndihmojë këtë ymet nëpërmjet të dobëtëve të tyre, lutjeve të tyre, namazit të tyre dhe sinqueritetit të tyre.”

Sinqueriteti nxjerr nga ngushtësitë e jetës dhe largon brengat. Kjo çështje shumë mirë vërehet në transmetimin e të Dërguarit të Allahut për ata tre personat nga Beni Israilët, të cilët kishin hyrë në një shpellë, në ndërkohë një shkëmb i madh ua zuri daljen. Të tre personat ofruan në lutjet e tyre nga një vepër që e kishin pasur sinqerisht vetëm për Allahun dhe kështu Zoti i shpëtoi nga ajo vështirësi në të cilën kishin rënë.¹¹

Sinqueriteti është njësia matëse e vlerësimit të veprave të njerëzve, d.m.th., se punët e mira mund të bëhen nga një numër i madh i njerëzve, por dallimin e bën se dikush prej tyre është i sinqertë e dikush jo, kështu ndodh që vepra më e pakët të shpërblehet më shumë për shkak të sinqeritetit dhe vepra më e madhe të shpërblehet më pak për shkak të mungesës së sinqeritetit. Njerëzit e urtë shpeshherë kanë thënë se vepra i ngjason trupit kurse sinqeriteti shpirtit, një trup pa shpirt është edhe pa vlerë.

O Allah i
Plotfuqishëm,
pastroji zemrat
tona nga
gjurmët e
hipokrizisë,
shtirjes dhe
vetëpëlqimit,
na fal
sinqeritet në
vepra të mira,
e na përgëzo
me faljen,
mëshirën dhe
shpërblimet
Tua në Ditën e
Llogarisë!

Nga tregimet që përcillen, do të veçoj atë të krimbit të mëndafshit me merimangën. Një ditë, krimbi i mëndafshit e prodhoi rrjetën e tij, por iu afrua merimanga edhe ajo e bëri rrjetën e saj dhe i tha: “O krimb, ti bërë rrjet, por edhe unë bëra rrjet, çfarë dallimi ka në mes prodhimeve tona?” Krimbi i mëndafshit i përgjigjet: “Atë rrjetë që e bëj unë e mbajnë mbretërit, kurse rrjetën që e bëre ti e ke kurth për mizat dhe insektet me të cilat ushqehesh. Të mjafton vetëm një herë që t’i prekësh dhe të bësh dallimin.”

O Allah i Plotfuqishëm, pastroji zemrat tona nga gjurmët e hipokrizisë, shtirjes dhe vetëpëlqimit, na fal sinqeritet në vepra të mira, e na përgëzo me faljen, mëshirën dhe shpërblimet Tua në Ditën e Llogarisë!

1 En Nahl, 66.

2 El Bejneh, 5.

3 El Kurtubi, *El Xhamiul Ahkamil Kurtubi*, vëllimi XX, f. 144, Darul Kutub el Kahire, 1967.

4 Rijadus-salihin, f. 27.

5 El Araf, 29.

6 Ibën Maxheh, f. 3406.

7 El Kehf, 110.

8 Sad, 82-83.

9 Es Saffat, 39-44.

10 Ibën Maxheh, f. 230, Ibën Hibbani, f. 67/68, Tirmidhiu, f. 2658.

11 Shiko më gjerësisht në Rijadus-salihin, f. 6-7.



Modestia si virtyt me vlerë në jetën e besimtarit

Mr. Sead Paqarizi

Synimi i secilit besimtar është që përmes besimit të përmbushur, veprave të pranuar dhe moralit të lartë të fitojë kënaqësinë e Allahut xh.sh., gjegjësisht shpërblimin dhe gradimin me Xhenet dhe mirësitë e tij. Prandaj, një nga virtytet që i mundëson njeriut të arrijë këtë qëllim, duke ia lehtësuar dhe trasuar rrugën drejt këtij qëllimi është modestia.

KUPTIMI I MODESTISË

Modestia është një prej virtyteve më të vlerësuara në shpalljet hyjnore dhe në të gjitha traditat dhe kulturat shoqërore në botë. Ajo nënkupton përulësinë, thjeshtësinë,

respektin ndaj Zotit dhe njerëzve, vetëdijen për kornizat individuale si dhe vetëpërmbajtjen në sjellje, veshje dhe të folur.¹ Gjithashtu modestia si virtyt nënkupton shprehjen e sinqeritetit, largimin nga mendjemadhësia, arroganca, mburrja, krenaria e tepruar dhe vetëlavdërimi. Modestia te besimtari është dëshmi e besimit të thellë, bindjes dhe respektit ndaj Allahut xh.sh..²

MODESTIA NË KURAN

Modestia si një virtyt me vlerë, në terma të ndryshëm përmendet edhe në Kuranin famëlartë. Allahu xh.sh., në suren *El Maide*, duke përmendur karakteristikat e një shoqërie të mirë, me fjalën “...të përulur me besimtarët...” (El Maide, 54), ka për qëllim modestinë, ndërsa në suren *El Isra*, derisa përmend detyrimet ndaj prindërve me shprehjen “...lësho para tyre krahët e përuljes prej mëshirës...” (El Isra, 24), aludon po ashtu në modesti. Virtyti i modestisë është përmendur në Kuran edhe në suren *El Furkan* me fjalën thjeshtësi/përulësi, kur Allahu tregon për robërit e të Gjithëmëshirshmit që ata janë “...të cilët ecin thjeshtë nëpër Tokë...” (El Furkan, 63), pra larg mburrjes dhe mendjemadhësisë. Terma të ngjashëm që aludojnë në përulësi apo që nxisin virtytin e modestisë janë përmendur edhe në ajete të tjera.³

Në Kuranin fisnik, në forma dhe fjalë të ndryshme, modestia është përmendur si një virtyt i lartë, i cili duhet të jetë i gdhendur në personalitetin e besimtarit dhe po ashtu janë përmendur edhe vetitë e tjera jo të mira, të cilat janë e kundërta e modestisë dhe nga të cilat besimtari duhet të distancohet dhe ta ruaj vetveten e tij.⁴



MODESTIA TE PEJGAMBERËT

Pejgamberët janë shembulli më i mirë i modestisë dhe përlësisë. Ata ishin personat më të përkryer dhe të përmbushur në moral dhe sjellje në mesin e njerëzve. Edhe pse ishin të zgjedhur të Zotit, që ishte një privilegj i jashtëzakonshëm, ishin njerëz me mision të veçantë si dhe me pozita të larta në këtë dhe botën tjetër. Ata gjithnjë e ruajtën thjeshtësinë dhe përlësinë duke qëndruar larg arrogancës, mendjemadhësisë apo murrjes dhe krenarisë me pozitën e tyre.⁵

Pejgamberi Muhamed a.s. është shembulli më i ndritshëm si i dërguar dhe personalitet me vlera dhe virtyte të larta në historinë e njerëzimit. Ai ishte shembull edhe në modesti me jetën e thjeshtë dhe përzierjen me njerëzit e zakonshëm, kryerjen e punëve të shtëpisë, përlësinë ndaj kategorive në nevojë dhe ndaj atyre që gabonin.⁶ Në një rast Muhamedi a.s. ka thënë: *“Unë jam rob dhe i Dërguar i Allahut, nuk dua që të më ngrini siç e ngritën të krishterët Isain, birin e Merjemes.”*⁷

Edhe pejgamberët e tjerë, si: Ibrahim, Jusuf, Musai, Isai etj., ishin me jetë dhe sjellje modeste, duke ruajtur përlësinë ndaj Zotit dhe njerëzve si virtyt të lartë njerëzor.

Prandaj, për ta përvetësuar modestinë si një virtyt të lartë në personalitetin e tij, besimtari duhet ta ndjekë shembullin e pejgamberëve në jetën e përditshme. Modestia e tyre na mëson se madhështia e vërtetë qëndron në përlësinë ndaj Allahut dhe në dashurinë e dhembshurinë për njerëzit. Kjo është rruga e sigurt për të fituar dashurinë dhe kënaqësinë e Zotit. Muhamedi a.s., ka thënë: *“Kush e përlu veten për hir të Allahut, Allahu e lartëson atë.”*⁸ Përmes përlësisë besimtari arrin pastërtinë e zemrës, ndriçimin shpirtëror dhe respektin e vërtetë.

MODESTIA NDAJ ALLAHUT

Modestia më e lartë dhe e sinqertë është bindja dhe përlësia ndaj Allahut xh.sh.. Vetëdija dhe bindja për praninë e vazhdueshme të Allahut çdo kund dhe çdoherë nxit besimtarin të jetë i përlur, të ruaj ndershmërinë, të largohet nga mëkatet dhe të kërkojë falje në vazhdimësi. Pejgamberi a.s., ka thënë: *“Keni turp nga Allahu ashtu siç duhet të keni turp.”*⁹

Modestia e sinqertë ndaj Allahut xh.sh. për besimtarin është një ndjenjë thellësisht shpirtërore e respektit, përljes, mirënjohjes dhe ndërgjegjësimi për Madhësinë e Allahut xh.sh. dhe dobësinë e vetvetes, e cila e shtynë atë të jetojë me kujdes, të sillet me ndershmëri në çdo aspekt jetësor. Ky virtyt i lartë i besimtarit ndaj Allahut xh.sh. shfaqet në adhurim, duke ju afruar besimtari Allahut xh.sh. me përlësi. Ai mundohet maksimalisht dhe shpirtërisht të adhurojë Allahun ashtu siç Ai e meriton, larg mendjemadhësisë e syfaqësisë. Modestinë ndaj Allahut xh.sh. besimtari e shfaq edhe në lutje, duke shprehur kërkesa dhe dua me përlësi, larg



kërkesave arrogante me bindje se është i varfër para Tij. Po ashtu besimtari modestinë ndaj Allahut e manifeston edhe në përditshmërinë e tij, duke u kujdesur për gjuhën nga fjalët jo të mira, për sytë nga shikimi i ndaluar, për trupin nga mëkatet e ndryshme në shenjë respekti ndaj Allahut dhe me bindje që Ai e sheh kudo. Andaj modestia ndaj Allahut xh.sh. është thelbi i moralit islam dhe rrënja e çdo virtyti të lartë për besimtarin.

ROLI I MODESTISË NË JETËN E BESIMTARIT

Besimtari, fillimisht, përmes modestisë percepton pafuqinë e tij para Allahut xh.sh. dhe kështu reflekton këtë vetëdije në jetën e tij. Kjo vetëdije në raport me Krijuesin i mundëson besimtarit të jetë modest në adhurime dhe përditshmërinë e tij. Besimtari i nënshtruar ndaj Zotit me modesti, kujdeset që përlësinë e tij ta shfaq edhe te njerëzit dhe t'i trajtojë të gjithë të barabartë, pa nënçmuar askënd.

Modestia si virtyt i lartë për besimtarin manifestohet edhe në veshjen, fjalët dhe sjelljet e tij. Thirrja për mbulimin e trupit dhe uljen e shikimit¹⁰ janë shprehje e thjeshtësisë, gjegjësisht të modestisë dhe përlësisë, që ju drejtohet grave por edhe burrave që ta ruajnë pastërtinë dhe thjeshtësinë në sjellje.

Andaj modestia ka një ndikim të thellë në jetën e besimtarit duke e afruar atë me Krijuesin dhe duke e mbrojtur nga dukuritë, vetitë, mëkatet dhe veprat jo të mira. Ajo e bën besimtarin të përlur ndaj Allahut, të dashur dhe dhembshur ndaj njerëzve, të jetë produktiv, i dashur dhe i vlerësuar nga të tjerët, i mundëson përforcimin e karakterit dhe personalitetit të tij, ia lehtëson arritjen e devotshmërisë etj..

MODESTIA – MBUROJË NGA MËKATET

Modestia, duke qenë një virtyt me vlerë, i cili nxit besimtarin gjithnjë drejt vetive pozitive, në të njëjtën kohë është një mburojë e fuqishme që ruan zemrën, mendjen, gjymtyrët dhe trupin e njeriut nga të bërit mëkat. Modestia e fortë në zemrën e besimtarit bëhet mburojë shpirtërore që mbron nga veprimet e ndaluara dhe i forcon ndërgjegjen për

të qëndruar në rrugën e drejtë. Kështu ajo frenon dëshirën për të bërë mëkate në vetmi, ruan shikimin, gjuhën dhe pjesët e trupit nga veprimet e ndaluara dhe e largon besimtarin nga mendjemadhësia, mburrja dhe arroganca. Pra, besimtari me modesti të ngulitur në karakterin e tij ndien keqardhje dhe turp para Allahut xh.sh. kur e shkel një urdhër të Tij. Po ashtu ai është i ndjeshëm gjithmonë ndaj veprimeve dhe mendimeve që mund ta çojnë në mëkate, andaj kjo ndjeshmëri e mbanë gjallë ndërgjegjen morale tek ai dhe ndikon që në vazhdimësi të jetë i lidhur me Krijuesin.¹¹ Nëse modestia është prezente në zemrat e besimtarëve, ajo bëhet mburojë edhe për shoqërinë e jo vetëm për individin. Prandaj modestia është një mburojë e padukshme por e fortë, një ndër armët më të fuqishme për besimtarin në një kohë kur mëkatet janë të pranishme kudo dhe tundimet janë të shumta.

REFLEKTIMI I MODESTISË NË SHOQËRI

Modestia duke përfaqësuar përlësinë, maturinë dhe dinjitetin, luan një rol të rëndësishëm për ndërtimin e një shoqërie të shëndoshë me iman (besim). Ajo ndikon në rritjen e respektit dhe ndershmërisë ndërmjet njerëzve dhe ruajtjen e unitetit, duke i vlerësuar të gjithë njësoj, me respekt dhe përlësi. Nxit bashkëpunimin dhe mirëkuptimin, promovon moral të lartë në shoqëri dhe stopon konkurrencën e sëmurë dhe smirën. Po ashtu besimtari modest është produktiv edhe në edukim si mësues, edhe në udhëheqësi si përgjegjës edhe në marrëdhëniet sociale etj.. Modestia është një virtut me vlerë për besimtarin, që e zbukuron atë dhe përmirëson shoqërinë. Kultivimi dhe nxitja e saj në shoqëri është obligim individual, shoqërore dhe fetar.

RUAJTJA E MODESTISË NË JETËN BASHKËKOHORE

Ruajtja, promovimi dhe kultivimi i modestisë si virtut i lartë për besimtarin, është një detyrë për secilin person, kjo me qëllim të triumfit ndaj rreziqeve morale, pasioneve individuale dhe zbehjes së vlerave shpirtërore në kohën bashkëkohore. Feja është rruga më e sigurt për ruajtjen dhe promovimin e modestisë si virtut. Njohuritë dhe burimet

Modestia,
duke qenë një
virtut me
vlerë, i cili nxit
besimtarin
gjithnjë drejt
vetive pozitive,
në të njëjtën
kohë është një
mburojë e
fuqishme që
ruan zemrën,
mendjen,
gjymtyrët dhe
trupin e
njeriut nga të
bërit mëkat.

fetare mundësojnë ruajtjen e modestisë si virtut, sepse besimtari e di që përlësia apo turpi është pjesë e besimit.¹² Andaj rritja e vetëdijes fetare dhe morale ndikon në ruajtjen e këtij virtuti me vlerë. Po ashtu edhe edukimi familjar ndikon në ruajtjen e modestisë. Të rinjtë të cilët janë rritur edukuar në mënyrë të mirëfilltë në familje mësojnë thjeshtësinë, ndershmërinë dhe përlësinë, andaj si të tillë janë më të fuqishëm të përmbahen ndaj tundimeve dhe sfidave bashkëkohore. Po ashtu edhe zgjedhja e duhur e shoqërisë ndikon në ruajtjen e modestisë. Shoqërimi me ata që kanë frikë Zotin dhe me ata që distancohen nga të gjithë faktorët që ndikojnë në zbehjen e moralit ndihmojnë në ruajtjen e modestisë.

PËRFUNDIM

Modestia është një ndër virtutet më të çmuara që pasuron jetën e besimtarit, si në aspektin shpirtëror, ashtu edhe në atë moral dhe shoqëror. Ajo përfaqëson një shenjë të besimit të sigurt, pasqyrë të një ndërgjegjeje të gjallë dhe dëshmi të përlësisë ndaj Allahut. Besimtari modest ruan dinjitetin e tij, respekton kufijtë e sjelljes dhe e frenon veten nga mëkatet, duke jetuar me ndershmëri dhe përkushtim. Në një botë ku vlerat shpesh zbehen dhe relativizohen, modestia mbetet një udhërrëfyes i sigurt drejt moralit të pastër, devotshmërisë dhe lumturisë së qëndrueshme. Prandaj, kultivimi dhe ruajtja e saj nuk është vetëm një nevojë personale, por edhe një kontribut i vyer për ndërtimin e një shoqërie të shëndoshë dhe të drejtë.

1 Mustafa Çağrıci, *İlmi hal II İslam ve Tolum*, Botimet TDV, Ankara, 2006, f. 525.

2 Osman Nuri Topbash, *Qytetërimi i Virtuteve*, Botimet Progresi, Shkodër, 2010, f. 383.

3 El Haxh 34; Llukman 18-19; El Isra 37.

4 El Bekare, 34, En Nahl 23; Sad 74,

5 Mustafa Çağrıci, *İslam Ansiklopedisi*, "Tevazu", Botimet TDV, v.40, f. 584.

6 Imam Gazali, *Kimya-yı Saadet*, Shtëpia Botuese Çelik, İstanbul, f.571-572.

7 Buhariu, 3445.

8 Muslimi, Bamireshia 69.

9 Tirmidhiu, 2458.

10 En Nur, 31.

11 Osman Nuri Topbash, f. 401.

12 Mustafa Çağrıci, f. 526.

Lufta kundër urisë

Dr. Jusuf el Kardavi

Abdusamed Nasir: Të nderuar shikues, esselamu alejkum! Edhe në këtë epokë moderne, njerëzimi nuk e ka fituar ende luftën kundër urisë. Njëmbëdhjetë milionë njerëz vetëm në Afrikë janë drejtpërdrejt të rrezikuar nga kjo 'murtaja e kohëve moderne' dhe mbi njëzet mijë fëmijë vdesin çdo ditë si rezultat i kequshqyerjes. Ku janë të drejtat për të uriturit dhe si të mbrohet e drejta themelore e njeriut për jetë? Çfarë zgjidhje ofron Islami dhe pse në Islam kujdesi për të uriturin lidhet ngushtë me akiden? A ka të bëjë vetëm me ushqimin ndihma e detyrueshme për shtresat vulnerabil? Këto janë vetëm disa nga çështjet që do të diskutojmë sonte me temën 'të drejtat e të uriturve', me të ftuarin tonë të nderuar dr. Jusuf el Kardavin, të cilin e mirëpresim.

Doktor, pamjet tronditëse të fëmijëve të rraskapitur që nuk lëvizin dot nga uria dhe që për shkak të kequshqyerjes më shumë të kujtojnë skelete sesa njerëz të çmendur të gjallë. Si e sheh Islami urinë dhe a është ajo një provë apo një dënim?

Dr. Kardavi: Bismilahir-rahmanir-rahim. Falënderimi i takon Allahut, qoftë i lavdëruar dhe i lartësuar, dhe paqja dhe bekimet qofshin mbi të dashurin tonë, Muhamedin, *paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*, mbi familjen e tij të nderuar dhe shokët e nderuar dhe të gjithë ata që ndjekin udhëzimet e tij deri në Ditën e Gjykimit. Zia e bukës është një provë dhe një tragjedi që prek individët si dhe familjet, kombet dhe gjithë ymetin. Për shkak të ashpërsisë së sprovave të urisë, Muhamedi, *paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*, thoshte një lutje të përditshme në të cilën i lutej Allahut që ta mbronte nga uria: "Allah, kërkoj mbrojtje te Ti nga uria, sepse ajo është shoku im më i keq!"

Sahabiu i famshëm Ebu Dherri r.a., ka thënë: "Çuditë me një njeri që nuk ka ushqim në shtëpinë e tij, e që nuk del në rrugë dhe përpiket të sigurojë ushqim për veten dhe familjen e tij me shpatël!" Ebu Dherri r.a., habitet se si njerëzit nuk rebelohen kundër urisë, dhe historia na tregon se të varfrit

shpesh iu drejtuan rebelimit, grushteteve, dhunës për shkak të urisë - kundër atyre që kanë, që nuk janë të uritur dhe jetojnë në luks, ndërsa të tjerët nuk kanë ushqimin më të vogël të nevojshëm për jetës.

Imam Muhamed bin el Hassan esh Shejbani, një nxënës i njohur i Ebu Hanifes, një nga më të merituarit për zhvillimin e shkollës juridike hanefi, zakonisht u drejtohej nxënësve kur hynte shërbëtorja e tij dhe e informonte se gruaja e tij ishte duke i thënë se shtëpia ishte pa miell. E ndërpreu ligjëratën, iu drejtua shërbëtores dhe i tha: "Të ka vrarë Allahu, më ke fshirë nga koka dyzet pyetjet ligjore që kam përgatitur për t'i përpunuar në ligjëratën e sotme!" Edhe pse ishte një dijetar i madh, ne e kemi të qartë se informacioni për zhdukjen e ushqimit e thyen plotësisht përqendrimin e tij, sepse familja ishte në rrezik ekstrem.

Allahu i Lartësuar e krijoi njeriun në formën në të cilën ai është i varur nga ushqimi. Pra, njeriu duhet të ushqehet për



të qëndruar gjallë. Për mushrikët mekasë ishte e çuditshme që Allahu i Lartësuar u dërgoi atyre një Profet i cili ishte i varur nga ushqimi, kështu që Allahu i Lartësuar u përgjigj: *“Edhe para jush, ne dërguam vetëm njerëz të cilëve u shpallëm ju nuk i njihni! Ne nuk i krijuam ata si qenie të gjalla pa ushqim, as nuk ishin të pavdekshëm.”* (El Enbija, 7-8).

Në momentin që njeriu mbetet pa ushqim, pa atë që është e nevojshme për jetën, ai është në gjendje jashtëzakonisht të vështirë dhe ka nevojë për ndihmë. Nëse dikush është i uritur, është detyrë e fqinjëve t'i ndihmojnë, më pas të afërmit, pastaj komuniteti shoqëror, shteti dhe mbarë bota. Pra, të gjithë njerëzit janë përgjegjës për urinë e një personi nëse nuk e ndihmojnë atë të shpëtojë veten. Në çdo vend ka nga ata që kanë ushqim të mjaftueshëm, dhe pjesën tjetër e hedhin, ndërsa të tjerët detyrohen të gërmojnë nëpër kontejnerë për të marrë ushqime. Është një gjendje e papranueshme që përkeqëson ashpërsinë e urisë.

Abdusamed Nasir: Si e shpjegon Islami fenomenin e urisë?

Dr. Kardavi: Uria është rezultat i disa rrethanave negative në të cilat ndodhet njeriu. Këto rrethana mund të jenë të ndryshme, si për shembull të jetosh në shkretëtirë ku nuk ka ujë të mjaftueshëm për të ujitur të korrat. Nëse nuk bie shi, ose nëse nuk mjafton, do të ketë një thatësi e cila do t'i pengojë të korrat të prodhojnë frutat e nevojshme për konsum njerëzor. Në rrethana të tilla, është e nevojshme të ndihmohen ata që jetojnë në zonat e goditura nga thatësira. Sot dihet mënyra e gjelbërimit të shkretëtirës, pra shndërrimi i shkretëtirës në tokë pjellore me vaditje. Nëse ata që jetojnë në zona vulnerabil nuk mund të ndihmohen, u takon atyre të largohen nga zona dhe të vendosen në një vend më të jetueshëm. Allahu i Lartësuar thotë: *“Kush shpërngulet për hir të Allahut, do të gjejë shumë vende në tokë, përkundër armiqve të tij dhe lirinë...”* (En Nisa, 100).

Uria ndonjëherë ndodh si pasojë e papunësisë. Nëse një burrë nuk mund të gjejë një punë për të jetuar, sigurisht që jeta e tij do të jetë e vështirë dhe shumë afër urisë. Andaj është obligim i shoqërisë që të gjithë ata që kanë nevojë të sigurojë punë që të jetojnë

Në vend që t'i jepet një njeriu një peshk të kapur për të ushqyer veten, atij duhet t'i jepet një rrjetë në mënyrë që të mund të kapë aq sa i nevojitet për të jetuar dhe kështu të jetë i pavarur nga të tjerët.

normalisht nga puna. Prandaj, synimi ynë nuk duhet të jetë vetëm të kujdesemi për të uriturit në atë mënyrë që t'i ushqejmë, por problemet e tyre duhet të zgjidhen sistematikisht. Në vend që t'i jepet një njeriu një peshk të kapur për të ushqyer veten, atij duhet t'i jepet një rrjetë në mënyrë që të mund të kapë aq sa i nevojitet për të jetuar dhe kështu të jetë i pavarur nga të tjerët.

Qëllimi i programit social islam është që të kujdeset përherë për të varfrit, në mënyrë që ata të bëhen plotësisht të pavarur nga ndihma e të tjerëve sa më shpejt të jetë e mundur. Qëllimi kryesor i zekatis është kujdesi i përhershëm dhe cilësor për të varfrit. Duke shpjeguar qëllimin e zekatis, Imam Shafiu ka thënë: *“Të varfërve u jepet ajo që do t'u sigurojë atyre jetën duke punuar dhe siguruar veten dhe familjet e tyre.”* Nëse e njeh zanatin e zdukthëtarisë, do t'i jepet zekati në makinat e zdukthëtarisë me të cilat do të bëjë punën. Nëse e kupton farkëtimin e hekurit, do t'i sigurohet gjithçka që i nevojitet për këtë punë. Nëse është bujk, do t'i jepet toka dhe makineritë e nevojshme për kultivimin e tokës në mënyrë që të fitojë bukën e gojës dhe së shpejti të kalojë nga gjendja e atij që ka nevojë për zekatin në gjendjen e atij që është i detyruar të japë zekat.

Arsyet e urisë mund të jenë edhe për shkak të korrakisë së të pasurve dhe qëndrimit të tyre shtypës ndaj të varfërve. Fatkeqësisht, ky fenomen nuk është i pazakontë në kohën tonë. Nëpërmjet sistemeve të ndryshme, pasuria përqendrohet në duart e individëve dhe në kurriz të një popullsie gjithnjë e më të varfër. Të pasurit nuk kujdesen për të varfrit dhe nuk i ndejnë vuajtjet e tyre. Kjo çon në një shtresim në rritje të shoqërisë. Të varfrit po varfërohen dhe të pasurit po pasurohen derisa të varfrit të mbeten pa asgjë, kur vetë ekzistenca e tyre bëhet e dyshimtë.

Abdusamed Nasir: Ju përmendët se është obligim i fqinjëve, të afërmeve apo i gjithë shoqërisë që të kujdesen për ata që nuk kanë mjete të mjaftueshme për jetesë. Konkludojmë se të varfrit kanë të drejta të caktuara me njerëzit e tjerë. A mund të na shpjegoni se cilat janë të drejtat e të uriturve?

Dr. Kardavi: E drejta themelore e të varfrit që nuk ka çfarë të hajë është e drejta për



ushqim. Ai ka të drejtë të ushqehet dhe kjo nuk duhet t'i mohohet. Askush nuk duhet të lejojë që jeta e dikujt të rrezikohet nga uria. Muhamedi a.s., në një hadith ka thënë: "Besimtar nuk është ai që e zë gjumi dhe e di se fqinji i tij është i uritur!" Kjo vlen për të gjithë, pavarësisht nëse ai ka dhënë zekatin apo jo ende. Nuk lejohet që dikush të thotë se ka dhënë zekatin dhe e ka kryer obligimin ndaj të varfërve dhe se i ka rënë obligimi për t'u kujdesur për ta. Na takon ne të kujdesemi për të gjithë ata që nuk kanë asgjë për të ngrënë, pavarësisht në çfarë kohe apo hapësirë ka ndodhur.

Kurani e ndaloi përdorimin e kërmave, përveç rasteve emergjente. Ibën Hazmi thotë se nuk lejohet që njeriu të konsumojë kërmë edhe në rast urgjence nëse ka një fqinj që mund ta ndihmojë. Muhamedi a.s., ka thënë: "Ai i cili ka tepricë, le t'ia japë atij që nuk ka!" Kështu, është detyrë e të pasurve që tepricën e të ardhurave t'ua japin të varfërve për të plotësuar nevojat e tyre themelore. Kjo është e drejta e të varfërve dhe ata duhet ta kërkojnë. Dhe nëse i pasuri nuk u jep atyre të drejtën e tyre, atëherë ata lejohen të përdorin forcën për të marrë të drejtën e tyre. Nëse ata vdesin në atë luftë, ata janë dëshmorë, sepse kanë luftuar për të drejtat e tyre. Prandaj, pasuria e të pasurve është e drejtë e të varfërve dhe duhet t'u jepet atyre.

Abdusamed Nasir: Ka mundësi që këto fjalë tua të keqkuptohen në mënyrë që dikush të kuptojë se përdorimi i forcës është i lejuar për atë që nuk ka mjete jetese. Një zhvillim i tillë mund të shkaktojë pasoja shumë negative?

Dr. Kardavi: E drejta e të uriturve është të luftojë kundër atyre që kanë mjaft dhe nuk duan t'i ndihmojnë. Ai që është i uritur duhet të ushqehet. Kur kjo e drejtë uzurpohet, atëherë atij nuk i mbetet gjë tjetër veçse të rebelohet kundër shtypjes

dhe uzurpimit të të drejtave elementare të njeriut. Është detyrë e besimtarit që të kujdeset për nevojtarët dhe të japë nga pasuria e tij nevojtarëve. Është obligim i rreptë që çdo besimtar duhet ta përmbushë. Kurani na mëson se neglizhimi për të mbështetur të uriturin është një nga arsyet e mosbesimit: "Çfarë ju solli në Sekar? Ne nuk do të jemi, thonë ata, nga ata që e falin namazin dhe nga ata që ushqejnë të varfrit..." (El Mudethir, 42-44). Prandaj themi se për të ushqyer të uriturit është farz kifaje (obligim shoqëror). Nëse një grup e përmbush atë obligim, detyrimi bie nga të tjerët, por nëse askush nuk e ka përmbushur, atëherë të gjithë janë mëkatarë.

Abdusamed Nasir: Ju keni përmendur disa ajete në të cilat Allahu xh.sh. thotë: Dhe si mendon; si mund të jetë njeriu mirënjohës për mirësitë? "Është lirimi i një skllavi, ose dhënia e ushqimit në kohën kur mbretëron uria: Ndonjë jetimi që është i afërt, ndonjë të varfëri që e ka molisur varfëria." (El Beled, 16-12). A mund të nxjerrim përfundimin nga këto ajete se ushqimi i të varfërve është një detyrim fetar për të cilin njeriu do të jetë përgjegjës nëse nuk e përmbush atë?

Dr. Kardavi: Çdo kushtëzim i njerëzve që janë sprovuar nga fatkeqësi të tilla si uria është një krim kundër të cilit duhet të ngrihet e gjithë bota. Kjo është e papranueshme. Askush nuk duhet të poshtërohet apo nënshtrohet për shkak të situatës së pa lakmueshme në të cilën ndodhet. Dukuritë e tilla duhet të përballen me të gjitha mjetet e mundshme. Nuk do ta pranoja kurrë një kushtëzim të tillë. Uria do të ishte më e dashur për mua sesa heqja dorë nga besimi dhe nderi im!

Përktheu: Shpend Hula

Intervistë televizive me Dr. Jusuf Kardavin, marrë nga TV Ikra

Një fjalë që ndryshoi gjithçka – një emër i shkruar në qiell

Bajram Zeqiri

Në jetën e Pejgamberit a.s., sahabët kanë gëzuar një pozitë dhe status të veçantë. Ata, *Zoti qoftë i kënaqur me ta!*, janë njerëzit më të privilegjuar, sepse Allahu i bëri shoqërues dhe bashkudhëtarë të misionit më fisnik, të njeriut më fisnik, njeriut më të zgjedhur, vulës së pejgamberisë, Muhamedit a.s.. Ata janë brezi më i mirë i ymetit, prijatarët e këtij ymeti, ata që më së shumti u përpoqën dhe dhanë gjërat më të shtrenjta të tyre për këtë fe. Ata ishin të parët që besuan atë që iu shpallë Muhamedit a.s., duke luftuar kështu dhe duke u përpjekur për përhapjen e besimit në Një Zot edhe te gjeneratat e tjera. *“Sa u përket besimtarëve të parë, prej muhaxhirëve dhe ensarëve, Allahu është i kënaqur me*

ata dhe me të gjithë të tjerët që i pasuan me vendosmëri e përkushtim në besim; edhe ata janë të kënaqur me Atë. Allahu ka përgatitur për ata kopshte, nëpër të cilat rrjedhin lumenj dhe ku do të jetojnë përgjithmonë. Kjo është fitorja madhështore!” (Et Tevbe, 100).

Sahabët besuan të Dërguarin e Allahut a.s., në një kohë kur Islami ishte i huaj dhe i panjohur, luftuan për të në kohë të vështira, ftuan njerëzit në besim me urtësi e mençuri, sakrifikuuan më të shtrenjtën e tyre, jetën, ishin të afërt e miqësor me njëri-tjetrin, e të ashpër me armiq të tyre. Për besimin dhe virtytet e tyre, Allahu xh.sh., ka argumentuar në Kuranin fisnik, duke na thënë: *“Muhamedi është i dërguar i Allahut, e ata që janë me të (sahabët) janë të ashpër kundër jobesimtarëve, janë të mëshirshëm ndërmjet vete, ti i sheh kah përulën (në ruku), duke rënë me fytyrë në tokë (në sexhde), e kërkojnë prej Allahut që të ketë mëshirën dhe kënaqësinë e Tij ndaj tyre. Në fytyrat e tyre shihen shenjat e gjurmës së sexhdes...”* (El Fet’h, 29).

Edhe vetë Pejgamberi a.s., çmoi dhe vlerësoi lart meritën dhe angazhimin e tyre dhënë për Islamin. Prej tij janë transmetuar shumë hadithe, të cilat sqarojnë pozitën e tyre, ndër to e përmendim transmetimin e Ebu Seid el Hudriut, i cili transmeton se Pejgamberi a.s., ka thënë: *“Mos i shani shokët e mi, se, për Atë, në Dorën e të Cilit është jeta ime, nëse ndonjëri prej jush do të jepte (do të shpenzonte) sasi të arit sa kodra e Uhudit, nuk do ta arrinte mirësinë e asnjërit prej tyre, madje as gjysmën.”*¹

Pavarësisht se të gjithë sahabët jetuan dhe qëndruan për kohë të gjatë me Pejgamberin a.s., është i njohur fakti se ata nuk janë të një grade, porse disa kanë përparësi, merita dhe vlera karshi disa të tjerëve. Për këtë, Allahu xh.sh. ka



thënë: “Nuk janë të barabartë ata që kanë shpenzuar dhe kanë luftuar para fitores me ata që kanë shpenzuar dhe kanë luftuar më pas. Ata kanë shkallë më të lartë, mirëpo Allahu u premton të gjithëve më të mirën (Xhenetin). Allahu e di mirë atë që bëni ju.” (Hadid, 10). Në Kuranin fisnik, në suren Et Tevbe, në ajetin 117, shihet përparësia e muhaxhirëve kundrejt ensarëve: “Pa dyshim, Allahu e pranoi pendimin e të Dërguarit, të muhaxhirëve dhe të ensarëve.” (Et Tevbe, 117). Shembull të njëjtë të lavdërimit kemi edhe në suren Hashër, në ajetin 9, ku Allahu xh.sh., i lavdëroi të gjithë sahabët, porse i vendosi në përmendje muhaxhirët karshi ensarëve, për faktin se ata u veçuan duke lënë vendlindjen, pasurinë, familjen e fëmijët për të emigruar së bashku me të Dërguarin e Allahut, me qëllim që ta ndihmojnë atë dhe për ta lartësuar fjalën e Tij.²

Përveç lavdërimit të muhaxhirëve karshi ensarëve, janë të lavdëruar dhe të dalluar sahabët që morën pjesë në luftën e Bedrit, për çka Allahu ju tha: “Veproni ç’të doni se tashmë ju kam falur.”³

Nga të gjithë sahabët që jetuan me Pejgamberin a.s., vetëm disa prej tyre patën nderin që në të gjallë të tyre të përgëzoheshin me Xhenet nga vetë i Dërguari a.s..

DHJETË TË PËRGËZUARIT ME XHENET

Në një hadith të Pejgamberit a.s., të transmetuar nga Seid ibën Zejdi, thuhet se: “E kam dëgjuar Pejgamberin a.s., duke thënë: “Dhjetë persona janë në Xhenet: Ebu Bekri është në Xhenet. Omeri është në Xhenet. Othmani është në Xhenet. Aliu është në Xhenet. Talha është në Xhenet. Zubejri është në Xhenet. Abdurrahman ibën Aufo është në Xhenet. Sad ibën Maliku është në Xhenet. Ebu Ubejde ibën Amir ibën Xherrahu është në Xhenet.” Këtu transmetuesi i hadithit, Seid ibën Zejdi heshti për një moment. Të pranishmit e pyetën: “Kush është i dhjetë?” Ai u tha: “Seid ibën Zejdi” – për veten e tij. Më pas u tha: “Një moment i tyre me të Dërguarin e Allahut, ku u pluhurosej fytyra, është më i dobishëm se e gjithë jeta juaj e

“Mos i shani shokët e mi, se, për Atë, në Dorën e të Cilit është jeta ime, nëse ndonjëri prej jush do të jepte (do të shpenzonte) sasi të arit sa kodra e Uhudit, nuk do ta arrinte mirësinë e asnjërit prej tyre, madje as gjysmën.”

(Muhamedi, a.s.)

mbushur me vepra të mira, edhe sikur të jetonit sa Nuhu a.s..”⁴

FAMILJA E JASIRIT

Përveç dhjetë të përmendurve së bashku në një hadith, si të përgëzuar me Xhenet, Pejgamberi a.s., kishte përgëzuar me Xhenet edhe sahabë të tjerë, përfshirë këtu edhe një rast unik, siç është shembulli i një familje të tërë, e ajo është familja e Jasirit. Kjo për faktin se kjo familje sakrifikoi tejmasë, duke u keqtrajtuar mizorisht në shkretëtirën e Mekës. Ata torturoheshin dhe vuanin nën tortura të vazhdueshme, pa u mëshiruar as ditën dhe as natën. Për këtë, i Dërguari i Allahut, Muhamedi a.s., në një hadith ka thënë: “Duron i o familja e Jasirit, pasi vendtakimi juaj do të jetë Xheneti.”⁵

Gruaja e Jasirit ishte Sumeje bintu Hababi, e cila është edhe dëshmorja e parë në Islam, ndërsa burri i saj Jasir ibën Amir el Kendij, llogaritet dëshmori i parë në Islam, teksa djali i tyre Amar ibën Jasiri, ishte personi i parë që ndërtoi xhami. Gjaku i prindërve të Amarit ishte gjaku i parë që derdhej në rrugën e Zotit, e për këtë i Madhëruari në Kuranin fisnik na thotë: “Kurrresi të mos mendoni se janë të vdekur ata që ranë dëshmorë në rrugën e Allahut. Përkundrazi, ata janë të gjallë duke u ushqyer te Zoti i tyre.” (Ali Imran, 169).

PALMAT E EBU DERSASË NË XHENET

Zoti xh.sh., në Kuranin fisnik ka thënë: “Kush është ai që i huazon Allahut një hua të mirë, e Ai t’ia shtojë atij shumëfish atë? Allahu shtrëngon (varfëron) dhe çliron (begaton) dhe kthimi juaj është vetëm tek Ai.” (El Bekare, 245). Ky ajet që bërë motiv për Ebu Dersahnë r.a., teksa një ditë po dëgjonte Pejgamberin a.s., duke ligëruar mbi vlerën e sadakasë dhe shpenzimit të pasurisë në rrugën e Allahut. Ebu Dersahu kishte një fermë me hurma, e cila llogaritej si më e mira e asaj kohe në Medinë. Ai, pas dëgjimit të fjalëve të Pejgamberit a.s., vajti tek ajo dhe e dhuroi atë, e kur Pejgamberi a.s., dëgjoi për këtë, tha: “Sa shumë palma do të gjejë Ebu Dersahu në Xhenet.”⁶

“KËSHTU SHPËRBLEHET E MIRA, KËSHTU SHPËRBLEHET E MIRA”

Në një hadith, të cilin e transmeton Aisheja r.a., thuhet se Pejgamberi a.s., ka thënë: “Hyra

në Xhenet dhe dëgjova një lexim. Kur pyeta se kush është ai që lexon, më thanë është Harithe ibën Numani. Kështu shpërblehet e mira, kështu shpërblehet e mira.”⁷

VEREKA IBËN NEUFELI

Kur Pejgamberit a.s., i erdhi Xhibrili me shpalljen e Allahut në shpellën Hira, ai ndjeu një lloj frike, sa që kur u kthye i frikësuar në shtëpi, i tha bashkëshortes së tij, Hatixhesë: “Më mbulo, më mbulo!”⁸

Të nesërmen, Hatixheja, së bashku me Pejgamberin a.s., shkuan te Vereka ibën Neufeli, i cili ishte i afërm i Hatixhesë, por që kishte njohuri mbi fetë qiellore dhe vetë besonte te feja e Ibrahimit a.s.. Kur Pejgamberi a.s., ia rrëfeu ngjarjen Verekës, ai i tha: “Për Zotin, i Cili ka në dorë jetën time, ti je profeti i këtij ymeti dhe je profeti i fundit. Ty të ka ardhur shpallja që i ka ardhur Musait. Populli yt do të të përgënjeshtrojnë, lëndojnë, luftojnë dhe do të të nxjerrin nga qyteti. Do të doja të isha djalë i ri kur të të dëbojë populli yt. Ah, sikur të isha i ri të të ndihmoja kur të vijë ajo ditë.”⁹ Me këtë, Vereka e inkurajoi Pejgamberin a.s., për ta mirëpritur shpalljen hyjnore, e Pejgamberi a.s., në një hadith ka thënë: “Kurrë mos e shani Vereka ibën Neufelin, pasi unë e kam parë atë në Xhenet.”¹⁰

“TI JE PREJ TYRE O UKASHE!”

Është i njohur transmetimi i Pejgamberit a.s., teksa u shpjegon sahabëve të tij një hadith, në të cilin thuhet: “Më janë treguar të gjithë popujt e parakaluar. Pash profetë, të cilët ndiqeshin nga një grup njerëzish. Pash profetë të tjerë të ndjekur nga një burrë ose dy burra. Kurse profetë të tjerë ishin vetëm, pa asnjë ndjekës. Më pas, mu paraqit një turmë e zezë, të cilën e pandeha si ymetin tim. Më thanë që janë ndjekësit e Musait a.s.. Më vonë, mu paraqit një turmë e madhe njerëzish dhe më thanë që ata janë ymeti dhe ndjekësit tu. Mes tyre janë shtatëdhjetë mijë që do të hyjnë në Xhenet pa dhënë llogari.” Sahabët filluan të hamendësonin se kush mund të jenë këta. E Pejgamberi a.s., pasi që u kthye prapë, u tha atyre: “Ata që do të hyjnë në Xhenet pa llogari janë ata që nuk kërkojnë të yshten, nuk digjen (për t’u kuruar), nuk janë pesimistë dhe vetëm Zotit i mbështeten.” Në atë mexhlis qëndronte edhe Ukashe ibën Muhsini, i cili u ngrit dhe tha: “O i Dërguari i Allahut, lute Allahun që të jem prej tyre!” Pejgamberi a.s., i tha: “Ti je prej tyre o Ukashe!”¹¹

DY TË PËRGËZUAR ME XHENET

Nga ajo që u shpjegua më lart, pamë se Pejgamberi a.s., nganjëherë përgëzoi me Xhenet vetëm një person, nganjëherë një familje të tërë, e nganjëherë edhe një grup të tërë, por është rast i veçantë përgëzimi i dy personave shumë të dashur të Pejgamberit a.s., dy nipërve të tij, Hasanit dhe Husejnit, djemtë e Aliut dhe Fatimes, Allahu qoftë i kënaqur me ta!¹²

Hasani dhe Husejni ishin dy nipërit e Pejgamberit a.s., të cilët u rritën, u frymëzuan dhe u edukuan me mësimet islame në shtëpinë e Resulullahut a.s.. Ata qenë dhe mbetën simbol dhe model për të gjithë të rinjtë e sotëm.

KRAHËT FLUTURUES TË XHAFER IBËN EBI TALIBIT

Në betejën e Mutes, Xhafer ibën Ebi Talibit iu prenë të dy duart, e Allahu këtë sprovë ia kompensoi me dy krahë fluturues në Xhenet. Pejgamberi a.s., në një hadith ka thënë: “Hyra në Xhenet dhe pashë Xhaferin, fluturonte bashkë me melaqet.”¹³

MYEZINI I TË DËRGUARIT A.S., BILAL IBËN REBAHU

Një ditë, Pejgamberi a.s., e pyeti Bilalin r.a.: “O Bilal! Çfarë ke vepruar që me ke paraprirë në Xhenet? Kur hyra në Xhenet gjatë Miraxhit, dëgjova zërin e këpucëve tua.” Bilali r.a. i tha: “O i Dërguari i Allahut! Sa herë që e prish abdesin, shpejtoj dhe marrë abdes të ri dhe menjëherë fal dy rekate namaz për çdo abdes që marrë.”¹⁴

UMEJR IBËN HAMAMI DHE ABDULLAH IBËN SELAMI

Një nga të përgëzuarit me Xhenet është edhe Umejr ibën Hamami, i cili, një ditë, teksa po qëndronte me Pejgamberin a.s., e pyeti: “O i Dërguari i Allahut! A është gjerësia e Xhenetit sa e qiejve dhe e tokës?” Pejgamberi a.s., i tha: “Ashtu është o Umejr!” Umejri i tha: “Atëherë e meriton që unë ta japë jetën për ta fituar Xhenetin.” E Pejgamberi a.s., i tha: “O Umejr, ti je nga banorët e Xhenetit!”¹⁵ Një sahabi tjetër i përgëzuar me Xhenet është edhe Abdullah ibën Selami, për të cilin vetë i Dërguari i Allahut a.s., ka thënë: “Kush dëshiron ta shoh një nga banorët e Xhenetit që ecën mbi tokë, le ta shohë Abdullah ibën Selamin.”¹⁶

SAHABIU QË NUK FALI ASNJË REKAT NAMAZ

Teksa flasim për të përgëzuarit me Xhenet, flasim për modelet dhe shembujt e gjallë që duhen ndjekur. Nuk flasim vetëm për veprat e tyre heroike, por flasim edhe për atë që është më e rëndësishmja, qëllimi i pastër dhe singleriteti në raport me Allahun e Madhëruar. I tillë ishte edhe Abdullah ibën Esiremi, i cili gjatë jetës së tij, nuk fali asnjë rekat namazi, madje as nuk e njohu rukunë dhe sexhden. Por, në ditën që ai pranoi Islamit, mori pjesë në një betejë së bashku me myslimanët dhe ra dëshmorë. Kur Pejgamberi a.s., dëgjoi për këtë tha që është dëshmor dhe është në Xhenet.¹⁷

BEDUINI I PËRGËZUAR ME XHENET

Një prej të përgëzuarve me Xhenet është edhe një beduin, i cili qe takuar me Pejgamberin a.s., gjatë betejës së Hajberit,



KATËR TË PËRGËZUARAT ME XHENET

Në një hadith të transmetuar nga Pejgamberi a.s., thuhet: “Janë përsosur shumë burra, kurse nga gratë nuk janë përsosur përveçse katër prej tyre: Merjemja, vajza e Imranit, Asija, gruaja e Faraonit, Fatimja, vajza e Muhamedit a.s., dhe Hatixhe bintu Huvejlidi.”²¹

Emrat e tyre janë përmendur edhe në hadithe të tjera veçmas, nga ku cilësohen edhe si banore të Xhenetit, prej tyre përmendim: “Fatimja është pjesë e imja.”²² Atë e përgëzoi me Xhenet i Dërguari a.s., ashtu siç e përgëzoi edhe burrin e saj, Aliun r.a..

ku edhe përqafoi Islamin. Kur myslimanët e ndan plaçkën e luftës, Pejgamberi a.s., i urdhëroi ata që një pjesë të saj ta ndajnë edhe për këtë, por ky u tha: “Jo për Zotin, nuk është ky qëllimi për të cilin kam ardhur. Qëllimi për të cilin kam ardhur është që të më godasë një shigjetë mu këtu (në fyt) dhe të më dal këtu (pas shpine).” Pas një kohe, vjen një shigjetë dhe e goditi mu në vendin ku ai donte. Kur Pejgamberi a.s., e pa, pyeti: “A është ai?” Sahabët i thanë: “Po.” Pejgamberi a.s., tha: “U tregua i sinqertë me Zotin dhe Zoti ia plotësoi atë që deshi.”¹⁸

UMMU SULEJMI DHE UMMU HIRAMI

Në përgëzimet e të Dërguarit a.s., me Xhenet janë edhe Ummu Sulejmi, e cila ishte e martuar me Ebu Talhan, me të cilin kishin vetëm një djalë. Një ditë, djali i tyre u sëmurë, dhe sëmundja iu rëndua, saqë ndërroi jetë. Atë ditë Ebu Talha ishte agjërueshëm, dhe kur erdhi, pyeti menjëherë për djalin e tij. Ummu Sulejmi i tha: “Asnjëherë nuk ka qenë më mirë se tani.” Pasi që ngrëni iftar dhe fjeti me të shoqen, Ummu Sulejmi i tha: “O Ebu Talha, nëse dikush të ka dhënë diçka hua dhe pas një kohe ta kërkon sërish, çfarë do të bëje?” Ebu Talha i tha: “Do t’ia jepja menjëherë.” Atëherë Ummu Suljemi i tha: “Mbështetu tek Allahu për djalin që ta mori.” Të nesërmen kur shkoi te Pejgamberi a.s., ai i bekuar i tha: “Vetë Allahu i Madhëruar është çuditur me atë që bëtë ju mbrëmë dhe Ai ua ka bekuar këtë natë!”¹⁹

Një nga gratë tjera të përgëzuara me Xhenet është edhe Ummu Hirami, e cila teksa, Pejgamberi a.s., po qëndronte një ditë në shtëpinë e saj, tha: “Do të vij në njëherë nga ymeti im, të cilët do të sulmojnë nga deti. Ata do ta meritojnë Xhenetin.” E Ummu Hirami, i tha: “Lute Zotin që të jem edhe unë nga kjo ushtri.” Pejgamberi a.s., i tha: “Ti do të jesh prej tyre!”²⁰

Këta ishin vetëm disa prej sahabëve, që qenë përmendur me emra dhe që janë përgëzuar nga vetë i Dërguari a.s., por që Pejgamberi a.s., na ka mësuar në shumë hadithe, se si ne si besimtarë ta fitojmë Xhenetin me punët dhe veprat tona. Prej tyre përmendim derën Rejjan, që do të jetë derë nga ku do të hynë agjëruesit, për të na dhënë shembullin dhe mësimin se agjërimi është një vepër që shpie në Xhenet.

Lusim Zotin e Madhëruar që të na bëjë prej të tillëve që jemi banorë të Xhenetit!

- 1 Suneni i Ebu Davudit, nr. 4658.
- 2 Abdullah Salih el Kusarij, “Virtytet dhe të drejtat e sahabëve”, përktheu Almedin Ejupi.
- 3 Po aty.
- 4 Suneni i Ebu Davudit, nr. 4649.
- 5 Mustedrek ala Sahihejni, nr. 5691.
- 6 Sahihu i Ibën Hibanit, nr. 7159.
- 7 Sahihu i Ibën Hibanit, nr. 7014.
- 8 Sahihu i Buhariut, 3, 4.
- 9 Safijurrahman el Mubarekfurri, Lulishtja e dritave.
- 10 Mustedrek ala Sahihejn, 4233.
- 11 Sahihu i Buhariut, 5705.
- 12 Xhasim Mutava, Të përgëzuarit me Xhenet, përktheu Elmaz Fida, Furkan ISM, Shkup, 2010, f. 229.
- 13 Suneni i Tirmidhiut, nr. 3763.
- 14 Sahihu i Buhariut, nr. 1149.
- 15 Sahihu i Buhariut, nr. 7540.
- 16 Sahihu i Muslimit, nr. 2495.
- 17 Xhasim Mutava, Të përgëzuarit me Xhenet, përktheu Elmaz Fida, Furkan ISM, Shkup, 2010, f. 9.
- 18 Mustedrek ala Sahihejn, 6589.
- 19 Xhasim Mutava, Të përgëzuarit me Xhenet, përktheu Elmaz Fida, Furkan ISM, Shkup, 2010, f. 236-239.
- 20 Sahihu i Buhariut, nr. 2895.
- 21 Sahihu i Buhariut, 5418.
- 22 Sahihu i Muslimit.

Doracakët më të njohur të fikhut hanefi (7)

VEPRA “TUHFETU’L-FUKAHA” E ALAUDIN SEMERKANDIT

Hazir D. Selmani

Në shekullin e VI hixhri, në trojet semerkandase të Transoksianës (ar.: Maveraenehër) jetoj dhe veproj Alaudin Semerkandi, njëri prej personaliteteve më të rëndësishëm të fikhut dhe usulit hanefi, autori i veprës “*Tuhfetu’l-Fukaha*” (shq.: Dhurata për dijetarët e fikhut), që llogaritet si njëri prej doracakëve fikhor bazë në medhhebin hanefi për dijetarët dhe studiuesit që erdhën pas tij deri në ditët e sotme.

KUSH ËSHTË ALAUDIN SEMERKANDI?

Për jetën e tij ka pak të dhëna. Emri i tij i plotë është Ebu Bekër Alaudin Muhamed b. Ahmed b. Ali Semerkandi. Viti i tij i lindjes nuk dihet, megjithëse duke u mbështetur në vitin e vdekjes së mësuesve të tij mund të vihet në një vlerësim të përafërt për këtë gjë. Mësuesit e tij më të mëdhenj ishin vëllezërit erudit hanefi Ebu’l Usër Bezdeviu (vd. 482 h.) dhe Ebu’l Jusër Bezdeviu (vd. 493 h.) si dhe fakihu dhe akideologu i madh hanefi Ebu’l Muin Nesefiu (vd. 508 h.).¹ Nisur nga kjo, dr. Sadij vjen në një përfundim se lindja e Alaudin Semerkandit prerazi ka ngjarë para vitit 482 h., të paktën një ose dy dekada më herët se ky vit. Ndërsa, në Enciklopedinë e famshme Iranika, vihet theks se lindja e tij nuk mund të ketë ngjarë më vonë se viti 465 h..² Mbiemri i tij gjeografik “Semerkandi” tregon se ai jetoj në një mjedis islam, ku

Mbiemri i tij gjeografik “Semerkandi” tregon se ai jetoj në një mjedis islam, ku shkenca islame ishte në kulmin e saj, sidomos fikhu dhe akideja dhe shkencat e tjera bazë dhe ato ndihmëse të këtyre dy fushave të thella islame.

shkenca islame ishte në kulmin e saj, sidomos fikhu dhe akideja dhe shkencat e tjera bazë dhe ato ndihmëse të këtyre dy fushave të thella islame. Edhe për nxënësit e tij nuk dihet shumë. Në mexhlisin e tij të dijes merrte pjesë një nxënës i ditur që njihet si Kasani, i cili më vonë nga dijetarët do të njihet si *Meliku’l-ulema* (shq.: mbreti i dijetarëve). Në ndërkohë, në mexhlisin e tij privat në shtëpi ai e mësoi dhe e trajnoi si Kasanin ashtu edhe vajzën e tij Fatimen. Këtë vashë për nuse e lypën disa princër, mirëpo në vend të pasurisë dhe pushtetit zgjodhi diturinë dhe atë nuk ia dha askujt për nuse dhe zgjodhi dhe e martoi me Kasanin, nxënësin e tij më të shquar. Fatimeja ishte fakihe në nivel myftie në fikhun hanefi, saqë fetvatë kur dëlnin prej shtëpisë së tyre, ato mbanin tri nënshkrime: atë të babait të saj, të Fatimesë dhe më vonë edhe nënshkrimin e burrit të saj Kasanit, siç shënon Kurashiu në “El Xhevahir”.³ Vlen për t’u përmendur se Fatimeja e Alaudin Semerkandit ishte transmetuese e mirë e medhhebit hanefi, madje kur ndodhte që burri i saj Kasani të ngatërrohej ndonjëherë në ndonjë fetva, ishte ajo që e përmirësonte atë dhe ia ndreqte fetvanë duke i treguar se si është e sakta. E ndërsa ai pa ngurrim vepronte sipas fjalës së saj.⁴ Kasani, duke u mbështetur në librin e hoxhës së tij shkroi një libër tjetër shumë të madh dhe e mahniti edhe vetë hoxhën. Libri në fjalë mban titullin “*Bedaiu’s-Sanai*”, për të



cilin do të flitet më pastaj. Tabahu këtë personalitet të shquar hanefi e ka përfshirë në historinë e tij të famshme 7 vëllimeshe të Halepit, e që kjo d.m.th. se ai një periudhë pati jetuar edhe në Halep, përndryshe nuk do të përfshihej në fletët e kësaj veprë madhështore. Po këtë gjë e deklaroi edhe Merashliu.⁵ Ndërsa në Enciklopedinë Iranika thuhet se ai për një kohë pati qëndruar edhe në Anadoll, me theks të veçantë në Konja.⁶ Temimiu duke cituar Sem'anin jep vendin dhe vitin e vdekjes së Semerkandit në fjalë, kur thotë: Vdiq në Buhara në fillim të muajit xhumada el-ula të vitit 539 hixhri.⁷

VEPRAT E ALAUDIN SEMERKANDIT

Merashliu numëron 6 vepra të Alaudin Semerkandit.⁸ Veprat e tija të botuara tani për tani janë vetëm tri edhe atë: 1. Doracaku i tij fikhor “*Tuhfetu'l-fukaha*” (shq.: Dhurata për dijetarët e fikhut), 2. Kryevepra e tij usulore “*Mizanu'l-usul ve netaixhu'l-ukul*” (shq.: Peshorja e usuli fikhut dhe frytet e mendjeve) si dhe 3. “*Sherhu Te'vilati Ehli's-Suneh*” (shq.: Komentimi i interpretimeve të Ehlus-Sunetit). Veprat ekzistuese të Alaudin Semerkandit janë një dëshmi e gjallë për dituritë e tij të thella, si dhe për aftësitë e tija tejet të përparuara në sistemimin, organizimin dhe ofrimin e materialit shkencor në letër. Këto vepra patën ndikim të mirë dhe mjaft të theksuar në fikhun dhe usulin hanefi edhe atë për shekuj me radhë. Vepra e tij usulore ka vlerë madhështore për shkak se sipas studiuesve llogaritet libri më i mirë ekzistues i medresesë usulore të hanefive të Semerkandit, kryesues i së cilës është imam Ebu Mensur Maturidiu.⁹ Ndërsa për kontributin e tij në tefsir, pra në veprën e tij të tretë të sipërshtënëuar, e që akoma është në dorëshkrim, aty autori ka bërë një punim interesant duke u mbështetur kryesisht në shënimet shkencore që ai i merrte gjersa

prezantonte në mexhliet e mësuesit të tij Ebu'l Muin Nesefiut, gjersa ky i fundit ua komentonte tefsirin “*Te'vilat Ehli's-Suneh*” të imam Maturidiut.¹⁰ Kjo veprë është dëshmi e gjallë për dijet e tjera të tija si ato gjuhësore, akaidore, etj.. Kjo veprë lirisht mund të llogaritet si një prej burimeve më të rëndësishëm të shkollës maturidite të akides islame, kuptohet pas veprës “*Teb siratu'l-Edileh*” të Ebu'l Muin Nesefiut. Në këto vepra të sipërpërmendura autori jep shenjë edhe për disa vepra të tjera të tija, për të cilat nuk dihet gjë tjetër veç emrit të tyre si: “*Sherhu't-Tekvim*”, pastaj për një libër tjetër në usuli fikh, “*Sherhu't-Tahavi*” dhe “*El Mebsut*”.¹¹ Njashtu duhet vëmendje e veçantë me burimet e jetëshkrimit të dijetarëve si dhe në burimet bibliografike, ngase në të njëjtën periudhë dhe vend vepruan dy emnakë të shquar hanefi, pra edhe Alaudin Semerkandi (?-539 h.) për të cilin flasim, por edhe Alaudin Semerkandi Usmendi (488-552 hixhri) dhe nganjëherë disa vepra të këtij të fundit gabimisht i atribuohen Alaudin Semerkandit, autorit të *Tuhfes-së*, vjehrrit të Kasanit. Habitshëm dhe për ngatërrim të dytë kanë nga një libër me titull të ngjashëm në usuli-fikhun e hanefive. Alaudini për të cilin flasim ka librin “*Mizanu'l-usul fi netaixhi'l-ukul fi usuli'lfikh*”, ndërsa Alaudini i dytë ka veprën “*El-Mizan fi usuli'l-fikh*”.

DORACAKU FIKHOR I ALAUDIN SEMERKANDIT

Vepra “*Tuhfetu'l-fukaha*” ose në shqip “Dhurata për dijetarët e fikhut” është shkruar pas kërkesës së ca miqve të Alaudin Semerkandit. Kjo veprë, gjithnjë sipas hyrjes së vetë autorit, është një rishkrim i Kitabit të Kuduriut me ca shpjegime dhe shtesa të nevojshme në mesele të papërmendura nga Kuduriu. Njashtu këtu Semerkandi ka bërë edhe sqarim të disa ngatërresave dhe ndërlikimeve fikhere si dhe bukur mirë ka përdorur edhe argumentime. Tërë këtë e ka bërë me një stil tejet të veçantë ndarës të kapitujve, nënkapitujve, e kështu me radhë. Me fjalë të tjera është një lloj zgjerimi i Muhtesarit të Kuduriut.¹² Për kohën që u shkrua, kjo veprë doli një libër shumë i përparuar në ristikurim, renditje, terminologji dhe terme medhheboe. Si libër fikhu përfshinë tërë kapitujt e fikhut, pra është doracak i plotë. Deri më tani ka pasur disa ribotime, në të shumtën e rasteve është botuar në tri vëllime. Botimi më i mirë sipas vlerësimit të shejh Abdulxhelil el Ata (fakih i madh hanefi i Damaskut) është ai i Universitetit të Damaskut, i shtypur në tri vëllime në vitin 1958.¹³ Kjo veprë citohet bukur shumë në librat e mëvonshëm të fikhut hanefi të zhanreve *Esh shuruh* dhe *El havashi*. Saqë vetëm në Hashijen e famshme të Ibën Abidinit, sipas llogaritjeve tona, citohet diku mbi 70 herë. Prej këtij doracaku në gjuhën shqipe deri më tani (viti 2025) nuk ka diçka të botuar në shqip, edhe pse është përfolur se pjesa e parë e tij (Ibadat) është përkthyer në Maqedoni, porse akoma nuk është botuar. Kjo veprë shikuar

nga këndvështrim i komenteve mund të llogaritet doracak (ar. *el-metën*), ngase për të ka të paktën një koment të shkruar, e pra nisur nga kjo ai mund të renditet në mesin e doracakëve të komentuar rrallëherë.

KOMENTET (EL SHURUH) E DORACAKUT FIKHOR TË ALAUDIN SEMERKANDIT

Për sa i përket numrit të komenteve të këtij doracaku, në burimet bibliografike haset vetëm një koment i tij. Fjala është për kryeveprën fikhore hanefite me titull “*Bedaiu’s-Sanai*” si dhe shekuj më vonë u shkruan edhe dy-tre libra të tjerë shumë më të vegjël, duke u mbështetur në këtë koment. Prandaj, kushtimisht mund të thuhet se koment i *Tuhfe-së* në mënyrë të drejtpërdrejt është vetëm një dhe tërthorazi shtohen edhe tri komente të tjera¹⁴, edhe atë:

1. Komenti i dhëndrit të tij Alaudin Kasanit me titull “*Bedaiu’s-Sanai*”. Në realitet kjo vepër gjigante e fikhut hanefi nganjëherë llogaritet edhe si libër i pavarur dhe jo koment, ngase nuk ka stilin e zhanrit të njohur të veprave fikhore *el shuruh*. Mirëpo, po të krahasohet materiali i *Tuhfe-së* me tekstin e këtij komenti vërehet se Kasani bukur mirë e ka përfshirë dhe qëndisur e zgjeruar me analiza, argumente e debate tekstin e *Tuhfe-së*. Tërë këtë Kasani e bën aq mjeshtërisht me një sistemim dhe strukturim tejet të përparuar gjatë ofrimit të tekstit dhe diskutimeve fikhore. Realisht, është kryevepër e hanefive si për nga sasia e materialit ashtu edhe për nga cilësia e tij. Këtij libri kryevepër nuk i gjendet shoqi në asnjë medhheh. Ai është libri më unik në tërë medhhebin tonë hanefi. Thuhet se ky libër qe “mehri” (paja) që Kasani ia dhuroi nuses së tij Fatimesë për martesën e tyre, prandaj jo më kot figuron thënia e njohur rreth tij: “... shpjegoi *Tuhfenë dhe martoi Fatimenë*.”¹⁵ Ibën Abidini, njëri ndër dijetarët hanefi më të autoritetshëm e vlerëson kështu: “*Libri El Bedaië është me vlerë të madhe; nuk kam parë libër tjetër të ngjashëm me të në librat tanë. Ai është shkruar nga imam Ebu Bekër b. Mesud b. Ahmed Kasani, ku ka bërë një komentim të veprës Tuhfetu’l-Fukaha të mësuesit të tij Alaudin Semerkandi.*” Ibën Abidini gjithashtu thotë: “*Tuhfe-ja është libër i imam Muhamed Semerkandit, të cilin libër e ka komentuar nxënësi i tij Kasani me një koment të madh që e ka titulluar El Bedaië.*”¹⁶ Vepra e Kasanit në librat e zgjeruar *el shuruh* dhe *el havashi* citohet me të madhe. Kjo vepër deri më tani ka pasur disa botime. Së fundmi pritet të shohë dritën e botimit diku në 16 vëllime me recensurë të dr. Said Bekdashit, studiuesit të madh sirian hanefi. Shekuj më vonë mbi komentin e Kasanit u shkruan të paktën edhe tre libra të tjerë në stil *muhtesar* (përmbledhje)¹⁷, e që tërthorazi mund të llogariten edhe si komente të vetë *Tuhfe-së*. Ata janë:

1.1. *Zadu’l-Garibi’d-dai min Bedai’s-Sanai* (shq.: Furnizimi i kurbetçit të humbur me (veprën) Bedai’s-Sanai). Autori i këtij muhtesari (përmbledhjeje) është Muhamed b. Muhamed

Radini Hyseni Hanefiu (vd. 925 h.). Dorëshkrimi në fjalë ruhet në Bibliotekën e Ajasofias me numrin rendor 1209 dhe ka rreth 1 mijë fletë të lexueshëm lehtë.

1.2. *Muxherradu’l-Bedai ve mulehasu’sh-sheraië* (shq.: Thelbi i veprës El Bedaië dhe përmbledhja e rregullave sheriatike të saj). Autori i këtij muhtesari është një dijetar me emrin Shah Muhamed b. Ahmed b. Ebi Suud el Manastiri el Siddiki (vd. 1052 h.). Mbiemri i tij “El-Manastiri” që rrjedh nga Manastiri në Maqedoninë Veriore hedh dritë për një figurë të madhe me prejardhje nga trojet tona për të cilin fort pak dihet. Ky dijetar ka edhe një koment të shkëlqyer mbi *Multeka-në* e Ibrahim Halebiut me titull “*Muntehe’l-Enhur*”.¹⁸

1.3. Shënime anësore mbi librin *Bedaiu’s-Sanai*, me autor Muhamed Dede Sabir Parsa Galipoli (vd. 1147 h.).

(Vijon)

- 1 Për të vërtetuar këto shiko: Alaudin Semerkandi, *Mizanu’l-usul* (Aman: Daru’l-Fet’h, 2017, botimi II), vëll. 1, f. 583; Abdulhaj Leknevi, *El Fevaidu’l-Behijeh*. (Kajro: Daru’l-kitabi’l-islamij, 1924), f. 158.
- 2 Shiko: Abdulmelik Sa’di në hyrjen studimore të veprës së para cituar *Mizanu’l-usul*, vëll. 1, fq. 20; Grup autorësh, *Encyclopaedia Iranica*, (Londër: Routledge & Kegan Paul, 1985), vëll. 1, fq. 782.
- 3 Abdulkadër Kurashi, *El Xhevahiru’l-Mudijeh fi tabekati’l-hanefijeh*. (Hajderabad: mexhlisu dairati’l-meaarif, 1914), vëll. 2, f. 277.
- 4 Po aty, vëll. 2, f. 278.
- 5 Muhamed Ragib Tabah, *Ib’lamu’n-Nubela bi Tarihi Haleb El-Shehbaë*, (Halep: Daru’l-kalemi’l-arabij, 1989), vëll. 4, f. 250; Jusuf Mer’ashli, *Mesadiru’d-Dirasati’l-islamijeh*, (Bejrut: daru’l-kutubi’l-ilmijeh, 2020, botimi I), vëll. 1, f. 263.
- 6 *Encyclopaedia Iranica*, vëll. 1, fq. 782.
- 7 Tekijudin Abdulkadir Temimi, *El Tabekatu’s-Senijeh fi teraxhimi’l-hanefijeh (dorëshkrim)*, (Stamboll: Biblioteka Nuruothmanijeh, dorëshkrim me nr. 3390), f. 298b.
- 8 *Mesadiru’d-Dirasati’l-islamijeh el-fikhu’l-hanefiju furuan ve usulen*, vëll. 1, f. 263-264.
- 9 Hejthem Hazineh, *Tetavuru’l-fikri’l-usuli’l-hanefij*. (Aman: Universiteti Al el Bejt, 1998, tezë masteri), f. 49.
- 10 Shiko: Alaudin Semerkandi, *Sherhu’t-Te’vilat (dorëshkrim)*. (Stamboll: Biblioteka Hamidijeh, dorëshkrim me nr. 176), f. 2a.
- 11 Shiko: Alaudin Semerkandi, *Tuhfetu’l-Fukaha* (Doha: Idaratu Ihjai’t-Turathi’l-islamij, 1987, botimi II), vëll. 1, f. 34 dhe vëll. 1, f. 298. Pastaj shiko: Alaudin Semerkandi, *Mizanu’l-usul* (Doha: Idaratu Ihjai’t-Turathi’l-islamij, 1984, botimi I), f. 6; f. 54 dhe f. 76.
- 12 Shiko: Alaudin Semerkandi, *Tuhfetu’l-Fukaha* (Damask: Universiteti i Damaskut, 1958, botimi I), vëll. 1, f. 2; Katip Çelebi, *Keshfu’dh-Dhunun an esamij el kutubi ve’l-funun*. (Londër: Al-Furqan Foundation, 2021), vëll. 2, f. 410; Abdullah Habeshi, Jusuf Mer’ashli, *Mesadiru’d-Dirasati’l-islamijeh*, (Bejrut: daru’l-me’arif, 2017, botimi I), f. 153.
- 13 Abdulxhelil el Ata el Bekri, *El-Hajru’l-Bakii fi tahkiki’l-Meraki* (Damask: Daru’n-Nu’man li’l-ulum, 2007, botimi II), vëll. 1, f. 299.
- 14 Për këta komente shiko: *Keshfu’dh-Dhunun*, vëll. 2, f. 410-411; *Xhamiu’sh-Shuruh ve’l-havashi*, vëll. 2, f. 86-87.
- 15 *El Xhevahiru’l-Mudijeh fi tabekati’l-hanefijeh*, vëll. 2, f. 244.
- 16 Ibën Abidin, *Radu’l-Muhtar ale’d-Durri’l-Muhtar* (Bejrut: Daru’l-Fikër, 1979, botimi II), vëll. 1, f. 100 dhe vëll. 1, f. 265.
- 17 *Xhamiu’sh-Shuruh ve’l-havashi*, vëll. 2, f. 86-87.
- 18 Ismail Pashë Bagdadi, *Hedijetu’l-arifin*, (Stamboll: Vekaletu’l-meaarifi’l-xhelijeh, 1951), vëll. 2, f. 281.

MOSHA E MARTESËS

HISTORIA E MARTESËS SË PROFETIT A.S. ME AISHEN R.A.

Hajrudin S. Muja

Jomyslimanët shpesh ngrenë pyetjen se sa ka qenë mosha e hasreti Aishes r.a., gjatë kohës kur u shpall fejesa dhe gjatë kohës kur ajo erdhi në shtëpinë e Profetit a.s.. Kjo për ta “akuzuar” Profetin a.s., se gjoja u martua me një vajzë “të mitur” duke i mbetur “besnik” një burimi, në të cilin pohohet se gjatë shpalljes së fejesës, ajo ka qenë 6 vjeçare, kurse në kohën kur filloi bashkëjetesën me Profetin a.s. ka qenë 9 vjeçare. Imam Nedeviju në “Biografia e Aishes”, thotë se në kohën e martesës, ajo ishte ndërmjet moshës 14 dhe 15 vjeçare. Imam Taberiu në “Tarijkh”, thotë se Aisheja ishte lindur në periudhën paraislame. Ibën Kethiri në “El Bidajeh”, thotë se duhej të ishte 19 ose 20 vjeçare. Koleksionisti i “Mishkat el Mesabijh”, thotë se ishte jo më e re se 18-19 vjeçare.

Kohëve të fundit është bërë një studim nën mbikëqyrjen e profesorit të Oksfordit - Christopher Melchert, një ekspert me famë botërore në studimet islame, që hedh dritë mbi “gruan e mitur” të Muhamedit a.s. dhe sjçon se historia e martesës së Profetit të Islamit me një “të mitur” është propagandë e pabazë dhe sajuar për motive politike dhe sektare. Merita e këtij studimi bie mbi prof. Joshua Little, i cili pjesën më të madhe të kohës ia ka kushtuar studimeve të teksteve të vjetra dhe ka dalë me rezultate që mund të ndryshojnë kuptimin tonë për historinë islame. Duke ju referuar “International Center for Research on Women”, Little thotë se “asnjë përkatësi fetare nuk ishte e lidhur me martesën e fëmijëve”, prandaj vënia në shënjestër e një feje të caktuar nëpër vende nuk është një mënyrë efektive për të adresuar martesën e hershme. Megjithatë, ndërsa martesa e fëmijëve është relativisht e pazakontë në pjesën më të madhe të botës islame, feja ndërvepron me kulturën në mënyra komplekse dhe, të paktën në disa rajone me shumicë myslimane, Islami thirret për të racionalizuar

praktikën. Argumenti fetar është bërë se Muhamedi a.s. ishte shembulli ideal i njeriut dhe si i tillë, çdo gjë që ai bënte duhet të konsiderohet moralisht e pranueshme.

Sidoqoftë, pas analizimit të të gjitha versioneve të ndryshme të raportit martesor të Aishes r.a., Little arrin në përfundimin se *hadithi* që pretendon moshën 9 vjeçare të saj, ishte fabrikuar nga një transmetues i quajtur Hisham ibën Urva (680-763), pasi ai ishte zhvendosur në Irak midis viteve 754 dhe 755 të erës sonë, që do të thotë një shekull pas vdekjes së Profetit Muhamed (632) dhe rreth 1600 kilometra larg nga qyteti arab i Medinës, ku do të kishte ndodhur martesa. Përveç kësaj siç rezulton,



fabrikimi i shërbeu qëllimeve të dallueshme sektare dhe politike. Ajo që e bën të veçantë studimin e Little-s është argumentimi nga këndvështrimi rigoroz akademik. Little vëren mungesën e raporteve të moshës martesore në burimet më të hershme, duke përfshirë disa vepra kryesore biografike dhe ligjore. Ibën Is'haku (704-768) - biografi më i njohur i Muhamedit - nuk tha asgjë për moshën e martesës së Aishes. Megjithatë, detajet u shtuan më vonë nga historiani Ibën Hishami (vdiq më 833).

Ndoshta edhe më interesant është fakti që hadithi i moshës martesore mungon në koleksionet më të hershme juridike medinase, duke përfshirë El Muvetan e Imam Malikut (711-795), edhe pse ky i fundit citon Ibën Urven dhjetëra herë. Siç shkruan Little: “Dështimi i Malikut për të cituar këtë hadith sugjeron jo thjesht se Maliku e refuzoi atë, por se ai nuk qarkullonte në Medine në atë kohë. Kjo posaçërisht duke pasur parasysh se hadithi i moshës martesore ka degëzime të rëndësishme ligjore, dhe kështu me siguri do të kishte kërkuar përfshirjen në një përmbledhje të dedikuar medinase të hadithit ligjor medinas.”

Hadithi mungon gjithashtu nga status kodi “El Mudavana”, një koleksion proto-Maliki i transmetimeve ligjore medinase. Little thotë se vepra më e hershme e Malikut për të cituar ndonjë version të hadithit të moshës martesore u shfaq “gati tre shekuj pas përhapjes fillestare masive të hadithit në Irak”. Me pak fjalë, martesë e hershme e Aishes mungon në burimet kryesore të hershme në qytetin ku ka ndodhur ngjarja. Duke përdorur argumentin e mungesës së këtij raporti në burimet e hershme, Little arrin në përfundimin se kjo ishte një histori e shpikur në Irakun e shekullit VIII dhe vetëm më vonë e riprojektuar në historinë e jetës së Muhamedit a.s..

E lëmë studimin e Little-s për t’ju referuar studimeve të tjera se si ka qenë raporti i shoqërive të tjera në lidhje me “martesat e fëmijëve”. Një martesë e tillë ishte krejtësisht normale dhe e pranueshme për Arabinë e shekullit VII dhe në shumë shoqëri të tjera

Ndoshta edhe më interesant është fakti që hadithi i moshës martesore mungon në koleksionet më të hershme juridike medinase, duke përfshirë El Muvetan e Imam Malikut (711-795), edhe pse ky i fundit citon Ibën Urven dhjetëra herë.

përgjatë historisë, përfshirë edhe atë të krishterë. Mosha e martesës ishte e përcaktuar sipas pjekurisë biologjike të sistemit shoqëror, dhe jo sipas standardeve moderne. Mund ta ilustronim me disa shembuj nga historia e krishterimit që dëshmon se kjo nuk ishte unike vetëm për Islamin. Ne mund t'i referohemi R.G. Bhandarkar¹ dhe Shenila Khoja-Moolji² për të shprehur martesat që janë bërë nën moshën dhjetë vjeçare.

Princesha franke Gisela u martua në moshën pesë vjeçare me vikingun Rollo në vitin 911. Djali i mbretit të frankëve (987-996) Roberti i II-të i mbiquajtur “i shenjtë” (972 – 1031) u martua me vajzën italiane Riozala ku ajo ishte vetëm tetë vjeçare. Eleonora e Anglisë ishte nëntë vjeçare kur u martua me Alfonsin e III-të të Kastiljes në vitin 1170. Agnes e Francës ishte tetë vjeçare kur u martua me Aleksin e II-të Komnenin në vitin 1180. Elizabeta e Kumanit ishte tetë vjeçare kur u martua me Stefanin e V-të të Hungarisë në vitin 1253. Elizabeta de Badlesmere ishte tre vjeçare kur u martua me Edmund Mortimer në vitin 1316. Kontesha Katharine Montimer ishte pesë vjeçare kur u martua me fisnikun anglez Thomas Beauchamp në vitin 1319. Joanna, vajza e Edwardit të II-të të Anglisë dhe Isabelës së Francës u martua në moshën shtatë vjeçare me Davidin e II-të të Skotlandës në vitin 1328. Elizabeta de Bohun ishte nëntë vjeçare kur u martua me Richard Fidsalan me 1359. Elizabeta e Bohemisë ishte shtatë vjeçare kur u martua me Albertin e III-të të Austrisë. Marie Brittany ishte pesë vjeçare kur u martua me John Perche në vitin 1396. Mbreti Rikardi i II-të i Anglisë (1367-1400) u martua me Isabelën (Valois) e Francës kur ajo ishte gjashtë vjeçare në vitin 1396. Margareta Beaufort ishte shtatë vjeçare kur u martua me John de la Pole në vitin 1450. Henri i VIII-të (1500) është martuar me Catherine Howard - një vajzë gjashtë vjeçare, e cila ishte më e re se vajza e tij Marije Tudor. Vajza aristokrate japoneze – Tamahime ishte tre vjeçare kur u martua me samurain japonez Maedea Toshitsune në vitin 1601. Princeza Rojale – Marija, në moshën nëntë vjeçare u martua me princin e Orange's – Williamin e II-të në vitin 1641.

Marie Adélaïde e Savojës ishte 12 vjeçare kur u martua me 15 vjeçarin Louis (1697), trashëgimtarin e Francës, martesë që krijoi një aleancë politike.³ Anandibai Joshi (mjekja e parë indiane e mjekësisë perëndimore) u martua në moshën nëntë vjeçare me Goparlao Joshi në vitin 1874.⁴ Mrinalini Devi u martua në moshën nëntë vjeçare me Rabindranat Tagorën në vitin 1883.⁵

A nuk është qesharake se si mënjanohej këto fakte historike dhe si i mvëshën martesës së Profetit a.s. me Aishen r.a. për ta bërë problem madhor?! Përgjatë Evropës mesjetare, martesat e fëmijëve ishin të shumta dhe të zakonshme. Kjo nuk hynte në kategorinë e shfrytëzimit, por reflektonte në realitetin e kohës së asaj bote. Fiksimi të Profeti Muhamed a.s., injoron kontekstin global historik. Gjykimi i praktikave antike me normat moderne është josingëritet intelektual, si evolvim shoqëror dhe ngjanë qëllimisht që myslimanët të kritikohen për “martesa të fëmijëve” 1400 vjet më parë, ndërkohë që mijëra të krishterë që kanë bërë të njëjtën gjë, të mos përmenden fare. Prandaj, nëse do të “akuzonim” Profetin Muhamed a.s. për ndonjë “papërshtatshmëri” në martesën tij me Aishen (!) për shkak të moshës së saj, do të na duhej të dënojmë Dhiatën e Vjetër, Dhiatën e Re, Evropën dhe shumë shtete amerikane.

Shumica e feve të praktikuara gjatë historisë kanë vendosur një moshë minimale për martesë. Në vendet hebraike për shembull, ishin rabinët ato që përcaktonin moshën madhore, meshkujt nuk mund të hynin në martesë derisa të mbushnin moshën 13 vjeçare e një ditë dhe të kishin kaluar pubertetin. Të njëjtat rregulla vlenin edhe për femrat, përveçse mosha e tyre ishte 12 vjeç e një ditë. Martesat e vajzave të reja me burra të moshuar konsideroheshin prostitucion. Vajza midis moshës 3 dhe 12 vjeç e një ditë ishte “ketannah” një moshë brenda së cilës babai ishte subjekt i autoritetit të saj dhe ai mund të organizonte një martesë për të pa pëlqimin e saj.

Ligji kanunor i krishterë ndalonte martesën e një vajze përpara fillimit të pubertetit. Megjithatë, Enciklopedia Katolike na jep një raport në lidhje me Marinë, nënën e Jezusit: “... priftërinjtë njoftuan nëpërmjet Judeas, që ata dëshiruan të gjejnë në Juda një burrë të respektueshëm që të martojnë Marinë me të, e cila atëherë ishte nga 12 apo 14-vjeçare. Jozefi, i cili në atë kohë ishte nëntëdhjetë vjeç, shkoi në Jerusalemin bashkë me kandidatët e tjerë; një mrekulli zbuloi që Perëndia kishte bërë zgjedhjen e Jozefit dhe pas dy vitesh, u bë shpallja.”⁶

Në shekullin XII, Kisha Katolike Romake ndryshoi në mënyrë drastike standardet ligjore për pëlqimin martesor, duke lejuar vajzat mbi 12 vjeç dhe djemtë mbi 14 vjeç të martoheshin pa miratimin e prindërve të tyre, edhe nëse martesa e tyre ishte bërë në mënyrë klandestine. Studimet e famullisë kanë konfirmuar se në periudhën e mesjetës së vonë, femrat ndonjëherë martoheshin pa miratimin e



prindërve të tyre në Angli.⁷ Brenda Kishës Katolike, përpara Kodit të së Drejtës Kanonike të vitit 1917, mosha minimale për një fejesë të pazgjdhshme (*sponsalia de futuro*) ishte 7 vjet për të kontraktuarit. Mosha minimale për një martesë të vlefshme ishte puberteti, ose nominalisht 14 për meshkujt dhe 12 për femrat. Kodi i të Drejtës Kanonike të vitit 1917 rriti moshën minimale për një martesë të vlefshme në 16 vjeç për meshkujt dhe 14 për femrat. Një Konferencë Peshkopësh mund të miratonte një moshë më të lartë për martesë, por në atë rast, mosha më e lartë krijonte vetëm një pengesë ndaluese, domethënë, një martesë që përfshinte një nuse ose dhëndër mbi moshën minimale të Kishës, por nën atë të caktuar nga Konferenca, ishte e vlefshme, por e paligjshme.

Në ligjin klasik islam, përshtatshmëria për marrëdhëniet martesore kushtëzohej nga pjekuria fizike (bulugh) dhe pjekuria mendore (rushd). Juristët klasikë nuk përcaktuan një moshë minimale për martesë, sepse ata nuk besonin që pjekuria arrihej nga të gjithë në një moshë të caktuar. Andrea Büchler dhe Christina Schlater vërejnë se: “mosha e martesës sipas ligjit klasik islam përkon me shfaqjen e pubertetit. Nocioni i pubertetit i referohet shenjave të pjekurisë fizike, siç është lëshimi i spermës ose fillimi i menstruacioneve”⁸

Shkollat tradicionale të jurisprudence islame (medhhebet) e përcaktojnë moshën e zotësisë së plotë juridike për të lidhur martesë: shafitë dhe hanbelitë - 15 vjeç për vajza dhe për djem; malikitë - 17 për meshkuj dhe për vajza; hanefitë 12-18 për djem dhe 9-17 për vajzat.

Në qytetërimet e lashta dhe mesjetare, ishte një praktikë e zakonshme që vajzat të martoheshin sapo të arrinin pubertetin, nëse jo më herët. Kjo praktikë vazhdoi gjatë gjithë mesjetës, dhe shumica e vajzave u martuan në moshën pesëmbëdhjetë vjeçare.⁹ Në ligjin Romak, mosha madhore varionte nga 20 deri në 30 vjeç, por që martesat ishin të kufizuara nga 12 vjeç për vajza dhe nga 14 vjeç për djem, ndërkohë që fejesa mund të bëhej nga mosha 7 vjeçare për të dy gjinitë.¹⁰ Po kështu edhe në Kinën Perandorake, martesa

e fëmijëve ishte normë. Tekstet e vjetra hinduiste (Rigveda, Atharvaveda, Dharmaśāstra, Manusmriti, etj.) kanë vargje të caktuara që tregojnë se gjatë periudhës Vedike, vajzat martoheshin para se të arrinin pubertetin pasi ato konsideroheshin të pjekura. Një baba konsiderohej se i ka bërë padrejtësi vajzës së tij nëse ai nuk arrinte ta martonte atë para pubertetit dhe nëse vajza nuk martohej në më pak se tre vjet pas arritjes së pubertetit. Në një letër drejtuar një miku amerikan në shekullin XIX, Roy përshkroi argumente kritike përse martesë e fëmijëve në kulturën hindu ekzistonte në atë kohë. Ai iu referua në mënyrë të ndërsjellë “martesës së fëmijëve” dhe “martesës së foshnjave”, dhe megjithëse ai kurrë nuk përcaktoi asnjërin term, ai raportoi se 10% e vajzave dhe 3% e djemve të moshës 8 vjeç e poshtë ishin të martuar në kohën e tij të shkrimit, por në të njëjtën kohë, Roy shpjegoi se mosha e pëlqimit për martesë në Angli ishte po aq e ulët - 12 vjet për vajzat dhe 14 vjet për djemtë - një largim i konsiderueshëm nga mosha madhore e Anglisë prej 21 vjeç në atë kohë.

Në Angli, si pjesë e ligjit për përdhunimit, Statuti i Westminsterit i vitit 1275, ishte një kundërvajtje “rrëmbyese” një “vajzë brenda moshës”, qoftë me ose pa pëlqimin e saj. Fraza “brenda moshës” u interpretua nga juristi Sir Edward Coke për të nënkuptuar moshën e martesës, e cila në atë kohë ishte 12 vjeç dhe marrëdhëniet seksuale me to u kriminalizuan. Një ligj i vitit 1576 vendosi dënime më të rënda për përdhunimin e një vajze për të cilën mosha e pëlqimit ishte vendosur në 10 vjet.¹¹ Kjo moshë qëndroi për një kohë të gjatë edhe në Kaliforni që ndalonin marrëdhëniet seksuale nën moshën 10 vjeç, duke ndjekur statutin anglez të 1576. Dispozitat e Kodit civil anglez të vitit 1753 u bënë moshat minimale të martesës edhe në Amerikën koloniale.¹² Juristi anglez Sir William Blackstone (1723-1780), në librin “Një analizë e ligjeve të Anglisë”, të botuar në vitin 1766 tregon se në ligjin e kohës së tij në Angli vajzat mund të martoheshin në moshën shtatë vjeçare.¹³

Përpara Revolucionit Industrial (para 1760), gratë në mbarë botën martoheshin shpesh në moshë të re, zakonisht menjëherë

Nëse e marrim
“të saktë”
moshën “9
vjeçare” të
Aishes r.a., në
kohën e
martesës, sipas
ligjeve të
ShBA-ve kjo
martesë edhe
sot mund të
konsiderohet e
vlefshme. Për
shembull, në
Nju
Hampshire,
mosha e lejuar
për vajzat
është 13, me
pëlqimin e
prindërve. Në
Massachusetts,
mosha e
lejimit për
vajzat është 12
me pëlqimin e
prindërve.

pas arritjes së pubertetit. Këto praktika u përhapën edhe në shekullin XIX në shoqëritë me popullsi kryesisht rurale. Burrat prireshin të martoheshin më vonë në shoqëritë ku pritej që një çift i martuar të krijonte një familje të tyren. Kjo i inkurajoi burrat të qëndronin të pamartuar derisa të tubonin pasuri të mjaftueshme për të mbajtur një shtëpi të re dhe për t’u martuar me vajza adoleshente. Në Francë, deri në Revolucionin Francez (1789-1799), mosha e martesës ishte 12 vjeç për femrat dhe 14 për meshkujt. Legjislacioni revolucionar në 1792 e rriti moshën në 13 vjeç për femrat dhe 15 për meshkujt. Sipas Kodit të Napolonit në 1804, mosha e martesës ishte 15 vjeç për femrat dhe 18 vjeç për meshkujt.¹⁴ Sipas ligjit të vitit 1871, dënimi për një marrëdhënie seksuale me një vajzë nën moshën e pëlqimit në Delaware ishte vdekja.¹⁵ Kjo moshë që deri atëherë kishte qenë dhjetë vjeç u ul në moshën 7 vjeç.¹⁶ Më 1880, 37 shtete caktuan moshën e pëlqimit në 10 vjet, kurse 10 shtete caktuan moshën e pëlqimit në 12 vjet. Në fund të shekullit XIX, një “Social purity movement” (lëvizje e pastërtisë shoqërore) e përbërë nga grupe të reformës feministe të krishtera, filloi të mbështeste një rritje të moshës së pëlqimit në 16 vjeç, me synimin për ta rritur atë përfundimisht në 18. Deri në vitin 1920, 26 shtete kishin një moshë pëlqimi prej 16 vjeç, 21 shtete kishin një moshë pëlqimi 18 vjeç.

Profesori i historisë në Universitetin e Kolorados Veriore në Greeley - Nicholas L. Syrett, ka botuar librin “American Child Bride - A History of Minors and Marriage in the United States” (2016), përmban plot rrëfime dhe anekdota rreth vajzave të reja deri në 9 vjeçare që janë martuar me burra shumë më të vjetër. Libri gjurmon evolucionin e martesës së fëmijëve nga koha koloniale e deri më sot dhe tregon për zonat e varfra rurale të vendit, ku praktika ka qenë gjithmonë më e zakonshme se zonat e pasura urbane. Studiuesit e sociologjisë janë fokusuar pothuajse ekskluzivisht në martesën e fëmijëve në Jugun Global në kurriz të të kuptuarit të martesës së fëmijëve në Veriun Global, gjë që argumenton përforcimin e narrativave raciste dhe ksenofobike duke e paraqitur martesën e fëmijëve si një problem social joperëndimor.



Hulumtimet mbi martesën e fëmijëve në ShBA përqendrohen në pasojat dhe jo në shkaqet e martesës së fëmijëve, të cilat mund ta zhvendosin fokusin nga një kuptim strukturor, se si pabarazitë e kryqëzuara formojnë gjasat e vajzave për t'u martuar si të mitura.¹⁷

Nëse e marrim “të saktë” moshën “9 vjeçare” të Aishes r.a., në kohën e martesës, sipas ligjeve të ShBA-ve kjo martesë edhe sot mund të konsiderohet e vlefshme. Për shembull, në Nju Hampshire, mosha e lejuar për vajzat është 13, me pëlqimin e prindërve. Në Massachusetts, mosha e lejimit për vajzat është 12 me pëlqimin e prindërve. Në Kaliforni dhe Misisipi, nuk ka një kufi minimal për moshën e lejimit të vajzave, për sa kohë që të jetë i pranishëm pëlqimi i prindërve.¹⁸ Sipas të dhënave të përpiluara nga Anjali Tsui, Dan Nolan dhe Chris Amico, të gjithë shikuan 200,000 raste të martesës së fëmijëve nga 2000 deri në 2015: 67% e fëmijëve ishin 17 vjeç; 29% e fëmijëve ishin 16 vjeç; 4% e fëmijëve ishin 15 vjeç; më pak se 1% e fëmijëve të moshës 14 vjeç e poshtë; ka pasur 51 raste të martesës së 13-vjeçarëve dhe 6 raste të martesës së 12-vjeçarëve.¹⁹ Sipas një burimi tjetër, deri në vitin 2018 numri i fëmijëve që u martuan në ShBA arriti në 300.00.²⁰

Për ndryshe, a mund të mendojmë se një vajzë “viktimë e një pedofilie” mund të bëhej më pas, si asnjë tjetër, një nga dijetaret më të shquara islame? Ajo ishte gruaja e tretë dhe më e re e Profetit a.s., bija e njeriut më të afërt të Profetit - Ebu Bekrit r.a.. Ajo i tregoi botës se si gruaja mund të ishte më e ditur se burrat, se politikanët apo se luftëtarët katërmëdhjetë shekuj më parë. Kishte një mendje të shkëlqyer dhe një kujtesë të jashtëzakonshme. Ajo kontribuoi në përhapjen e mesazhit të Profetit a.s. dhe i shërbeu komunitetit mysliman për 44 vjet pas vdekjes së të Dërguarit të Allahut a.s.. Ajo ishte

e përfshirë në çështje fetare dhe ngjarje politike gjithashtu, por edhe njohëse e transmetimit të 2210 haditheve.

Në botëkuptimin e sotëm, pasojat e zakonshme të martesës së fëmijëve përfshijnë një rrezik më të madh për sjellje të pahijshme abuzimi seksual, trauma psikologjike, rrezik për vdekje ose lëndim gjatë lindjes së fëmijës dhe një gjasë për të braktisur shkollën.²¹ “Journal of Global Health”²² ka një studim që shpjegon anët negative të këtyre martesave, për lindjet e padëshiruara dhe ndërprerjen e shtatzënisë, për braktisjen e shkollës, për infektim me sëmundje, etj.. Ndërsa është raportuar se deri në vitin që shkoi (2024) në botë ka pasur 61 milionë martesë të fëmijëve²³, ose 650 milionë vajza e gra, të cilat janë martuar nën moshën 18 vjeçare²⁴, nga “opozita” janë paraqitur edhe mendime pozitive, se martesat e tilla ndikojnë në zgjidhjen e problemit të shturjes së adoleshentëve, në parandalimin e shtatzënisë dhe trajtimin e çështjeve të shtatzënie jashtëmartesore.²⁵

- 1 R.G. Bhandarkar: “*History of Child-Marriage*”, në “*Zeitschrift der Deutschen Morgenländischen Gesellschaft*”, Vëll.47, Nr.1, 1893, f.143-156.
- 2 Shenila Khoja-Moolji: “*Girls, Education, and Narratives of Progress: Deconstructing the Discourse on Child Marriage*”, ImprintRoutledge 2015.
- 3 Geoffrey Symcox: “*Victor Amadeus II: absolutism in the Savoyard State, 1675-1730*”, University of California Press 1983.
- 4 Caroline Healey Dall: “*The Life of Dr. Anandabai Joshee*”, Boston 1888.
- 5 *The Better India*. 5 korrik 2018.
- 6 “*The Catholic Encyclopedia - An International Reference of Work on the Constitution, Doctrine, Discipline, and History of the Catholic Church*”, New York Robert Appleton Company, Vëll. VIII, f. 505.
- 7 *Medieval Studies*, #33/1971, f.228-263.
- 8 Andrea Büchler & Christina Schlater: “*Marriage Age in the Islamic and Contemporary Muslim Family laws – A Comparative Study*”, University of Zurich 2013.
- 9 Angeliki Laiou: “*Consent and Coercion to Sex and Marriage in Ancient and Medieval Societies*”, Washington DC, 1993, f.85-190.
- 10 B.Rawson & PR Weaver (ed): “*The Roman family in Italy: status, sentiment*”, Oxford University Press 1999, f. 21.
- 11 *Children & Youth in History*, 15 korrik 2018.
- 12 *Demography* #47 (3)/2010.
- 13 William Blackstone: “*An Analysis of the Laws of England*”, London 1766, f.410.
- 14 Artikulli 144 i Kodit Civil.
- 15 Janet Lindenmuth: “*The Age of Consent and rape reform in Delaware*”, Widener Law Delaware Library. 16 shtator 2020.
- 16 *The New York Times*. 15 tetor 1895.
- 17 “*Sociology Compass*”, Vëll.15, Nr.11, Nëntor 2021.
- 18 http://topics.law.cornell.edu/wex/table_marriage#g.
- 19 Anjali Tsui, Dan Nolan & Chris Amico: “*Child Marriage in America – by the numbers*”, Frontline, 6 korrik 2017.
- 20 www.independent.co.uk.
- 21 Vivian E. Hamilton: “*Liberty without Capacity*”, SSRN Working paper 2013.
- 22 *Journal of Global Health*, 30 tetor 2021.
- 23 www.savethechildren.org.uk
- 24 BMC Public Health, 15 tetor 2020.
- 25 wap.business-standard.com

Intervistë me znj. Arlinda Amity – daktroreshë e shkencave të teologjisë islame, e diplomuar në Zvicër.

“Debati për shaminë në Evropë është shumë më tepër se një çështje lirie personale apo të drejtash fetare”

Ju faleminderit për mundësinë që të ndani përvojat tuaja mbresëlënëse për lexuesit shqiptarë dhe për ndjekësit e revistës islame mbarëshqiptare “Dituria Islame”!

Na tregoni pak për rrugëtimin tuaj të begatë edukativ dhe arsimor, megjë jeni ndër gratë e para shqiptare, doktor shkence në teologji islame në një vend perëndimor si Zvicra?

Së pari, duhet të bëj të qartë se unë me siguri nuk jam gruaja e parë dhe e vetme me prejardhje shqiptare që ka doktoruar në studimet islame në një vend perëndimor. Jam e sigurt se në këtë rast ka edhe gra të tjera me një diplomë të ngjashme ose të njëjtë.

Pasi përfundova shkollën e mesme në Zvicër – në kantonin Baselland – u regjistrova në Universitetin e Bazelit për studimet e Iberoromanistikës dhe Studimeve të Lindjes së Mesme (që më parë quhej Islamologji). Gjatë studimeve, interesimi im kryesor ishte në fushën e studimeve letrare, dhe punova mbi historinë e Andaluzisë. Në tezën time të masterit, hulumtova tekstet e ashtuquajtura moriske, pra myslimanët spanjollë që pas inkuizicionit nuk lejohej më të praktikonin publikisht fenë e tyre dhe ishin në ushtrinë vetëm fshehtas. Këto tekste i kushtuan temave të ndryshme islame, të cilat i transmetonin brenda komunitetit të tyre. E veçanta ishte se këta moriske, megjithëse flisnin spanjisht, në tekstet e tyre përdornin ende shkrimin arab.

Që nga viti 2016, kur fillova të kërkoja mundësi të reja punësimi, më kontaktuan për një doktoratë në Qendrën Zvicerane për Islam dhe Shoqëri në Universitetin e Friburgut. Në fokus ishte një punë mbi komunitetin shqiptar në Zvicër. Në atë kohë nuk kishte ende studime të detajuara mbi imamët shqiptarë, prandaj ky projekt më tërhoqi shumë dhe bashkëpunova me Universitetin e Friburgut dhe Universitetin Goethe në Frankfurt për realizimin e doktoratës.



Si një emigrante nga trojet shqiptare, cilat ishin sfidat kryesore që u ballafaquat me to gjatë ngritjes suaj akademike?

Për botën akademike, përvoja ime si emigrante nuk kishte rëndësi. Si në Bazel, ashtu edhe në Fribourg, pashë një ambient të hapur e mikpritës ku njerëzit trajtoheshin me barazi, pa dallim prejardhjeje. Gjatë kohës së shkollës, përjetova qartë diskriminim për shkak të prejardhjes sime. Duke qenë se migrova në Zvicër pak më vonë, duhej të kompensoja më shumë mësim, dhe mësues të caktuar na trajtonin ndryshe apo nuk na merrnin seriozisht.

Tashmë jeni ligjëruese universitare. Në cilin universitet jeni angazhuar dhe cilin program teologjik islam e ligjëroni?

Në vitin 2018, pra ende gjatë doktoratës, mora një detyrë mësimdhënieje në Shkollën e Lartë Pedagogjike të Universitetit të Shkencave të Aplikuara të Zvicrës Veriperëndimore (PH FHNW), në Departamentin e Etikës, Fesë dhe Bashkësive. Në këtë kuadër, studentëve u jepja njohuri për fenë islame dhe për bashkësitë myslimane në Zvicër. Me kalimin e viteve, bashkëpunimi im me PH FHNW u thellua, aq sa fillova të mbaj më shumë ligjërata. Sot jam e punësuar si ligjëruese me kohë të plotë dhe jap kurse të lëndës dhe të didaktikës mbi bashkësitë fetare në Zvicër.

A konsideroni që sot, studimet e Islamit në kontekstin evropian janë linja e duhur për një teolog-e që vepron në Evropë, apo duhet doemos të studiohet Islami diku në një vend ku flitet gjuha e Kuranit?

Është e rëndësishme të sqaroj se studimet e mia në Universitetin e Fribourg-ut nuk janë teologji klasike, si ajo që njihet në vendet islame. Unë jam më shumë e fokusuar në marrëdhëniet midis shtetit, shoqërisë dhe bashkësive fetare, si dhe në zhvillimet dhe ndryshimet që ndodhin në këtë fushë. Prandaj, për ata që duan të jetojnë për një kohë të gjatë në Zvicër dhe të punojnë profesionalisht me komunitetet myslimane, mendoj se është shumë e dobishme të përfitojnë të paktën nga shërbimet që ofron Universiteti i Fribourg-ut, edhe nëse nuk ndjekin një program të plotë studimi. Sa i përket dijes fetare në fushat e ndryshme të teologjisë islame, mendoj se një arsimim i fortë – në një vend mysliman apo edhe në formë online – mbetet i domosdoshëm.

A mendoni që brezi i ardhshëm i myslimanëve në Zvicër, do të arrijnë ta ruajnë identitetin e tyre fetar pa u ndjerë të stigmatizuar apo përjashtuar nga shoqëria?

Jam e bindur se kjo me siguri do të ndodhë, edhe pse ende ka disa pengesa që duhet të tejkalohen. Duhet ta kuptojmë se numri i myslimanëve që e praktikojnë aktivisht Islam në jetën e tyre të përditshme është shumë i vogël. Bëhet fjalë për 10% të popullsisë myslimane, e cila në përgjithësi është shumë sekulare. Kjo do të thotë se ky debat në fakt prek vetëm një pjesë shumë të vogël të komunitetit.

Islami, si fe, duhet së pari të interpretohet në bazë të Kuranit dhe jetës së Profetit Muhamed a.s.. Sepse nëse që në fillim përpiqemi ta shpjegojmë besimin islam në mënyrë gjeografike ose filozofike, atëherë krijohet përshtypja sikur ekzistojnë “islame” të ndryshme, gjë që bie ndesh me mesazhin thelbësor të fesë islame.

A është e shëndoshë dhe e saktë ideja e cilësimit të Islamit si “Islami evropian”, apo “Islam tradicional”?

Unë personalisht mendoj se Islami, si fe, duhet së pari të interpretohet në bazë të Kuranit dhe jetës së Profetit Muhamed a.s.. Sepse nëse që në fillim përpiqemi ta shpjegojmë besimin islam në mënyrë gjeografike ose filozofike, atëherë krijohet përshtypja sikur ekzistojnë “islame” të ndryshme, gjë që bie ndesh me mesazhin thelbësor të fesë islame: t’i shërbehet një Zoti dhe të ndiqet shembulli i Profetit.

Është plotësisht e pranueshme të thuhet se në një rajon të caktuar – për shembull në Evropë – njerëzit që i përkasin besimit islam kanë zhvilluar ndonjë veçori që i dallon nga komunitetet e tjera myslimane.

Por, pavarësisht kësaj përbërjeje të larmishme të myslimanëve, duhet ta kemi gjithmonë parasysh se vetë besimi, në interpretim, duhet të bazohet në Kuran dhe Sunet.

Si e vlerësoni rolin e institucioneve fetare shqiptare në diasporë? A kanë ato ndikim të qëndrueshëm në formimin e brezave të ardhshëm?

Institucionet fetare shqiptare kanë një rëndësi të veçantë, pasi përbëjnë numrin më të madh të myslimanëve në Zvicër. Si rrjedhojë, sidomos në qytete dhe zona urbane ku janë të përqendruara këto komunitete, gjenden xhami funksionale që mbështeten në struktura të qarta dhe, në varësi të burimeve të tyre, ofrojnë shërbime të ndryshme si mësim i Kuranit, derse apo ceremonitë martesore. Disa komunitete janë tashmë aq të mirë organizuara, saqë kanë ndërtuar xhami të reja dhe moderne, të cilat tregojnë për rëndësinë e madhe që këto komunitete i japin jetës së tyre në Zvicër dhe kontribuojnë në mënyrë thelbësore në integrimin afatgjatë të komuniteteve myslimane.

Kritika më e madhe që vërej është orientimi i komuniteteve përgjatë vijave gjuhësore dhe etnike. Por kjo është një dukuri që nuk prek vetëm komunitetet shqiptare, por në përgjithësi komunitetet myslimane. Xhamitë janë të hapura për të gjithë njerëzit në çdo kohë, megjithatë strukturat fetare janë ende



tepër të fokusuar në karakteristikat e diasporës. Pikërisht si një bashkësi universale besimi, myslimanët në Zvicër duhet të kontribuojnë më shumë në drejtim të diversifikimit të strukturave të tyre fetare, duke bashkëpunuar përtej kufijve të komuniteteve dhe, mbi të gjitha, duke komunikuar në gjuhën vendore dominuese. Sepse nuk duhet të harrojmë se mendësia e diasporës mund të jetë ende e fortë të gjenerata e parë e emigrantëve shqiptarë, por për gjeneratat pasuese lidhja dhe kuptimi ndaj diasporës po zhvillohet në një drejtim krejtësisht tjetër. Në këtë rast, në qendër qëndron Zvicra, vendi ku këta të rinj myslimanë janë rritur, nëse jo edhe lindur.

A mendoni se ekziston një mungesë e theksuar e zërit të gruas në predikimin dhe interpretimin aktual të Islamit?

Por natyrisht, duhet ta pranojmë që sidomos sa u përket funksioneve publike – të paktën në Zvicër – zërat e grave janë më pak të pranishëm. Sa u përket debateve teologjike, kam përshtypjen se gratë janë të përfaqësuara, por duhet njohur mirë literatura dhe platformat për të pasur qasje. Megjithatë,

edhe në këtë rast mund të thuhet se zërat e grave janë më pak të dëgjuar në krahasim me ata të burrave.

Në një botë ku religjioni shpesh instrumentalizohet për ndarje dhe konflikt, si mund të kontribuojë teologjia islame në ndërtimin e një etike universale që bashkon njerëzit pa dallim feje, gjinie dhe kulture?

Teologjia islame mund të japë një ndihmesë të vlefshme për një etikë të përbashkët për të gjithë njerëzit, sepse e sheh njeriun si një qenie që ka përgjegjësi para Zotit – pa dallim feje, prejardhjeje apo gjinie. Islami mëson se çdo njeri është krijuar me dinjitet dhe me ndjenja të natyrshme për të dalluar të mirën.

Mbi këtë bazë ndërtohet një etikë që e njeh dhe e mbështet të mirën, dhe e lidh atë me një kuptim më të lartë, hyjnor. Në qendër nuk qëndron njeriu si masë e gjithçkaje, por përgjegjësia që ai ka para Krijuesit. Kjo ndihmon për të shmangur sjelljet e paqëndrueshme morale dhe për të nxitur drejtësinë, mëshirën dhe respektin ndaj të gjithë njerëzve.

Jeta e Profetit Muhamed a.s. ofron shumë shembuj praktikë për këtë qasje, por këta shpesh harrohen në jetën e përditshme. Etika islame ka rregulla të qarta, por është e hapur për të dialoguar me natyrën njerëzore. Ajo ka mundësinë të ndërtojë ura, duke ofruar vlera të përhershme që i flasin çdo njeriu në mënyrë të plotë.

Si i shihni debatet rreth shamisë në Evropë – a janë ato çështje të lirisë personale dhe të drejtave fetare, apo një pasqyrim i tensioneve më të thella kulturore ndaj Islamit?

Debati për shaminë në Evropë është shumë më tepër se një çështje lirie personale apo të drejtash fetare. Ai pasqyron tensione më të thella kulturore – veçanërisht në mënyrën se si Evropa e trajton Islamin dhe vetëvendosjen e grave. Në të vërtetë, ky debat është një shembull i qartë se si trupi i gruas instrumentalizohet vazhdimisht – qoftë përmes rregullave që përcaktojnë sa duhet të tregojë një grua, qoftë përmes ndalimeve që i thonë sa mund të mbulojë ajo.

Evropa e sheh veten sot si e ndriçuar dhe liberale, por strukturat mizogjene ekzistojnë ende: si në pabarazinë në pagesa, ashtu edhe në seksualizimin normativ të trupit të gruas apo idealet shoqërore të bukurisë që prekin kryesisht gratë. Debati për shaminë është pjesë e këtij modeli – ai është shprehje e një problemi më të madh: kontrolli dhe vlerësimi i trupit të gruas nga instanca të jashtme.

Por në rastin e shamisë shtohet edhe një element tjetër: racizmi në formën e

Debati për shaminë në Evropë është shumë më tepër se një çështje lirie personale apo të drejtash fetare. Ai pasqyron tensione më të thella kulturore.

islamofobisë. Gratë myslimane shpesh nuk shihen si subjekte që veprojnë vetë, por paraqiten si viktime të një Islami që konsiderohet në mënyrë të përgjithësuar si prapambetur. Në vend që të dëgjohen zërat e tyre, flitet për to – por jo me to. Kjo qasje nuk tregon vetëm një trashëgimi orientaliste, por edhe një ndjenjë kulture superiore që shpesh është e pranishme në këto debate.

Prandaj, debati për shaminë nuk mund të shihet i shkëputur nga konteksti. Ai është një ndërthurje e politikave gjinore, kritikës fetare, arrogancës kulturore dhe racizmit strukturor – dhe pikërisht për këtë arsye, ka nevojë për më shumë nuanca, më shumë dëgjim dhe më shumë respekt për vetëvendosjen e grave myslimane.

Pse në disa vende evropiane shamia shihet si problem? A është kjo çështje feje, kulture apo paragjykimi?

Kur shamia shihet si problem në Evropë, rrallëherë kjo ka të bëjë me vetë copën e pëlhurës, por më shumë me kuptimet që i atribuohen asaj. Siç thashë më herët, debati për shaminë është një shprehje e tensioneve të thella kulturore: ai prek çështje të fesë, gjinisë, pushtetit dhe identitetit. Në shumë raste, shamia nuk është problemi i vërtetë, por një sipërfaqe mbi të cilën projektohen frika ndaj Islamit, mosbesimi ndaj “tjetrit” dhe pyetje të pazgjidhura shoqërore mbi rolet gjinore.

Këtu përzihen injoranca fetare, mendjemadhësia kulturore dhe paragjykimet raciste. Në një shoqëri që e sheh veten si moderne dhe feministe, shamia interpretohet shpesh automatikisht si simbol i shtypjes, pa marrë parasysh kontekstin apo vendimin personal të gruas që e mban. Kjo qasje injoron jo vetëm shumëllojshmërinë e zërave të grave myslimane, por edhe zbulon një marrëdhënie të pabarabartë pushteti: shoqëria “e ndriçuar” shumicë përcakton se çfarë konsiderohet çlirim apo shtypje.

Për më tepër, ndërsa shumë shoqëri evropiane janë të gatshme ta festojnë shumëllojshmërinë kulturore – për shembull në ushqim, modë apo muzikë – dukshmëria fetare, veçanërisht ajo islame, has në kufij të qartë. Shamia nuk shihet si shprehje e identitetit fetar, por si provokim, si kthim

Shpesh mendohet se gratë me shami nuk janë të lira. Ky mendim shpesh nuk lind nga një interes i vërtetë për realitetin e jetës së këtyre grave, por nga një imazh i parapërgatitur që buron nga paragjykimet kulturore dhe mosbesimi i pashprehur ndaj Islamit.

prapa, apo madje si rrezik për sigurinë. Kjo nuk është thjesht një keqkuptim fetar apo kulturor, por një shprehje e paragjykimeve të thella dhe mosbesimit strukturor ndaj myslimanëve.

Prandaj, pyetja nuk është vetëm: Pse i pengon shamia? Por edhe: Pse grave myslimane u mohohet e drejta për të zgjedhur vetë se si ta shprehin dinjitetin, devotshmërinë apo vetëvendosjen e tyre?

A mendohet ndonjëherë në vendin ku veproni se gratë me shami nuk janë të lira? Çfarë do t'u thoshit atyre që e shohin shaminë si simbol shtypjeje?

Edhe në Zvicër diskutimet rreth shamisë janë të pranishme – qoftë në debate politike, paraqitje mediatike apo takime të përditshme. Shpesh mendohet se gratë me shami nuk janë të lira. Ky mendim shpesh nuk lind nga një interes i vërtetë për realitetin e jetës së këtyre grave, por nga një imazh i parapërgatitur që buron nga paragjykimet kulturore dhe mosbesimi i pashprehur ndaj Islamit.

Këto debate duhet marrë seriozisht, veçanërisht sepse ato tregojnë shumë për gatishmërinë shoqërore për të pranuar diversitetin fetar – ose për të mos e pranuar atë. Por unë e konsideroj problematike kur flitet për gratë myslimane pa i dëgjuar ato. Kush e sheh shaminë si simbol të shtypjes, duhet të pyesë veten: Në çfarë baze e kam dhënë këtë gjykim? Kam folur ndonjëherë me një grua të prekur? Kam kuptuar perspektivën e saj – jo vetëm për shaminë, por për tërë jetën e saj?

Në vend që të mbështetemi në supozime të përgjithshme, shpesh me ngjyrimë raciste, do të ishte shenjë respekti dhe hapësire për t'i dhënë fjalën grave myslimane vetë. Kush injoron këtë aspekt, nuk i bën dëm vetëm këtyre grave, por humb edhe mundësinë për të vlerësuar dhe sfiduar paragjykimet e veta.

Liria nuk do të thotë që të gjithë të marrin vendime të njëjta, por që të kenë mundësinë të zgjedhin rrugë të ndryshme me bindje të plotë.

Intervistën e realizoi Driton Arifi

Nëna – heroina që nuk pret asgjë në këmbim

MSc. Zamira Bushati – Puka

Në shoqërinë tonë moderne, shpesh modeli i gruas së suksesshme po shihet përmes syzeve të karrierës, pozitës sociale apo të ardhurave materiale, duke lënë në hije madhështinë e rolit të mëmësisë. Shpesh suksesi po matet me arritjet materiale, e po harrojmë vlerat morale dhe shpirtërore. Po minimizohet roli i nënave, i heroinave tona, të cilat mund të mos kenë diploma të varura në mur, por kanë plagë në duar dhe rrudha nga sakrificat dhe mundimet e jetës.

Po shohim që shumë nëna po kujtohen dhe po i shprehin mirënjohje vetëm në Ditën Ndërkombëtare të saj. Shpesh fëmijëve të sotëm, nën petkun e lirisë, po i serviren kundërshtimi i prindërve, e veçanërisht i nënave. Po hasim nëna, të cilat kanë drojë të shprehin mendimet e tyre përpara fëmijëve nga frika e keq reagimit apo e nënçmimit. Jo vetëm kaq, por po vëmë re dhe po theksohet dita-ditës një fenomen jo i bukur, i cili nuk ka qenë dhe nuk është traditë e shoqërisë myslimane, dërgimi i prindërve në azile me arsyetimin se nuk kanë kohë dhe mundësi të kujdesen për nënën apo babanë në moshën e pleqërisë së tyre.

Prandaj ky shkrim vjen si mirënjohjeje për figurën madhështore të nënës, por edhe si një thirrje dhe këshillë për reflektim, jo vetëm për rininë tonë dhe për çdokënd që e ka nënën, babanë ose të dy prindërit gjallë, që të tregojnë respekt dhe përkushtim ndaj tyre, ashtu siç na mëson besimi ynë.

Përgjatë historisë, figura e nënës ka qenë dhe do mbetet një shtyllë e pazëvendësueshme e shoqërisë dhe një burim i pashtershëm dashurie, sakrifice dhe frymëzimi. Ajo jo vetëm se është porta përmes së cilës vjen në jetë brezi i ardhshëm, por është edhe dora e parë që përkund fëmijën, zëri i parë që e përkëdhel atë dhe drita e cila ndriçon rrugën e jetës, pa bërë bujë e pa paraqitur kërkesa. Nëna është edukatorja e parë,

është mësuesja e ndjenjave, e ndërgjegjes dhe e karakterit. Ajo nuk edukon vetëm me fjalë, por edhe me heshtje e me përqafime. Edukon me përkushtimin e palodhur, me lotët e fshehur e me lutjet e singerta. Sado që teknologjia të përparojë, nuk mundet asnjëherë të zëvendësojë përqafimin

e nënës, shikimin e saj të butë apo aromën që fëmija ndien kur fshihet në krahë të saj. Nëna është krijuar të ndërtojë botë të tëra brenda katër mureve, duke formuar dhe drejtuar zemrat e shpirtin e atyre që nesër do të jenë e ardhmja e çdo vendi.

Nëna nuk është vetëm një figurë e dashurisë, por edhe e mençurisë, e urtësisë dhe e durimit. Allahu e ka pajisur atë me ndjeshmëri të natyrshme, me aftësi të brendshme për të kuptuar fëmijën pa fjalë, për ta ngrohur atë pa zjarr dhe për ta ndihmuar edhe kur vetë është e lodhur. Nëna është e para që ngrihet dhe e fundit që fle. Është ajo që sakrifikon ëndrrat e saj për të parë fëmijët e vet të realizuar. Ndoshta nuk dëgjohej ankesa e saj, por heshtja e saj është një libër i tërë vuajtjeje, durimi e dashurie të pakushtëzuar. Nënën nuk kërkojnë duartrokitje, por japin pa zë.

Sakrificat e tyre nuk shkruhen në letër, por gdhenden në zemra. Dhe ndonëse lodhja e saj është reale, nëna nuk merr kurrë pushim nga roli i saj: nuk merr kurrë leje, edhe kur është e sëmurë apo në hall, përherë mendja dhe zemra e saj janë për fëmijët. Kjo sakrificë e ky heroizëm, i cili nuk do të thotë se duhet të jetë përherë një akt spektakolar, është i vazhdueshëm. Dhe heroina e vërtetë nuk është ajo që kërkon lavdi, por ajo që vazhdon të japë, edhe kur s'ka asgjë më për të dhënë.

Për këto e për shumë të tjera, Islami e ka vendosur nënën në një vend nderi të pakrahasueshëm, ndryshe nga shumë shoqëri që e kanë relativizuar rolin e saj. Sipas Islamit,

Nëna është krijuar të ndërtojë botë të tëra brenda katër mureve, duke formuar dhe drejtuar zemrat e shpirtin e atyre që nesër do të jenë e ardhmja e çdo vendi.



mirënjohja për nënën nuk është thjesht një emocion i momentit, por është një obligim i vazhdueshëm. Ai na mëson që jo vetëm të mos flasim me zë të lartë përpara saj, të mos e nënçmojmë, të mos e mërzisim, të mos tregohemi të pasjellshëm me të, por as t'i themi "uf" apo "oh". Ai e konsideron respektin dhe përkujdesjen ndaj nënës në çdo fazë të jetës, si një privilegj që sjell bekim në dynja dhe shpërblim në Ahiret. E ka ngritur respektin ndaj prindërve në pedestalin më të lartë të njerëzores.

Në Kuranin famëlartë, Allahu xh.sh. thotë: *"Zoti yt ka urdhëruar, që të mos adhuronit askënd tjetër përveç Atij dhe, të silleni mirë me prindërit. Nëse njëri prej tyre ose të dy arrijnë pleqërinë të ti, mos u thuaj atyre as "uh!", mos i kundërshtoj, por drejtoju atyre me fjalë respekti."* (El Isra, 23).

Prandaj në Islam, respekti ndaj nënës nuk është thjesht një metaforë për të zbukuruar gjuhën, por është udhëzim hyjnor për të riformuar botën, sepse një shoqëri që nderon nënën, është një shoqëri që ndërton të ardhmen me themele të forta. Një komb që përkujdeset për nënën, është një komb që nuk i trembet së nesërme. E kundërta ndodh kur nëna shpërfillet e nuk respektohet, e gjithë struktura morale e familjes fillon të rrënohet. Jo vetë kaq, por kur nëna barazohet thjesht me një hallkë të zinxhirit ekonomik, fëmijët nuk rriten më me zemër, por si mekanizma, si robotë pa shpirt dhe pa ndjenja.

Psikologjia moderne e ka studiuar në thellësi marrëdhënien nënë-fëmijë dhe çdoherë është mahnitur përpara forcës së saj emocionale dhe ndikimit që ka ajo në ekuilibrin emocional dhe psikologjik të fëmijës. Sipas teorisë së John Bowlby-t për lidhjen e ngushtë nënë - fëmijë, theksohet se kjo marrëdhënie formon bazën e sigurisë së brendshme të individit. Sipas John Bowlby-t (1907-1990), ndjenja e shqetësimit të foshnjës kur

largohet nga nëna përjetohet si ankth. Çdo stimul shtesë që e frikëson dhe e shqetëson mobilizon shenja të tilla si të qarat. Nëna me kujdesin dhe rehatinë e foshnjës mund të lehtësojë simptomat negative dhe të përmirësojë sjelljen e lidhjes.¹ Kjo dashuri formon atë që psikologët e quajnë "besim bazë", pa të cilin njeriu është vështirë të ndërtojë ekuilibër emocional apo marrëdhënie të shëndetshme.

Realisht, nëna nuk është vetëm burim dashurie, por edhe qeliza edukative dhe kulturore e shoqërisë. Është ajo që transmeton gjuhën, sjelljen, vlerat, traditat dhe besimin. Nëna është themeli mbi të cilin ndërtohet brezi i ardhshëm.

E jo rastësisht, kur Profeti Muhamed, paqja e Zotit qoftë mbi të, u pyet nga një njeri: "Kush nga njerëzit e meriton më shumë shoqërinë time të mirë?" Ai iu përgjigj: "Nëna jote". Ai i tha: "Pastaj kush?" Ai iu përgjigj: "Nëna jote." Ai pyeti: "Pastaj kush?" Ai tha: "Nëna jote." Ai tha: "Pastaj kush?" Ai tha: "Babai yt."² (Buhariu, 5971 dhe Muslimi, 2548). Në këtë porosi Profeti a.s. nuk përmendi as shokë, as miq e as udhëheqës, por tha: "Nëna jote", duke e përsëritur tri herë, përpara se të përmendte babanë, gjë që tregon se përkujdesja ndaj nënës nuk është thjesht vetëm një ndjeshmëri, por është një përkthim i vlerës hyjnore në jetën tonë njerëzore. Po kështu, myslimanët janë edukuar me faktin se kënaqësia e Zotit kalon përmes kënaqësisë së nënës, nga këshilla që Profeti ynë i dashur ia dha një sahabiu, duke i thënë: "Qëndro pranë saj, sepse Xheneti është nën këmbët e saj!"³ (Nesaiu, 3104 dhe Ibën Maxhe, 2781).

Prandaj, nëse do të përpiqeshim ta përkufizonim nënën me një fjalë, ajo do të ishte "heroinë"; nëse do ta përkufizonim me një ndjenjë, do të ishte "mëshirë"; e nëse do ta përkufizonim nga ana shpirtërore, do të ishte bekim në tokë dhe parajsë në Ahiret. Është detyrë e çdo individi, por edhe e institucioneve, të krijojnë një ambient ku nënat të ndihen të respektuara, të mbështetura dhe të çmuara, sepse nuk mund të ketë drejtësi sociale dhe zhvillim të qëndrueshëm aty ku figura e nënës mbetet e nënvlerësuar.

Le të tregojmë kujdes ndaj mënyrës se si sillemi me nënat tona! Le të tregojmë respekt, përkujdesje, ndihmë e mirënjohje ndaj tyre çdo ditë me praninë tonë. Le të lutemi për to kur s'janë më mes nesh, me shpresën e takimit me to në botën tjetër, sepse një shoqëri që e nderon nënën, është një shoqëri që nderon vetveten dhe një zemër që e respekton nënën, është një zemër që është më pranë Zotit!

1 Shih: <http://revistapsikologji.com/zhvillimi-psikologjik-i-femijes-sipas-teorise-se-lidhjeve-te-j-bowlby>.

2 Shih: <https://dorar.net/h/qlx4uzkd#:~:text=%D8%A3%D9%85%D-9%83%D8%8C%20%D8%A3%D9%85%D9%83%20%D8%8C>.

3 Shih: <https://dorar.net/hadith/sharh/119940>.

Kauza e dashurisë ndaj atdheut në paqe dhe në liri

Murtezan Idrizi

HYRJE

Termi atdhe por edhe termi mëmëdhe, pothuajse janë identikë me njëri-tjetrin, apo janë sinonime të afërta. Atdhe quhet vendi ku ke lindur, jetuar dhe ku kanë jetuar të parët, vendi ku është i vendosur një popull apo një komb prej kohësh. Në gjuhën e përditshme shqipe tashmë ka depërtuar edhe termi vatan. Termi vatan, edhe pse i huazuar nga turqishtja në gjuhën shqipe, në esencë ajo ka origjinë arabe *vattane*, që ka kuptimin e jetesës, rrojtjes, banimit, kalimit të jetës në një vend.¹ Sinonime të termit vatan në gjuhën shqipe janë termet mëmëdhe, atdhe.²

Dashuria për atdheun është një ndjesi e natyrshme që lind nga lidhshmëria e individit me vendin e lindjes. Kjo ndjesi është e rrënjësuar thellë në ndërgjegjen e çdo njeriu që ka shpirt të pastër dhe ndjenja të shëndosha. Ndjesia për atdheun si duket është e krijuar nga Vetë Zoti në trupin e njeriut që nga krijimi, dhe që bënë që çdo individ të ndiejë se vendi i tij është më i dashur se çdo vend tjetër. Në njëfarë forme siç e përshkruan poeti ynë i madh Naim Frashëri në poezinë e tij për atdheun:

*“O Atdhe, më je i dashur sa më s’ka,
Më je nënë, më je motër, më je vëlla,
Nga ç’ka rrotull më i shtrenjti ti më je,
Je më i miri nga çdo gjë që ka ky dhe.”*

Atdhe quhet vendi ku ke lindur, jetuar dhe ku kanë jetuar të parët, vendi ku është i vendosur një popull apo një komb prej kohësh.

Dashuria për atdheun është një ndjenjë që dallon nga dashuria e zakonshme, andaj këtë dashuri të veçantë duhet kultivuar dhe shfaqur ndryshe. Kjo ndjenjë e veçantë për atdheun ekspozohet duke i dhënë një vend të veçantë në brendinë tonë atdheut, duke e vendosur në një vend të veçantë në ndërgjegjen e gjithsecilit. Ky është një qëndrim i vendosur dhe i guximshëm për tokën që të ka lindur. Është nderim me përkulje për të kaluarën dhe njëkohësisht besim i fortë për ndërtimin e së ardhmes.

KAUZA E DASHURISË NDAJ ATDHEUT NGA PRIZMI KOMBËTAR

Shikuar nga prizmi kombëtar shqiptar, dashuria për atdheun duhet të jetë një kauzë për gjithsecilin. Madje dashuria për atdheun duhet të jetë prioriteti kryesor për çdo shqiptar. Para se të flasim për kauzën e dashurisë ndaj atdheut, është e udhës të dihet se gjeografia shqiptare në përgjithësi është shumë e gjerë, por e parcelizuar ndërmjet shteteve fqinje. Ashtu siç e quan edhe shkrimtari Ali Podrimja “*me plot kufi e murana pas të cilave fshehët shqetësimi ynë gjithëkombëtar.*”³ Për gjithë shqiptarët, qofshin brenda kufijve ose jashtë kufijve të Shqipërisë, mëmëdheu i tyre është Shqipëria. Në kufijtë e gjeografisë shqiptare është edhe Kosova, që ende rrugëton drejt pavarësisht të plotë. Gjithashtu janë edhe shqiptarët e Maqedonisë së Veriut me të



drejta të avancuara, por ende të papërfunduara plotësisht. Lugina e Preshevës dhe shqiptarët në Mal të Zi ende mundohen t'i bëjnë ballë presionit serb që insiston me çdo kusht që shqiptarët të arratisen nga trojet e stërgjyshërve të tyre. Nuk mund të kalohet pa i përmendur edhe shqiptarët e Çamërisë që janë zhdukur krejtësisht, një pjesë goxha e madhe e shpërngulur me dhunë, një pjesë e tyre të vrarë (të masakruar, i njohur si gjenocidi çam⁴) dhe një pjesë e asimiluar tërësisht.

Nëse e analizojmë të kaluarën e Shqipërisë, sidomos periudhën para viteve të nëntëdhjeta, ajo pjesa 37 vjet komunizëm në krye me Enver Hoxhën, na shfaqet një pasqyrë e errët për atdheun, gjithçka të keqe kishte vetëm kauzë dashurie për atdhe nuk kishte. Partia Komuniste që më vonë do të quhej Partia e Punës, kishte instaluar sistemin totalitar monarkist dhe gjithçka ishte nën kontrollin e një njeriut. Nuk kishte demokraci, nuk kishte liri shprehjeje, nuk lejohej kritika, kush mendonte ndryshe nga monarku brenda natës zhdukej. Kështu ishte rasti me Musine Kokalarin, e cila ishte zëri i demokracisë, zëri i lirisë, zëri i intelektualëve shqiptarë, ajo e ngriti zërin për zgjedhje demokratike në vend. Por pas gjithë asaj që bëri Musineja, u dënua me 25 vjet burg, (nga të cilat 16 vjet i kalojë në burg). Sundimi diktatorial i asaj kohe kishte arritur të skllavërojë një popull të tërë. Në librin *"Rruga e një shqiptari drejt lirisë"*, i autorit Zef Margjinaj ka vënë në dukje shkaqet se pse ishte kyçur në luftën kundër komunizmit, kundër dhunës dhe padrejtësive që i bëhej popullit liridashës në Shqipëri. Autori ka shënuar se çdo kush që ishte kundër sistemit komunist ishte i përndjekur në çdo cep të Shqipërisë. Ashtu ndodhi edhe me vetë Zefin, ai dikur me armë në dorë u doli përballë komunistëve e që më vonë u arratis në Itali, nga ku edhe do ta vazhdojë betejën me penë kundër sistemit totalitar, për ta mbrojtur lirinë popullit të tij.⁵

Dashuria për vatanin nuk duhet të bëhet në formë folklorike, me fjalë boshe dhe me muzikë joshëse, por kjo kauzë kërkon vepra dhe manifestime konkrete.

Shembuj të tillë kemi shumë në shqiptarinë tonë.

Pak më keq se kjo ishte Kosova e cila i kalojë 87 vjet nën okupimin serb. Gjatë këtyre viteve populli shqiptar në Kosovë ishte dëshmitar i vrasjeve, burgosjeve, rrahjeve, torturave dhe shpërnguljeve të dhunshme nga sistemi komunist serb.⁶ Kjo vazhdojë deri në qershor të vitit 1999, ku me forcën e brendshme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe me ndihmën e faktorit të jashtëm NATO-së u finalizua çlirimi i Kosovës, por jo edhe pavarësia e plotë. Nuk duhet harruar edhe kontributin e

presidentit Ibrahim Rugova me moton: "Liri, Pavarësi, Demokraci", ai kishte edhe një moto tjetër: "Kosova Shtet i Pavarur dhe Sovran".⁷ Idetë e këtilla i bashkuan dhe i organizuan shqiptarët jashtëzakonisht në Kosovë. Andaj në vazhden e kësaj do të citojë një thënie të Albin Kurtit: "Kosova është ëndrra historike e popullit të saj, është ideali i shumë gjeneratave të dëshmorëve për gjatë viteve nën pushtimin serb e jugosllav në shekullin XX."⁸

Për të mos e ekzagjeruar temën për vuajtjet e shqiptarëve në Ballkan, nuk do të përmendim shqiptarët e Maqedonisë së Veriut, ata të Luginës së Preshevës, të Malit të Zi dhe të Çamërisë.

Kundruar në përgjithësi rrethanat e asaj kohe, mos zhvillimi ekonomik dhe social në gjitha trevat shqiptare, sistemi totalitar komunist brenda dhe jashtë Shqipërisë, e shumë faktorë të tjerë e kanë zbehur dashurinë për një atdhe të përbashkët. Analizuar të gjitha këto vuajtje, persekutime dhe vështirësi në gjithë shqiptarinë, kuptohet se edhe dashuria për atdhe të shqiptarët dallonte nga vendi në vend. Andaj, asaj kohe arratisja nga vendlindja ishte shpëtim, liri dhe paqe. Vështirësitë e kohës që i përjetoi populli shqiptar, qofshin ata të Shqipërisë, Kosovës, Maqedonisë së Veriut, Luginës, Malit të Zi dhe të Çamërisë, si duket e kanë zbehur kauzën e dashurisë për atdheun.

Kauza e dashurisë për atdheun duhet të jetë një motivim që do të nxitë individin të veprojë me përkushtim, sakrificë dhe përgjegjësi për vatanin e vetë. Kjo dashuri duhet të reflektojë në mbrojtjen e gjuhës, kulturës, historisë dhe traditës shekullore shqiptare. Ajo nuk është thjesht një ndjenjë, por një angazhim moral dhe qytetar për t'i kontribuar të ardhmes. Në këtë drejtim mund të merren si shembull shumë rilindës që vepruan për kauzën shqiptare. Disa prej tyre me armë në dorë, disa të tjerë me penë në dorë dhe

shumica me zemër të çiltër u orvatën për atdheun e tyre.

Dashuria për vatanin nuk duhet të bëhet në formë folklorike, me fjalë boshe dhe me muzikë joshëse, por kjo kauzë kërkon vepra dhe manifestime konkrete. Dashuria për atdhe kërkon përkushtim në arsim (edukimi i brezave të rinj) edhe atë me unifikimin e planit mësimor për shkollat fillore (pjesërisht edhe në shkollat e mesme) në mbarë trojet shqiptare. Kështu do të mbrohet kultura, historia dhe tradita jonë autentike kombëtare. Në harkun e dashurisë ndaj atdheut është edhe orvatja për drejtësi dhe barazi në shoqëri duke e ngritur zërin për të mirën publike. Në këtë frymë hyjnë edhe ruajtja e mjedisit dhe burimeve natyrore, sepse toka e atdheut është një trashëgimi për brezat që vijnë pas. Kjo i bie se dashuria ndaj tokës që të ka lindur është përgjegjësi për të bërë më të mirën e mundur që vendi të përparojë.

Kauza e dashurisë ndaj atdheut është frymëzim shpirtëror individual për secilin qytetar që e ndienë vetën se i takon atij kombi. Realisht ky frymëzim duhet shndërruar në angazhim për t'i ruajtur, zhvilluar dhe mbrojtur vlerat historike kombëtare. Kauza e dashurisë ndaj atdheut është vetë kauza e identitetit tonë, për t'i mbajtur lidhjet me rrënjët tona shqiptare.

KAUZA E DASHURISË NDAJ ATDHEUT NGA PRIZMI FETAR

Shikuar nga aspekti fetar, vendlindja për shqiptarët në përgjithësi e për ata të besimit islam në veçanti ka një rëndësi të madhe. Trojet ku jetojnë shqiptarët denbabaden për sa i përket banorëve, strukturës së saj kulturore, historisë, artefakteve historike, pamjes natyrore, klimës dhe pasurive të shumta natyrore, meritojnë më shumë dashuri dhe përkushtim.

Në vazhden e dashurisë për atdheun një thënie profetike thotë: *“Dashuria për atdheun është pjesë e besimit.”* Këtu nuk do të ndalemi të sqarojmë saktësinë apo pasaktësinë e kësaj thënie profetike. Por nga tradita profetike mund kuptohet dashuria e Profetit për vendlindjen e tij. Ai, instinktin e



dashurisë për atdheun e kishte mbjell te gjithsecili myslimanë. Profeti Muhamed me rastin e migrimit nga Meka në Medine, ishte ndalur në një vend dhe ishte kthyer drejt Mekës duke iu drejtuar me këto fjalë: *“Sa vend i bukur që je, sa e dashur më je! Sikur populli yt të mos më nxirrte me dhunë prej teje, kurrë nuk do të kisha banuar diku tjetër.”* Bazuar në këto argumente fetare, vendlindja për gjithsecilin prej nesh duhet të konsiderohet e shtrenjtë.

Për në fund dua të theksoj se ky vend është bërë një vend me gjakun, djersën, duart, mundin, modelet dhe motivet që të parët tanë i kanë thurur në nyje. Një poet është shprehur shumë bukur: *“Ajo që i bën flamujt flamur është gjaku i derdhur mbi të, toka është atdhe atëherë kur dikush vdes për të.”* Prandaj neve na bie në hise që t'ua dimë vlerën këtyre trojeve, t'i mbrojmë e ruajmë me vetëdijen se atdheu është nder. Duhet ta bëjmë më të mirën e mundshme për këtë vend.

- 1 Memishi, Isa, Fjalor arabisht – shqip, Logos-A, Shkup, vëll., 2, f. 931.
- 2 Neziri, Sami, Fjalor turqisht – shqip, EDFA, Tiranë 2006, f. 945.
- 3 Podrimja, Ali, Tkurrja e Atdheut, Botimet Toena, Tiranë, 2024, f. 79.
- 4 Türkdoğan Uysal, Berna, Gjenocidi Çam, Alsar, Tiranë, 2024, f. 56-68.
- 5 Margjinaj, Zef, Rruga e një shqiptari drejt lirisë, 1981, f. 9-12.
- 6 Podrimja, f. 80.
- 7 Sejdiu, Fatmir, *“Dr. Ibrahim Rugova – arkitekt i shtetformimit në Kosovë”*, Shenja, nr. 165, janar 2025, f. 4-7.
- 8 Intervistë me Albin Kurtin, Kosova është ëndrra historike e popullit të saj, Shenja, nr. 143, mars 2023, f. 11-14.

Specifikat e përkthimit të Kuranit nga h. Sherif Ahmeti

Dr. Azmir Jusufi

Përkthimi i Kuranit dhe interpretimi i mesazheve të tij fisnike, është një prej disiplinave më të rëndësishme islame. Kjo lëmi gjithmonë ka tërhequr vëmendjen e shumë studiuesve islam, si në të kaluarën ashtu edhe sot. Mesazhet e Kuranit fisnik ishin, dhe si të tilla mbetën burimi themelor i mendimtarëve islam. Gati nuk ka gjuhë botërore në të cilën nuk është përkthyer Kurani.

Kur është fjala për përkthimin e Kuranit nga Sherif Ahmeti, mund të themi se ai ishte një mbështetës i përkthimit të domethënies të Kuranit, dhe ishte kundër *përkthimit tekstual* (të fjalëpërfjalshëm) të Kuranit, duke pasur parasysh se është e pamundur që të ruhet stili i tij artistik duke e bartur në një gjuhë tjetër. Ai rreth përkthimit të tij të Kuranit pati thënë: “Përkthimi i domethënies të Kuranit është i nevojshëm dhe është i kërkuar, ngase nëpërmjet tij besimtarët njoftohen në udhëzimet e tij të larta. Përkthimi i Kuranit tekstualisht në ndonjë gjuhë tjetër nuk është i lejuar, ngase është e pamundshme të ruhet stili i tij artistik dhe të bartet në ndonjë gjuhë tjetër.”¹

PËRKTHIMI TEKSTUAL I KURANIT

Përkthimi i Kuranit do të thotë: “bartje dhe të shprehurit e kuptimeve të ajeteve kuranore nga gjuha arabe në një gjuhë tjetër.”

Përkthimi i Kuranit dhe interpretimi i mesazheve të tij fisnike, është një prej disiplinave më të rëndësishme islame. Kjo lëmi gjithmonë ka tërhequr vëmendjen e shumë studiuesve islam, si në të kaluarën ashtu edhe sot.

Ky lloj i përkthimit nuk është i lejuar dhe kjo pothuajse është e pamundur, sepse secila gjuhë i ka specifikat e veta me të cilat dallohet nga gjuha tjetër.² Përkthimi i fjalëpërfjalshëm është i privuar prej ndjesisë retorike të tekstit kuranor.³

Haxhi Sherif Ahmeti, në lidhje me këtë lloj të përkthimit të Kuranit ka thënë: “Përkthimi i Kuranit tekstualisht në ndonjë gjuhë tjetër nuk është i lejuar, ngase është e pamundshme që të ruhet stili i tij artistik dhe të bartet në ndonjë gjuhë tjetër.”⁴

Në vazhdim do të përmendim disa shembuj nga përkthimi tekstual i Kuranit nga h. Sherif Ahmeti:

يُنَبِّأُ الْإِنْسَانَ يَوْمَئِذٍ بِمَا قَدَّمَ وَأَخَّرَ

Sherif Ahmeti këtë ajet e ka përkthyer kështu: “Atë ditë njeriu do të njihet me atë që çoi para dhe me atë që la prapa.” (El Kijame, 13).

Edhe pse Sherif Ahmeti anonte që Kuranin mos ta përkthejë *tekstualisht* (fjalë për fjalë), siç e kemi përmendur tashmë, ai megjithatë, bëri përjashtime në këtë çështje, kështu që, këtë ajet e përktheu fjalë për fjalë. Duke e përkthyer këtë ajet në mënyrë tekstuale, fjalë për fjalë, ajeti merr kuptimin e kundërt prej atij që aspiro.

قَاتِلْهُمْ اللَّهُ أَتَى يُؤَفِّكُونَ⁵

Sherif Ahmeti këtë ajet e përktheu kështu: “*Allahu i vraftë si largohen (nga e vërteta)!*” (Et Tevbe, 30).

Kur fraza **قَاتَلَهُمُ اللّٰهُ** “*katelehumull-llah*” përmendet në Kuran, ajo nuk do të thotë gjithmonë “Allahu i vrau”, por “Allahu i mallkoi”. Në këtë rast, Sherif Ahmeti ajetin e përktheu tekstualisht.

Të njëjtin gabim e kanë bërë edhe përkthyesit e tjerë të Kuranit në gjuhën shqipe, duke e përkthyer fjalën **قَاتَلَهُمُ اللّٰهُ** “Allahu i vrau”, ndërsa dr. Muhamed Taqiudin el Hilali, dr. Muhamed Muhsin Khani,⁶ dhe Yusuf Aliu⁷ në anglisht, Muhamed Panxha dhe Xhemaludin Çausheviq⁸ në gjuhën boshnjake, këtë ajet e përkthyer kështu: “*Allah's curse be on them*” (**Bog ih je prokleo**) – “**Zoti i mallkoi**”.

مِنْ وَرَائِهِ جَهَنَّمُ

Sherif Ahmeti këtë ajet e përktheu si vijon: “*E pas tij (kryelartit) është Xhehenemi...*” (Ibrahim, 16).

Edhe në këtë rast, Sherif Ahmeti ajetin e përktheu tekstualisht (fjalë për fjalë).

رَبِّ اغْفِرْ لِي وَلِوَالِدَيَّ وَلِمَنْ دَخَلَ بَيْتِي [مُؤْمِنًا]

Sherif Ahmeti këtë ajet e përktheu si vijon: “*...dhe ata të cilët hynë në shtëpinë time...*” (Nuh, 28).

Fjala **بيت** “*bejt*” në këtë ajet, në bazë të komentimit të këtij ajeti, ka kuptimin: “feja”, “xhamia”, “anija”. Ajeti është përkthyer fjalë për fjalë. Në kuptim të njëjtë si “shtëpi” e kanë përkthyer edhe përkthyesit tjerë të Kuranit në gjuhën shqipe, si dhe përkthyesit në gjuhën boshnjake, si: Korkuti, Panxha – Çausheviq, prof. dr. Enes Kariq.⁹

وَمَنْ يَغْشُ عَنْ ذِكْرِ الرَّحْمَنِ

Sherif Ahmeti këtë ajet e përktheu si vijon: “*Kush mbyll sytë para këshillave të Zotit...*” (Ez Zuhuf, 36). Fjala **يغش** “*jaşu*” është përkthyer me kuptim “mbyllje të syve”. Përkthyesit e Kuranit në gjuhën boshnjake në të njëjtën mënyrë e kanë përkthyer këtë ajet kuranor sikur Sherif Ahmeti.

Si përfundim rreth kësaj çështjeje, të përmendim fjalët e Hajrullah Hoxhës, i cili në lidhje me përkthimin e Kuranit fjalë për fjalë ka thënë: “Për shkak të përmbajtjes hyjnore

“Për shkak të përmbajtjes hyjnore dhe gjuhës së pasur arabe, ku në shumë raste një fjalë ka disa kuptime, Kurani nuk mund të përkthehet në mënyrë adekuate dhe të saktë, fjalë për fjalë, pa u shërbyer me ndonjë fjalë të caktuar sqaruese në kllapa, ose me më shumë fjalë sipas nevojës në formë të komentimit me fusnota, në fund të faqes përkatëse, përndryshe, nëse përkthehet tekstualisht në shumë vende ai nuk do të mund të kuptohet qartë nga lexuesit.”

dhe gjuhës së pasur arabe, ku në shumë raste një fjalë ka disa kuptime, Kurani nuk mund të përkthehet në mënyrë adekuate dhe të saktë, fjalë për fjalë, pa u shërbyer me ndonjë fjalë të caktuar sqaruese në kllapa, ose me më shumë fjalë sipas nevojës në formë të komentimit me fusnota, në fund të faqes përkatëse, përndryshe, nëse përkthehet tekstualisht në shumë vende ai nuk do të mund të kuptohet qartë nga lexuesit.”¹⁰

EMRAT E BUKUR DHE ATRIBUTET E ALLAHUT

Në vazhdim të përmenden disa shembuj nga emrat e bukur dhe atributet e Allahut xh.sh.:

أَمَّنْ هَذَا الَّذِي يَرْزُقُكُمْ إِنْ أَمْسَكَ رِزْقَهُ

Sherif Ahmeti këtë pjesë të ajetit e përktheu si vijon: “*...po qe se Ai ua ndërpret furnizimin e vet...*” (Mulk, 21).

Emri i Allahut është emër i përveçëm dhe gjithmonë shkruhet me shkronjë të madhe. Mirëpo, edhe përemrat dhe atributet e Tij shkruhen me shkronja të mëdha.

Sherif Ahmeti, emrat e Zotit, përemrat dhe atributet e Zotit, ndonjëherë në përkthim i shkruan me shkronja të mëdha dhe ndonjëherë me të vogla.

رَبِّ ابْنِ لِي عِنْدَكَ بَيْتًا فِي الْجَنَّةِ

Sherif Ahmeti këtë ajet e përktheu si vijon: “*...më bën një vend pranë mëshirës sate në Xhenet...*” (Et Tahrim, 11).

Në këtë ajet, Sherif Ahmeti, “*mëshirës sate*” në përkthim e shkruan me shkronjë të vogël, kurse do të duhej të shkruhej me shkronjë të madhe.

تَنْزِيلٌ مِنْ حَكِيمٍ حَمِيدٍ

Sherif Ahmeti këtë ajet e përktheu si vijon: “*...është i zbritur prej të Urtit, të Lavdishmit.*” (Fussilet, 42).

Në të njëjtin ajet, emrin e bukur të Allahut **حَكِيم** në përkthim e shkruan me shkronjë të vogël, e sipas rregullave të dy duhet të shkruhen me shkronjë të madhe.

الْحَمْدُ لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ، الرَّحْمَنُ الرَّحِيمُ، مَالِكِ يَوْمِ الدِّينِ، إِيَّاكَ نَعْبُدُ وَإِيَّاكَ نَسْتَعِينُ



Sherif Ahmeti këto ajete i përktheu kështu: “*Falënderimi i takon vetëm Allahut, Zotit të botëve! Bamirësit të përgjithshëm, Mëshirëbërësit! Sunduesit në ditën e gjykimit (përgjegjësisë-shpërbimit)! Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm te Ti kërkojmë ndihmë!...*” (El Bekare, 1-4).

Në këtë rast, në suren *El Fatiha*, Sherif Ahmeti në përkthim i ka shkruar saktë dhe korrekt emrat e bukur dhe cilësitë e Allahut.

(MOS)PËRDORIMI I KLLAPAVE

Të gjithë përkthyesit e Kuranit i përdorin shenjat e kllapave në përkthimet e tyre. Vetë përdorimi i kllapave tregon se përkthyesit kanë konsultuar komente të ndryshme të Kuranit. Është e domosdoshme që përkthyesi i Kuranit në situata të caktuara të përdorë shenjat e kllapave për të sqaruar ndonjë fjalë të caktuar dhe kuptimin e duhur në ajetin e caktuar, por me përdorimin e tepruar të kllapave humbet kuptimi i vërtetë dhe intenca e ajeteve kuranore.

Me anë të shembujve të veçantë që do përmendim, do të konstatojmë se edhe Sherif Ahmeti përdori shenja të kllapave:

فَمَنْ كَانَ مِنْكُمْ مَرِيضًا أَوْ عَلَى سَفَرٍ فَعِدَّةٌ مِنْ أَيَّامٍ أُخَرَ

Sherif Ahmeti këtë ajet e përktheu si vijon: “*Po kush është prej jush i sëmurë ose ka mundim koke (e rruhet para kohe)...*” (El Bekare, 196).

Siç mund të shihet, Sherif Ahmeti kishte vepruar drejt edhe kësaj here, duke përdorur shenjat e kllapave.

فَمَنْ كَانَ مِنْكُمْ مَرِيضًا أَوْ عَلَى سَفَرٍ فَعِدَّةٌ مِنْ أَيَّامٍ أُخَرَ

Sherif Ahmeti këtë ajet e përktheu si vijon: “*...e kush është i sëmurë prej jush ose është në udhëtim (e nuk agjëroi), atëherë ai (le të agjërojë) më vonë aq ditë...*” (El Bekare, 184).

Sherif Ahmeti edhe në këtë rast ka vepruar drejt duke përdorur shenja të kllapave.

- 1 Kur'an-i, përkthim me koment (përkthim me koment) përktheu dhe komentoi: H. Sherif Ahmeti, Kryesia e Bashkësisë Islame të Serbisë RS - Prishtinë, (Prishtinë: 1988), 22.
- 2 Për më shumë shih: Jusuf Ramić, *Tefsir – historija i metodologija*, Biblioteka e botimeve të veçanta – Libri 6, Fakulteti i Shkencave Islame në Sarajevë, (Sarajevë: 2001), 256.
- 3 Ferid Dautović, “O prevođenju Kur'ana (Stavovi nekih islamskih učenjaka)”, *Novi Muallim*, nr. 10, (Sarajevë: 2002), 42.
- 4 Kur'ani-i, përkthim me komentim, përktheu dhe komentoi: H. Sherif Ahmeti, *op. cit.* f. 23.
- 5 Sipas Muhamed Mahlufit, كيف يصرفون عن الحق do të thotë: “Si largoheni nga e Vërteta pas shkëlqimit (përhapjes) të saj.” Shih: Muhamed Mahluf, *Kelimatul-l-Kur'an*, Memleketu-l-arabijje es-Suudijje, 1416. H./1995, 105.
- 6 *The Noble Qur'an*, English translation of the meanings and commentary by Dr. Muhamed Taqiudin al Hilali and Dr. Muhamed Muhsin Khan, King Fahd Complex For The Printing Of The Holy Qur'an, Madinah, (K.S.A: 1417 H.), 248.
- 7 *The Holy Qur'an (Koran)*, English translation of the meaning by Yusuf Ali, Published and printed by the King Fahd Holy Qur'an Printing Complex, Formatting by William B.Brown, (K.S.A: 1987), 86.
- 8 *Kur'an Časni - prevod i tumač*, përkthjen dhe përgatitën: Hafiz Muhammed Panxha dhe Xhemaludin Čausheviq, (Sarajevë: 2012), 286.
- 9 Shih në përkthimet e tyre të Kuranit.
- 10 Hajrullah Hoxha, “Një vështrim kritik punimit me titull: ‘Më shumë kujdes për botimin e përkthimit dhe interpretimit të Kuranit në gjuhën shqipe’”, *Edukata Islame*, nr. 92, (Prishtinë: 2010), 257.



“Historia është regjistruese e ngjarjeve në kohë dhe transmetuese e tyre për brezat që do të vijnë”


Prof. asoc. dr. Shkodran Imeraj

Mendim profesional mbi librin monografik: “Kontributi i hoxhallarëve në përpjekjet për zgjidhjen e çështjes shqiptare gjatë shekullit XX”, të autorit prof. dr. Fahrush Rexhepi, mësimdhënës pranë Fakultetit të Studimeve Islame në Prishtinë, botuar nga Shtëpia Botuese “Dituria Islame”, Prishtinë 2024, 531 faqe.

“Historia është regjistruese e ngjarjeve në kohë dhe transmetuese e tyre për brezat që do të vijnë.” Me këtë maksimë e nis këtë mendim profesional mbi librin “Kontributi i hoxhallarëve në përpjekjet për zgjidhjen e çështjes shqiptare gjatë shekullit XX”, të autorit prof. dr. Fahrush Rexhepi, mësimdhënës dhe ish-dekan i Fakultetit të Studimeve Islame në Prishtinë, libër ky i botuar nga Shtëpia Botuese “Dituria Islame”, i cili ka dalë në shtyp në fund të vitit 2024 dhe përmban 531 faqe.

Prof. dr. Fahrush Rexhepi është një emër i shquar i shkencës, i cili gjatë gjithë jetës së tij profesionale dhe akademike i ka fokusuar studimet në historinë e popullit shqiptar, me theks të veçantë te historia dhe roli i prijësve fetarë islam, që nga periudha e shpalljes së pavarësisë së shtetit amë shqiptar e deri në luftën e fundit për çlirimin e Kosovës më 1998–1999.

Libri monografik i prof. dr. Fahrush Rexhepit me titull “Kontributi i hoxhallarëve në përpjekjet për zgjidhjen e çështjes





shqiptare gjatë shekullit XX”, është një vepër kapitale me vlera të veçanta shkencore, pasi që në të janë renditur dhe përmbledhur në mënyrë kronologjike ngjarje me peshë në historinë e shqiptarëve në përgjithësi, dhe veçanërisht në historinë e Kosovës.

Libri përbëhet nga pesë pjesë (kapituj), të shoqëruara nga një parathënie dhe një hyrje, ndërsa në fund përfshihen përfundimet, shënimet për autorin, një fjalor i orientalizmeve të përdorur në gjuhën shqipe, burimet dhe literatura, si dhe treguesi i emrave.

Pjesa e parë, me titull “Çështja shqiptare dhe rrethanat në fillim të shekullit XX”, përmban tre nëntituj ku autori trajton etnokulturën dhe raportet e Shqipërisë me gjeopolitikën para shpalljes së pavarësisë. Me theks të veçantë, është trajtuar roli i fesë islame në zhvillimin e etnokulturës dhe pozicionimi i saj në kuadër të gjeopolitikës në fillimet e Luftës së Dytë Botërore. Më tej, trajtohet ndarja e zonave të pushtimit nga aleatët nazifashistë, dhe në fund, roli i prijësve fetarë islam në afirmimin e kërkesës për ribashkimin e trojeve shqiptare në një shtet të vetëm. Autori thekson se

Një vepër kapitale me vlera të veçanta shkencore, pasi që në të janë renditur dhe përmbledhur në mënyrë kronologjike ngjarje me peshë në historinë e shqiptarëve në përgjithësi

regjimi komunist me vetëdije arriti të lërë në harresë kontributin e prijësve fetarë islam, duke përmendur figura të shquara si: myderriz Ymer Prizrenin, haxhi Zekë Byberin, Murtez ef. Luzhën, Hasan ef. Shllakun, Hafiz Gutën, Asim ef. Luzhën, mulla Idriz Gjilanin, etj..

Brenda kësaj pjese, autori ka trajtuar edhe periodikun islam gjatë Luftës së Dytë Botërore si një dritare për çështjen kombëtare dhe bashkimin e shqiptarëve.

Pjesa e dytë, me titull “Roli i hoxhallarëve në rrjedhat shoqërore e politike të periudhës së mbretërisë shqiptare 1941–1944”, përbëhet nga gjashtë tituj. Këtu ofrohen të dhëna për xhematet në tokat e liruara (1935), për organizimin institucional të komunitetit mysliman në Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut, si dhe për personelin dhe institucionet fetare në Prishtinë gjatë viteve 1944–1943. Autori analizon edhe nëpunësit e vakëfit të madh, ata të Ferizajt, imamët në Prizren, Suharekë dhe Dragash.

Me mjeshtëri profesionale, prof. dr. Rexhepi trajton pozitën e myslimanëve nën okupimin

jugosllav (1912–1941), si dhe historikun e medreseve: në Shkup, Gjakovë, Gjiilan, Prishtinë, Tiranë dhe Shkodër. Po ashtu, jep informacion për bibliotekat që funksiononin në kuadër të këtyre institucioneve.

Vëmendje i kushtohet edhe zhvillimit të periodikut islam dhe figurave të rëndësishme si: Sadik Ramadan Bega, Haki Sharovi, sheh Muharrem Mitrovica, Vexhi Buharaja, si dhe revistave si “Zani i Naltë”, “Kultura Islame”, etj..

Pjesa e tretë, me titull “Roli i hoxhallarëve në organizimin dhe në udhëheqjen e mbrojtjes kombëtare shqiptare”, për nga pesha dhe rëndësia është pjesa qendrore e studimit. Këtu jepen të dhëna për figura të shquara, të cilët duke u mbështetur edhe në mësimet fetare morën armët për të udhëhequr popullin në luftë, si: haxhi Ilaz Agushi, mulla Idriz Hajrullah Velekinca, haxhi Jajah Daci, mulla Zekë Berdynaj, mulla Iljaz Spahi Broja, Haki ef. Sermaxhaj, mulla Nurë Gjoinoci, etj..


Po ashtu, jepen të dhëna për përpjekjet e hoxhallarëve në pengimin e shpërnguljes së shqiptarëve dhe në organizatat politike.

Pjesa e katërt, me titull “Hoxhallarët në periudhën e ngritjes dhe të konsolidimit të pushtetit komunist në arealin shqiptar 1945–1951”, është e ndërtuar në pesë tituj dhe disa nënsythe. Këtu trajtohet roli i hoxhallarëve në konsolidimin e shtetit shqiptar pas Luftës së Dytë Botërore dhe raportet mes fesë dhe shtetit (1945–1967). Jepen të dhëna për kundërshtimin që prijësit fetarë islam i bënë sistemit komunist, drejtuesit e Komunitetit Mysliman Shqiptar, dhe organizimi i Bashkësisë Fetare Islame në Kosovë, si dhe i Bashkësisë Katolike të Kosovës. Po ashtu trajtohet persekutimi i ulemasë nga regjimi komunist, duke përfshirë hafëz Ali Korçën dhe të tjerë që u vunë në shënjestër të likuidimit.

Pjesa e pestë, me titull “Kontributi i hoxhallarëve në organizatat politike ushtarake nacional-demokratike shqiptare”, përfshin tri tituj. Kjo pjesë sjell të dhëna për rolin e hoxhallarëve në gjysmën e dytë të shekullit XX, përfshirë Lidhjen e Dytë të Prizrenit. Vëmendje të veçantë i kushtohet kontributit të elitës fetare në hapjen dhe ruajtjen e arsimit shqip në Kosovë pas Luftës së Dytë Botërore, përmes figurave si: mulla Sherif Ahmeti, mulla Abdyl Tahiraj, Muharrem Sherfi Krasniqi, etj..

Studimi monografik “Kontributi i hoxhallarëve në përpjekjet për zgjidhjen e çështjes shqiptare gjatë shekullit XX”, i autorit prof. dr. Fahrush Rexhepi, është një kontribut me rëndësi të veçantë shkencore që hedh dritë mbi rolin e prijësve fetarë islam në të gjitha hapësirat shqiptare, veçanërisht në Kosovë. Historiografia jonë tashmë ka një studim të mirëfilltë, të mbështetur në burime arkivore dhe literaturë të pasur shkencore, të ndërtuar në nivel të lartë profesional.

Libri ka një redaktim shkencor të denjë, një lekturë gjuhësore cilësore dhe është realizuar teknikisht brenda



standardeve shkencore. Autori, me përkushtimin dhe profesionalizmin e tij, ka sjellë një vepër me vlera të mëdha, duke e bërë këtë studim një referencë të rëndësishme për qarqet akademike dhe shkencore brenda dhe jashtë hapësirave shqiptare.

VLERËSIMI PËRMBLEDHËS

Vepra e prof. dr. Fahrush Rexhepit është një kontribut i rëndësishëm në historiografinë shqiptare dhe islame. Ajo ofron një analizë të thellë, të matur dhe të argumentuar mbi një temë që ende kërkon më shumë vëmendje shkencore. Gjuha e përdorur është e qartë dhe profesionale, ndërsa struktura e veprës ndihmon në leximin e rrjedhshëm dhe të organizuar. Metodologjia e studimit është e qëndrueshme, e bazuar në burime primare dhe dytësore, me një qasje që respekton standardet akademike bashkëkohore.

Kjo monografi është e vlefshme për studiuesit e historisë, teologjisë, sociologjisë dhe shkencave politike, por edhe për opinionin e gjerë që kërkon të kuptojë më mirë rolin e Islamit te shqiptaret në proceset historike të shekullit XX.

Mulla Fejzullah ef. Guri (1927–2013) – një jetë, një veprimtari, një trashëgimi

Blertona Kriva

Studimi i jetës dhe veprimtarisë së Fejzullah ef. Gurit përfaqëson një rast domethënës në historikun e detyrës së imamit dhe mualimit në Kosovë dhe përtej saj edhe në Maqedoninë e Veriut gjatë shekullit XX. Ai përfaqëson modelin e imamëve të cilët, me gjithë kushtet e vështira politike dhe ekonomike që mbizotëruan asokohe, ruajtën përkushtimin ndaj fesë, dijes dhe shërbimit ndaj xhemitit. Ky punim, i mbështetur në dokumentet arkivore dhe dëshmitë gojore, përpaket të sjellë një skicë për një punim më të gjatë për jetën, punën dhe ndikimin e tij.

Përvoja që paraqes në këtë shkrim është nisur nga një takim i papritur me një libër të vjetër në xhaminë e fshatit Nikaj (Kaçanik). Në pamje të parë një libër i zakonshëm dhe

i dëmtuar nga koha, ai u shndërrua në pikën e kthesës që më shtyu të thellohem në jetën dhe veprimtarinë e Mulla Fejzullah efendiut – imam i devotshëm dhe kontribuues i palodhur në jetën fetare dhe arsimore. Ky refleksim personal përmban vëzhgimet e para që më shtynë drejt një hulumtimi më të gjerë dhe më të thellë, me qëllim dokumentimin dhe vlerësimin e trashëgimisë së tij shpirtërore dhe kulturore.

PËRJETIMI PERSONAL

Në një skaj të xhamisë sonë në fshatin Nikaj, qëndronte një dollap përplot me libra, dhe në raftin e parë të tij gjendeshin disa prej tyre, të cilët, që në shikim të parë, vëreheshin se ishin të vjetër. Mendoja se të gjithë ishin mus'hafë. Vjetërsia e tyre vërehej qartë nga ngjyra e letrës, nga kopertinat e vjetra e, diku-diku, edhe të dëmtuara. Njëri prej tyre më tërhoqi vëmendjen dhe e mora më shpesh nëpër duar. Mirëpo, për shkak të pamundësisë për të kuptuar gjuhën e tij, e vendosja përsëri në raftin ku rrinte ai. Më pas mësova se është një libër që trajton hytbe me tema të ndryshme. Autori i tij nuk dihet, ngase mungojnë faqet e para dhe të fundit të librit, dhe për pasojë mungon edhe emri i autorit. Sa i përket vjetërsisë së tij, nuk kam ndonjë të dhënë të saktë, pasi nuk kam hasur ndonjë shkrim brenda që të dëshmojë datën e botimit apo të blerjes. Gjithashtu, as nga familjarët e të ndjerit e as nga nxënësit e tij nuk kam arritur të siguroj ndonjë informacion për këtë. E vetmja e dhënë që kam gjetur në libër është çmimi – 120 dinarë. Mendoj se pesha e këtij libri nuk qëndron në vjetërsinë e tij, por në faktin se Mulla Fejzullah efendiut, i cili ka dhënë një kontribut të madh në xhaminë e fshatit Nikaj, i ka mbajtur hytbet e ditës së xhuma nga ky libër, duke përzgjedhur çdo javë nga një temë tjetër. Kjo është edhe



arsyeja që më shtyu ta analizoj këtë libër. Libri është tërësisht i shkruar në gjuhën arabe, gjë që më bëri të kuptoj se hoxha ynë kishte njohuri të mira në këtë gjuhë. Prandaj vendosa t'i pyes disa prej nxënësve të tij – Albulenën, Xhemilën, Shpresën dhe Dijetarin, – të cilët e konfirmuan këtë informacion. Brenda dy kopertinave të këtij libri gjenden shumë tema të ndryshme, ku shumica trajtohen në një faqe e gjysmë, por ka edhe tema më të gjata që shtrihen në pesë apo gjashtë faqe.

Ky libër, i thjeshtë në pamje, u bë për mua dritarja drejt një bote të pasur me përkushtim dijetari dhe veprimtari të heshtur, por me ndikim të thellë. Ai u bë jo vetëm objekt studimi, por frymëzimi për të hulumtuar më tej rrugën e një imami që, përmes hytbevedhe përkushtimit të tij të përditshëm, kishte lënë gjurmë në zemrat e shumë gjeneratave. Ky rast më mësoi se pas heshtjes së librave të vjetër qëndrojnë histori të gjalla, të cilat meritojnë të dëgjohen, dokumentohen dhe të bëhen pjesë e kujtesës sonë kolektive.

JETËSHKRIMI I MULLA FEJZULLAH EF. GURIT (1927–2013)

I regjistruar në librin amë si i lindur më 10.1.1927 në një familje bujare, nga i ati Halimi dhe e ëma Latifja, si fëmijë i katërt pas dy vëllezërve dhe një motre. Por të dhënat e letërnjoftimit të tij nuk janë të sakta për arsye se sipas fjalëve të Mulla Fejzës, siç e quanin dhe siç njihej botërisht, që i kishte thënë e ëma, ai ishte i lindur më herët se që është regjistruar në librin amë, pra datëlindja e saktë duhet të jetë para katër vjetëve. Do të thotë viti i lindjes është 1923, pra 5 maj të atij viti. I ati i tij Halimi, i edukuar në frymën fetare islame, e udhëzoi Fejzën të ndjek rrugën e tij pasi që ai ishte fetar, falte namaz gjithnjë. Fejza mësimet e para të fesë filloi t'i merrte në mejtepin të cilin e mbante mulla Ramadan ef. Dullovi nga fshati Biqec. Këto mësimet e para fetare mulla Fejzës i zgjatën përafërsisht tri vjet. Mosha kur filloi t'i ndiqte këto mësimet fetare ishte 8 vjeçe. Pas kësaj moshe filloi t'i ndiqte mësimet fetare në Medresenë në Shkup, te hafëz Aziz Efendiu nga Kaçaniku, i cili jetonte në Shkup. Gjatë kësaj kohe qëndronte në Medresenë e Shkupit. Mësimet


Mulla Fejza
gjatë luftës në
Kosovë, për
shkak të
moshës së
shtyrë, nuk
mundi të
marrë pjesë në
luftë si ushtar,
por ai ishte i
vetmi që
qëndroi në
katund dhe
nuk u largua.
Po ashtu gjatë
kësaj kohe doli
për çdo namaz
në xhami dhe
fali namazet
ditore.

në Medresenë e Shkupit i zgjatën përafërsisht pesë vjet. Pas kësaj vazhdoi mësimet në Han të Elezit te Rushan Efendiu nga Odri i Tetovës. Në Han të Elezit ndoqi mësimet afër tri vjet, për të vazhduar në Odër të Tetovës tek i njëjti hoxhë, pra te Rushan Efendiu. Këto mësimet zgjatën afërsisht një vjet. Në xhaminë e Nikajve, asokohe imam ishte mulla Selmani i Nikajve, ku mulla Fejza ishte myezin i tij përplot dhjetë vjet (në këtë periudhë për tre ramazane shërbeu lutjet fetare dhe fali taravitë në fshatin Dernogllavë të Kaçanikut), për ta zëvendësuar atë pastaj deri në fund të vitit 2012.

Periudha e fillimit si imam në xhaminë e Nikajve ishte shumë më vonë se viti 1948, sepse po në këtë kohë filloi të mbahet edhe mësimi leximi i nxënësve të parë të kësaj treve. Pra kjo xhami filloi të shërbente edhe si shkollë e parë në këtë trevë me mësuesin Kadri Blosi nga Elbasani i Shqipërisë. Detyrën si myezin mulla Fejza e kreu deri në vitin 1958. Ngase më 1 janar të vitit 1959 kaloi në detyrën e imamit të kësaj xhamie pa dekret të rregullt për shkak të mungesës së dokumentacionit dhe shkollimit të nevojshëm. Megjithatë, veprimtaria e tij në xhami vazhdoi në mënyrë aktive. Provimi për imam dhe njohja zyrtare ndodhi më 21 tetor 1959, ku ai dha me sukses provimin për imam pranë Medresesë së Ulët në Prishtinë në lëndët: Kuran, akaid, fikh, etikë islame, histori e Islamit, imamat, pedagogji dhe gjuhë. Emërimi zyrtar u bë pas dhënies së provimit dhe përgatitjes së dokumenteve, me propozim të Këshillit të xhematit në Kaçanik dhe Komisionit të Bashkësisë Islame në Prishtinë, ai u emërua zyrtarisht imam i xhamisë në Nikaj me dekret nr. 1408 datë 1.2.1962, i konfirmuar nga Kryesia Supreme Islame në Sarajevë.

Për shkak të kushteve të vështira ekonomike, në vitin 1969 detyrohet të migrojë përkohësisht në fshatin Graçan të Shkupit, ku edhe filloi punën si imam në këtë fshat.

Mirëpo, pasi që fshati Nikaj mbeti pa imam dhe banorët e fshatit Nikaj kërkuan që mulla Fejza të rikthehet sërish në fshatin Nikaj, pra nga viti 1970, filloi sërish ta kryejë detyrën e imamit të xhamisë në Nikaj deri në fund të vitit 2012. Vlen të theksohet se mulla Fejza



gjatë luftës në Kosovë, për shkak të moshës së shtyrë, nuk mundi të marrë pjesë në luftë si ushtar, por ai ishte i vetmi që qëndroi në katund dhe nuk u largua. Po ashtu gjatë kësaj kohe doli për çdo namaz në xhami dhe fali namazet ditore. Gjatë kësaj periudhe që shërbeu si imam i xhamisë ishte shumë i përkushtuar pra, pesë vaktet e namazit i falte gjithnjë në xhami pa marrë parasysh kushtet e vështira: borë, shi, acar, të cilat nuk e ndalen kurrë dhe lirisht mund të themi se ishte një ndër imamët më të përkushtuar që i bëri shërbim banorëve të këtij fshati. Mulla Fejzullah ef. Guri vdiq më 15.6.2013.

GJURMËT E DIJES – SI E KUJTOJNË NXËNËSIT MULLA FEJZËN

Një mision i përkushtuar që zgjati gati gjashtë dekada nuk do të ishte i plotë pa zërin e atyre që më së shumti përfituan nga ai – nxënësit e mulla Fejzullah Gurit. Gjatë afro 60 vjetëve, në duart e tij kaluan breza të tërë që morën dritën e diturisë nga ai. Përmes këtyre rrëfimeve, rikthehemi në ditët kur nxënësit tuboheshin në mejtepin e tij, në kërkim të diturisë dhe udhëzimit shpirtëror.

Shpresa Guri – Kam filluar të mësoj që në moshën 8-vjeçare dhe kam ndjekur mësimet për tri vjet në xhami. Fillimisht ishim shumë nxënës, por numrin e saktë nuk e kujtoj. Mulla Fejza na mësonte dhe edukonte me përkushtimin dhe dashurinë më të madhe. Në fund të atyre tri vjetëve, në moshën 11-vjeçare, përfundova hatmen. Në atë kohë, çdo familje kishte odën e miqve, dhe familja ime organizoi një mevlud për këtë rast. Merrnin pjesë rreth 80 të afërm – burrat qëndronin në odë, ndërsa gratë në pjesën tjetër të shtëpisë.

Edhe pse kanë kaluar shumë vite dhe sot jetoj në Zvicër si nënë e tre fëmijëve, mësimet e mulla Fejzës më kanë përcjellë gjatë gjithë jetës. Mësonim në xhami gjatë verës, ose në

mahfil, ndërsa në dimër, për shkak të të ftohtit, mulla Fejza na merrte në shtëpinë e tij. Ishte një sakrificë që në atë kohë nuk e kuptoja, por sot e kuptoj se ai ishte një njeri që e jetonte me përkushtim misionin e tij fetar.

Më kujtohet se gjatë verës, edhe kur kishte punë në arë, ai na mësonte para sabahut, falnim së bashku namazin, dhe më pas shkonte të punonte tokën. Pavarësisht lodhjes, kthehej gjithmonë për të udhëhequr namazet ditore. Edhe pas martesës sime, sa herë më shihte, më pyeste: “A po falesh? A po lexon Kuran?” Këto kujtime më japin të kuptoj se përkushtimi i tij ndaj nxënësve nuk përfundonte me mësimet, por zgjaste me vite. Mulla Fejza ishte një njeri që kujdesej jo vetëm për edukimin tonë fetar, por edhe për pastërtinë e xhamisë. Ai do të mbetet përherë mësuesi im i parë, një figurë e pazëvendësueshme që më dha dije dhe forcë për t’u përballur me sfidat e jetës. Ai do të mbetet gjithmonë në lutjet e mia.

Albulena Guri - Mulla Fejzullah Guri ka lënë pas një trashëgimi të pasur mësimesh dhe udhëzimesh që kanë ndikuar thellësisht në formimin tim personal dhe shpirtëror. Ishte një imam i devotshëm, i njohur për diturinë dhe pasionin që kishte për përhapjen e vlerave islame.

Nga mësimet e tij mësova përkushtimin ndaj urdhrave të Zotit, rëndësinë e diturisë, etikën, dashurinë për atdheun dhe jetën me dinjitet. Ishte pikërisht ai që më frymëzoi të vazhdoja studimet në degën e Letërsisë Shqipe.

Mësimet fetare i fillova në moshën 7-vjeçare. Fillimisht mësova disa sure, më pas mënyrën e faljes së namazit, dhe gradualisht shkronjat arabe. Leximi i Kuranit erdhi më vonë. Mësoheshim sipas metodave tradicionale – 33 kushtet e fesë ishin ndër mësimet që i kujtoj ende sot. Më vonë bëra tri hatme nën udhëheqjen e tij.

Mulla Fejza na jepte mundësinë të këndonim ilahi, të cilat ai i dëgjonte me kënaqësi. Kishte një zë të ëmbël kur lexonte Kuranin – një përvojë e paharrueshme për çdo nxënës që pati fatin ta ndjekë. Mësimet që ai ka lënë pas janë të shumta dhe mund të them se mësimet kryesore të tij që më përcollën deri sot janë: Përkushtimi ndaj urdhrave të Zotit, vlera dhe rëndësia e diturisë, etika e mirë, dashuria ndaj atdheut etj..

Kenan Malsiu - Kam filluar të mësoj te mulla Fejza në vitin 2002, kur isha 13 vjeç. Ishim shumë nxënës. Mësuam suret e fundit, mënyrën e faljes së namazit dhe leximin e Kuranit. Ai kishte një zë të bukur dhe ishte një mësues i përkushtuar në punën që bënte. Edhe pse kanë kaluar mbi 20 vjet, mësimet e tij kanë mbetur të gjalla në mendjen time dhe më kanë frymëzuar që të ndjek të njëjtën rrugë të dijes.

Dijetar Guri - Kam filluar të vijoj mësimin në xhami gjatë viteve 2002-2010, që nga moshë 7-vjeçare. Frymëzimi im ishte gjyshja ime, e cila nuk e linte asnjëherë namazin e teravive pa falur në xhami. Ngase edhe gratë qysh në atë kohë

vinin dhe faleshin në xhami gjatë kohës së muajit Ramazan, e ndonjëherë edhe për namazin e sabahut, andaj gjyshja më merrte me vete. Halla ime, që ishte 3 vjet më e madhe se unë, tashmë lexonte Kuran, dhe kjo më dha shtysën që të filloja edhe unë.

Në ditën e parë, mulla Fejza më pyeti: “Çfarë të shtyu të vish në xhami, ti je ende i vogël?” I thashë: “Dëshira e madhe për të mësuar fenë time.” Ai më përqafoi dhe më tha: “Je i mirëseardhur!”

Para se të filloja mësimin në xhami unë pata mësuar që të falesha dhe kur shkoja në xhami për namazin e drekës, mulla Fejza i drejtohej xhematit me fjalët shikoni këtë fëmijë sa i vogël është por sa shume di për fenë! Dhe drejtohej nga unë dhe më pyeste sa rekate i ka dreka? Pasi përgjigjesha më pyeste për ikindinë dhe vaktet e tjera nga sa rekate kanë? Dhe kjo më motivonte që të vazhdoj tutje për të mësuar më shumë. Mulla Fejza përdorte metoda të ndryshme që të na mësonte dhe motivonte. Ajo që më kujtohet mua është se fillimisht na mësonte shkronjat e Kuranit, por duke filluar nga shkronja e parë elif e deri në shkronjën e fundit njëherë vetëm formën e shkronjave. Në mësimin e sureve përdorte një metodë që për ne ishte stimulim që t'i mësonim suret. Çdoherë që mësonim sure na shpërblente me të holla. Pastaj i mësonim 33 shartet e Islamit. Në kohën që kam mësuar unë, afërsisht kanë qenë 20-25 nxënës që vijonim mësimin. Ne nxënësit ishim të ulur në tokë, ndërsa mulla Fejza zakonisht ulej në karrige dhe ne e dëgjonim atë. Pas një kohe, mulla Fejza më mësoi se si të bëhem myezin, pastaj shpeshherë më jepte mundësinë që ai duke qenë prezent, unë t'i prija xhematit në namaz. Nga ajo që unë pashë nga veprimet e mulla Fejzës dhe nga ato gjëra që ai mua mi tregonte, mbaj mend se mulla Fejza çdo ditë para namazit të akshamit lexonte nga një Jasin. Çdo muaj bënte nga një hatme, ndërsa në muajin Ramazan bënte tri hatme. Në ditën e xhuma e kishte zakon të vinte gjysmë ore më herët dhe këtë kohë e shfrytëzonte në leximin e Kuranit. Kishte zakon që çdoherë që vinte për ndonjë punë në familjen time, ose për vizitë, dhe gjithnjë më thoshte ta marrë Kuranin dhe ai të më dëgjonte duke lexuar një faqe Kuran. Me aq sa më kujtohet, mulla Fejza kishte një bibliotekë të pasur me libra dhe pata fatin që të më dhuronte tre libra. Ishte shumë i afërt me mua dhe kështu mësuesi im i parë u bë dhe frymëzimi im për të ndjekur rrugën e tij.

Mulla Fejzullahu ndërroi jetë në vitin 2013, por kujtimet dhe mësimet e tij vazhdojnë të jenë një burim frymëzimi për mua. Ai ishte një mësues që e shihte punën e tij si një mision dhe bëri gjithçka që mësimet e tij të mbeteshin përgjithmonë në mendjet dhe zemrat tona.

Albesian Guri - Mulla Fejzullah Guri ka qenë një nga figurat më të rëndësishme në jetën time. Kam filluar mësimet tek ai në vitin 2008, kur isha vetëm 7-vjeç. Fillimet ishin të thjeshta – mësimi i shkronjave arabe. Por ai nuk ishte një mësues i zakonshëm; ai na udhëzonte me durim dhe disiplinë, duke u kujdesur që të kuptonim dhe të përvetësonim atë që mësonim.

Një nga gjërat që e bënte të veçantë ishte mënyra si na motivonte. Herë pas here, ai më inkurajonte të thërrisja ezanin dhe të kryeja rolin e myezinit në xhami. Ishte një përgjegjësi që më ndihmoi të zhvilloja vetëbesimin dhe të kuptoja rëndësinë e shërbimit për komunitetin. Për më tepër, shpesh na shpërblente me të holla, një gjest i vogël që kishte një ndikim të madh te ne si fëmijë.

Fejzullah Guri ka qenë gjithmonë korrekt dhe i disiplinuar, duke na mësuar jo vetëm mësimet fetare, por edhe vlara si, respekti, përkushtimi dhe serioziteti në jetë. Ndonëse nganjëherë ishte i rreptë, kjo na ndihmoi të kuptojmë përgjegjësitë dhe të ndërtojmë karakterin tonë. Vëllai im gjithashtu ka qenë nxënës i tij dhe sot shërben si imam i xhamisë, një dëshmi e ndikimit të tij të madh.

Mulla Fejzullahu ndërroi jetë në vitin 2013, por kujtimet dhe mësimet e tij vazhdojnë të jenë një burim frymëzimi për mua. Ai ishte një mësues që e shihte punën e tij si një mision dhe bëri gjithçka që mësimet e tij të mbeteshin përgjithmonë në mendjet dhe zemrat tona.

PËRFUNDIM

Figura e Fejzullah ef. Gurit dëshmon për kontributin e heshtur, por të qëndrueshëm të imamëve në ruajtjen e jetës fetare në trojet shqiptare. Ai përfaqëson brezin që i mbijetoi sfidave politike dhe shoqërore, duke i dhënë prioritet shërbimit ndaj Zotit dhe komunitetit. Dokumentet arkivore dhe kujtimet gojore e përforcojnë imazhin e tij si imam shembullor dhe njeri me vlara të larta morale.

LITERATURA:

1. Dosja arkivore “Fejzullah ef. Guri”, Arkivi i Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, në Prishtinë, 1959–1969.
2. Intervistë me ish-nxënës të tij në fshatin Nikaj, Kaçanik, të dhëna gojore, maj 2024.
3. Dokumenti i provimit të Medresesë së Poshtme në Prishtinë, 1959.
4. Vendimi i BFI-së për emërim dhe shkarkim, dekret nr. 1408, 1962–1969.

Hani me dy porta

Artan Sadiku

Ishte princi i njohur i Belhit, Ibrahim Ed'hemi,¹ i cili i ulur në fronin e tij të florinjte, teksa një natë dëgjoji një zhurmë në çatinë e pallatit të tij dhe vendosi të ngjitej për të parë se ç'ishte. Kur pa një njeri, e pyeti: "Ç' bën këtu?" I tha: "Po e kërkoj devenë që më ka humbur." Ibrahim Ed'hemi i tha: "Çfarë flet? Shpreson ta gjejsh devenë mbi çati? Ç' lyp deveja mbi çati?" Ky i tha: "O gafil i përgjumur, ti kërkon Zotin ulur në fron të artë, e veshur me pelerinë të mëndafshhtë, a nuk është kjo më e çuditshme se deveja mbi çati?"²

Shpeshherë fjalët që përdorim kanë udhëtuar e bërë rrugë të gjatë, duke u transformuar e marrë kuptime të reja (shpesh kuptimi fillestar edhe harrohet), mirëpo gjuha mbetet monument i heshtur që na rikujton kuptimin primordial të gjërave. Kështu gjuha bëhet sikur muzeu i shpirtit njerëzor, që i reziston harresës nga pragmatizmi i imponuar ndaj gjuhës si mjet funksionimi, e zhveshur tashmë nga e përtejshmja që brumos secilën fjalë.

Një ilustrim i natyrës efemere të së kësobotshmes fshihet në kuptimet e fjalës arabe *bejt*, që në shqip përdoret në kuptimin: varg poetik. Janë të njohur bejtexhinjtë të cilët thurnin bejte, për të na thënë e stërthënë, si trokitje në dyert e mbyllura të territ egoist, për të hapur rrugë. Sepse bejtet janë si rrugët, drejtëza të pakufizuara në të majtë e në të djathtë, në to hyjmë e dalim për të ndërë frymën perpetuale të gjërave. Kuptimi tjetër i fjalës *bejt* në gjuhën arabe është 'shtëpi', e shtëpia si vargu, ka hyrje e dalje, në të hyjmë e dalim, bash sikur të ishte një han, një han me dy porta.

*"Mirë se erdhe, lamtumirë miku i dashur,
Shërbëtorët të tregojnë si duhet dalë,
T'gjithë banorët në këtë vend janë të dehur,
Nuk e dinë se po na shembet çatia mbi han."*³

Tregohet se si njëherë Rabia el Adevia⁴, kishte humbur një unazë. Kur e panë duke kërkuar unazën në rrugë, i thanë: a të kujtohet se ku e ke humbur më saktësisht? Tha: "Unazën kam humbur në shtëpi, por po e kërkoj jashtë sepse brenda



shtëpisë është terr e nuk e gjej dot.”⁵ Domosdo që shtëpia e kërkimit është vetja jonë, por për t’i ikur kërkimit të vendit të vetëm ku edhe diçka mund të gjetet, ne shmangim atë duke kërkuar çdo kund tjetër, pos aty ku vërtet humb çfarëdo që mund të humbet, shtëpia. E siç është shtëpia për hapësirën, ashtu është edhe rituali për kohën, është ‘shtëpi’⁶, duke e stolitur kohën me orenditë e shtëpisë, e duke e bërë atë të banueshme, prej fryme në frymë, prej vakti në vakt, prej cikli në cikël.

Kjo frymë, si në gjuhë është ruajtur edhe në këngët e endacakëve ashikë e baulë, në një gjeografi të gjerë nga Bangladeshi në Ballkan. Ata me dukjen prej lypsarësh, mospërfillës për shtëpinë e kësobotshme, siç përshkruan këtë gjendje Omar Kajami në një bejt të vetëm:

“Në qiell pa shpresë dhe pa shtek mbi dhé...”⁷

Sa e sa banorë të bejteve të çastpërçastshme, shpjegojnë shtëpinë e tyre të vetme – bejtin, ndër të cilët Ashik Vejseli, i cili na rikujton se si kjo shtëpi-varg, është në fakt një han:

“Në këtë han me dy porta,

Ditë e natë udhën vazhdoj,

Assesi hallin vetes t’ia di...”⁸

Këto e të tjera vargje këngësh mbi ‘Hanin me dy porta’, jehojnë në unison me sa e sa këngë popullore e vargje të kënduara në gjeografi aq të gjerë e periudhë aq të gjatë kohore, porse sikur përsërisin po të njëjtën. Kjo jehonë është thirrje, që sikur dëshiron të na thotë: ‘Le të vazhdojnë bejtet, hyr e del në to, veç le të mos pushojmë të fjetur e gafilë në këtë shtëpinë tonë të rrejshme prej rrjete merimange.’ E ky është një rikujtues për këdo që ka ngritur e banon në këso ‘shtëpi’ merimangash: ‘Parabola e atyre që marrin për mbrojtës përveç Zotit, është si ajo e shtëpisë së merimangës, e ajo është shtëpia më e dobët.’⁹

“Plot mysafirë,

Vijnë edhe shkojnë,

Dikush më parë,

E dikush më vonë.”¹⁰

Se urgjenca e kësaj thirrjeje është aq e madhe na ilustron aq bukur një tregim nga Attar, i cili na e risjell princin nga Belhi. Kur një ditë, një njeri erdhi në pallatin e Ibrahim Ed’hemit, me madhështi e rrufeshëm, saqë

nuk pati kohë as për shërbëtorët e tij t’i dilnin para, por arriti drejt e te froni i Ibrahim Ed’hemit dhe kur e pyeti se çfarë donte, ky i tha:

‘Erdha të qëndroj në këtë han.’ I tha:

‘Ky nuk është han, por është saraji im.’ I tha:

‘E para teje i kujt ishte ky saraj?’ Tha:

‘I babait tim.’

‘Po para tij?’

‘I filanit.’

‘E para tij?’

‘I babait të filanit.’

‘E ku janë të gjithë ata tani?’

‘Të gjithë kanë vdekur. Kanë kaluar nga këtu.’

Atëherë, përfundimisht i tha:

‘A nuk qenka ky një han, njëri dalka e tjetri hyka?’¹¹

E për të kuptuar këtë, u desh një shërbëtor t’ia mësonte princit të Belhit, i cili e bëri që të largohej përgjithmonë nga pallati i vet, për të bredhur rrugëve, bejteve, haneve, e sokakëve, pa u ndalur, sepse e dinte se rruga ishte e vetmja rrugë.

“Mirë se erdhe, lamtumirë miku i dashur,

Shërbëtorët të tregojnë si duhet dalë,

Udhëtarët nuk kanë vend për t’u çlodhur,

Mirë e dinë se po na digjet hambari në han.”¹²

“Mirë se erdhe,
lamtumirë
miku i dashur,

Shërbëtorët të
tregojnë si
duhet dalë,

Udhëtarët nuk
kanë vend për
t’u çlodhur,

Mirë e dinë se
po na digjet
hambari në
han.”

1 Ibrahim Ed’hem i ishte princ i Belhit, por një ditë doli në gjueti me shërbëtorët e pallatit të tij mbretëror dhe u nda prej tyre duke shkuar pas një drenushë. Duke u bërë dëshmitar i një mrekullie, u kthye në rrugën shpirtërore dhe hoqi dorë nga të gjitha pozitat, duke bredhur si fukara endacak. Për më shumë shih: *The Kashf al-Mahjub*, by Hazrat Ali bin Usman Al-Hujwiri (r.a.), përkthyer nga: Reynold A. Nicholson, Zia-ul-Quran Publications, Lahore, 2001.

2 Feriduddin Muhamed Attar, Tezkiretul evlijâ, edituar nga dr. Muhamed Isti’lami, f. 88.

3 Petrit Çarkaxhiu, teksti i këngës ‘Hani me dy porta’.

4 Rabia el Adevia ishte një skllave, e cila fitoi lirinë e saj, siç tregohet, pasi pronari i saj ishte dëshmitar i mrekullive të ndryshme. (për më shumë shih: Muhamed Attar, Tezkiretul evlijâ, edituar nga dr. Muhamed Isti’lami, f. 61-75)

5 Mehmed Karahodžić – Komentimi i Mesnevisë së Mevlana Runit, vëllimi i parë, ligjërata nr. 1 (04.09.2013).

6 Antoine de Saint-Exupéry, Citadelle, 1948.

7 Omar Kajam – Rubairat, përkthyer nga Rushit Bilbil Gramshi (Pseudonim i Fan Nolit) Edicioni i dytë, e ndrequr dhe e plotësuar. Bruxelles, 1927.

8 Aşık Veysel Şatıroğlu, teksti i këngës ‘Uzun ince bir yoldayım’.

9 Kuran, kaptina Merimanga, 41.

10 Petrit Çarkaxhiu, teksti i këngës ‘Hani me dy porta’.

11 Feriduddin Muhamed Attar, Tezkiretul evlijâ, edituar nga dr. Muhamed Isti’lami, f. 88.

12 Petrit Çarkaxhiu, teksti i këngës ‘Hani me dy porta’.

Ebul-Kasim Halef b. Abbas el Zahravi – dijetari i madh i mjekësisë

Sead Ahmetaj

Emri i plotë i studiuesit të mjekësisë andaluziane Zehravi, i cili është i njohur për risitë që solli në fushën e kirurgjisë, është Ebul-Kasim Halef b. Abbas el Zahravi. Mendohet se Zehravi ka jetuar mes viteve 936-1013. Ai njihet si Zehravi, sepse lindi në qytetin Zehra të Andaluzisë. Ai mori mësim nga studiues si Ibni Xhulxhuli, Ebu Bekir er Razi dhe Ibnul Cezar el Kayrevani, të cilët ishin dijetarë të mëdhenj të asaj periudhe. Me këtë edukim dhe formim, ai u edukua shumë mirë si teorikisht, ashtu edhe praktikisht. Përveç shkencës mjekësore, ai ishte i interesuar edhe për fizikën, matematikën dhe astronominë. Edhe pse Zahravi, ishte bashkëkohës i shkencëtarëve të shekullit XI, si Biruni dhe Ibën Sina, ai ishte i interesuar për degë të ndryshme të

mjekësisë, e më së shumti i njohur për punën e tij në fushën e kirurgjisë. Veprat e Zahraviut, i cili pranohet si babai i kirurgjisë në vendet perëndimore, janë përkthyer në gjuhë të ndryshme. Në Evropë quhej Abulcasis dhe Albucasis.

“Kitâbü’t-Tasrîf” është vepra e vetme e Zahraviut që ka arritur deri në ditët tona. Edhe pse kjo vepër është vepra më gjithëpërfshirëse e shkruar në fushën e kirurgjisë në Andaluzi, ajo tërhoqi vëmendje të madhe edhe në Evropë në periudhat e mëvonshme. Me fjalët e tij, ai e përshkroi veprën e tij si vijon: “Gjithçka që di ia detyroj vetëm leximit të kujdesshëm të librave të të parëve, dëshirës sime për t’i kuptuar ato dhe për ta përvetësuar këtë njohuri për veten time; vrojtimet dhe përvojën time të gjithë jetës i shtova punës sime. Më në fund, shkrova këtë libër, i cili përmban njohuritë dhe të gjitha përvojat e mia, i çliruar nga detajet e panevojshme dhe i shpjeguar sa më qartë.”

Ashtu si vepra e Ibën Sinasë e quajtur “El Kanun fi’t-Tib”, e cila u mësua si tekst shkollor në shkollat e Evropës deri në fund të shekullit XVII, edhe kjo vepër e shquar përbëhet nga tridhjetë kapituj. Nëse japim shembuj nga pjesët e veprës, atëherë në pjesën e parë jepet informacion i përgjithshëm mbi parimet mbi të cilat bazohet teoria tradicionale mjekësore; seksioni i dytë dhe më voluminoz i kushtohet patologjisë së përgjithshme dhe ka të bëjë me diagnostikimin dhe trajtimin e 325 sëmundjeve; në kapitullin e tretë dhe të njëzet e nëntë, trajtohet në përgjithësi tema e barnave dhe paraqiten në detaje vetitë farmakologjike, efektet, metodat e përgatitjes dhe ekuivalentët e shumë barnave të thjeshta dhe të kombinuara. Vepra është përdorur për qindra vjet në Evropë dhe botën islame dhe është përkthyer në gjuhë të ndryshme.






BABAI I KIRURGJISË DHE NDIKIMET E TIJ

Shumë emra që punojnë në fushën e mjekësisë në gjeografinë islame dhe evropiane i ndeshim në shekullin XI. Zahravi bëri një zbulim të ri në fushën e mjekësisë dhe përshpejtoi studimet në fushën e kirurgjisë, duke treguar se trajtimet nuk ishin të kufizuara në kauterizimin e thjeshtë, gjakderdhjen, prerjen e disa tumoreve, qepjen e disa plagëve dhe prerjeve dhe trajtimin e frakturave dhe dislokimeve të ndryshme. Ai dha një kontribut të madh në zhvillimin e kirurgjisë dhe teknologjisë kirurgjikale të asaj periudhe. Ai gjithashtu zhvilloi trajtime kirurgjikale për sëmundjet e traktit urinar. Ai bëri rekomandime të ndryshme për trajtimin kirurgjik për çështjet e androgjinisë, shpjegoi në detaje se si të hiqet fetus i gjatë lindjes dhe veçanërisht çfarë duhet bërë në rast të vështirësive në nxjerrjen e kokës së foshnjës. Zahraii është kirurgu i parë që prezantoi instrumentet kirurgjikale duke vizatuar piktura. Në punën e tij, ai përshkroi rreth 200 instrumente kirurgjikale dhe shpjegoi në detaje zonat e përdorimit të tyre. Ne shohim fotografi të afro 200 instrumenteve kirurgjikale në “*Kitābū’l-Tasrīf*”. Dorëshkrimi është shembulli i parë dhe i rrallë në mesin e librave mjekësorë evropianë dhe islamikë, në të cilin instrumentet kirurgjikale janë paraqitur me figura.

Shembuj të veglave janë si më poshtë: Gërshërë dhe thika të përdorura në aktivitete kirurgjikale, bisturi, instrumente kirurgjikale me majë të formave të ndryshme, metale që do të përdoren në prodhimin e tyre, si dhe format e instrumenteve, shiringat, gjilpërat e




Zahravi është kirurgu i parë që prezantoi instrumentet kirurgjikale duke vizatuar piktura. Në punën e tij, ai përshkroi rreth 200 instrumente kirurgjikale dhe shpjegoi në detaje zonat e përdorimit të tyre.

qepjes, gjilpërat e kataraktit, mjete të ngjashme me gërshërët që përdoren në tonsilektominë, bisturitë, pincat, gërvishtësit e gurëve dentarë, kateterët, instrumentet e gjinekologjisë, shiritin e tensionit për të akomoduar dislokimet e vertebrës dorsal dhe sharra të ndryshme.

Zahravi gjithashtu ka dhënë shpjegime të hollësishme për mënyrën e sterilizimit të instrumenteve kirurgjikale. Zahravi u ndal edhe në trajtimin me kauterizimin dhe shpjegoi se si trajtoheshin sëmundje të ndryshme dhe se si ndalohej gjakderdhja me këtë metodë. Ai lexoi me kujdes hadithet e Profetit tonë a.s. dhe kreu studime praktike. Një nga metodat, e cila është një praktikë mjekësore e bazuar në hadithet e Profetit a.s. për shëndetin, është trajtimi i kauterizimit. Dihet se në kohën e Profetit a.s., mjekimi bëhej me prerjen e damarëve, marrjen e gjakut dhe kauterizimin e plagës.

ZAHRABI KONSIDEROHEJ EDHE PIONIERI I KIRURGJËVE. LE TË FLASIM PËR DISA NGA PUNËT QË AI KA BËRË NË KËTË FUSHË:

Është mjeku i parë që përshkroi me detaje hemofilinë, një sëmundje shumë e shquar në botën e mjekësisë; Për të parandaluar rrjedhjen e gjakut gjatë operacioneve, ai shpiku teknikën e qepjes së venave për të parandaluar gjakderdhjen; Ai përdorte zorrët e maces si fije kirurgjikale dhe përdorte një kateter në traktin urinar; Duke punuar në inflamacionet e mushkërive, ai ia doli t'i trajtojë për herë të parë duke prerë me ndërhyrje kirurgjikale gjoksin dhe duke e kauterizuar atë; Ka kryer



operacionin e parë të hernies dhe ka përshkruar dhe diagnostikuar veçmas strumën dhe kancerin e gjëndrës tiroide; Ka kryer operacion për të trajtuar ënjtjet dhe tumoret në mitër. Ai ka pas një zgjidhje shumë të rëndësishme në lidhje me kancerin e mitrës; Për të zgjidhur problemin e dhëmbëve problematikë për sa i përket protezës, ai e zgjidhi duke lidhur një fije ari me trashësi mesatare mes dy dhëmbëve dhe kështu futi konceptin e protezës në dhëmbë; Ai gjithashtu hyri në histori si personi i parë që përdori qymyrin për distilim në mjekësi. Ai flet për përfitimet, vetitë dhe përbërjet e ilaçeve. Ai shpjegoi se cili ilaç është i mirë për cilën sëmundje; Ai përmendi ilaçet kundër dhimbjeve, emetikët, barnat që përdoren për pastrimin e zemrës, obezitetin dhe dobësinë, stomakun dhe zorrët, hollimin e gjakut, si dhe antidotet dhe recetat për përdorim kundër helmeve, lehtësimit të diarresë dhe kapsllëkut, epilepsisë, paralizës, paralizës së fytyrës, dhimbjes së dhëmbëve; Ai foli për ilaçe të mira për ftohjen, hemorroidet, dhimbjet e veshit dhe sëmundjet e syve, si dhe ilaçet për sëmundjet e dhëmbëve dhe mishrave të dhëmbëve, sëmundjet e gjoksit, astmën, gulçimin, ngjirjen e zërit dhe kollën; Emrin e ilaçit e ka shkruar për herë të parë në tableta. Ai shpjegoi ushqimet që duhet të hajë pacienti dhe si duhet të ruhen ilaçet. Ai gjithashtu shkroi për rëndësinë e emërtimit të barnave dhe datave të skadencës.

Si rezultat i këtyre studimeve, shkencëtari i madh i mjekësisë hodhi themelet e kirurgjisë moderne, i cili kishte njohuritë, guximin, praktikitetin, diagnozën dhe vetëbesimin e nevojshëm për të qenë një kirurg i mirë. Ai shkroi emrin e tij në histori me shkronja të arta.

Dy vëllimet e para u botuan në 1519 në Augsburg, me emrin “*Liber Theoricae nec non Practicae Alsaharavii*”.

Zahravi, si rezultat i këtyre studimeve, studiuesi i madh i mjekësisë hodhi themelet e kirurgjisë moderne. Zehravi, i cili kishte njohuritë, guximin, praktikitetin, diagnozën dhe vetëbesimin e duhur për të qenë një kirurg i mirë, e ka shkruar emrin e tij me shkronja të arta në histori, ashtu edhe dijetarët myslimanë të mjekësisë që erdhën pas tij kishin grumbulluar njohuri shkencore që ishin përtej kohës së tyre gjatë ditëve kur qytetërimi islam ishte në kulmin e tij.

1. Zehrâvî, et-Taşrîf li-men ‘aceze ‘ani’t-te’lif (nşr. Fuat Sezgin), Frankfurt 1406/1986, nëshredin girişi, I, 5-8.
2. a.mlf. [Albucasis], On Surgery and Instruments (nşr. ve trc. M. S. Spink – G. L. Lewis), Berkeley 1973.
3. İbn Hazm, Fezâ’ilü’l-Endelüs ve ehlihâ (nşr. Selâhaddin el-Müneccid), Beyrut 1387/1968, s. 18.
4. Humeydî, Cezvetü’l-muktebis (nşr. İbrâhim el-Ebyârî), Kahire 1410/1989, I, 325-326.
5. İbn Beşkuvâl, eş-Şıla (nşr. İbrâhim el-Ebyârî), Kahire 1410/1989, I, 102-103, 264.
6. Dabbî, Buğyetü’l-mültemis (Ebyârî), I, 357.
7. İbnü’l-Ebbâr, et-Tekmile (nşr. F. Codera), Madrid 1887, II, 551.
8. İbn Ebû Usaybia, ‘Uyûnü’l-enbâ’, s. 501.
9. Makkârî, Nefhu’l-‘îf, II, 691; III, 175, 185.
10. D. Campbell, Arabian Medicine and its Influence on the Middle Ages, London 1926, I, 85-90, 166-172.
11. Muhammed el-Arabî el-Hattâbî, et-‘Tîb ve’l-eṭṭebbâ’ fi’l-Endelüsü’l-İslâmiyye, Beyrut 1988, I, 111-274.
12. Âmir en-Neccâr, Fî Târîhi’t-ṭîb fi’d-devleti’l-İslâmiyye, Kahire 1994, s. 161-221.
13. Ali Hüseyin eş-Şatşât, Târîhu’l-cirâha fi’t-ṭibbi’l-‘Arabî, Bingazi 1999, I, 174-184.
14. A. M. Mansour, “Surgery of Abul-Qasim al-Zahravi”, Islamic Medicine, II, Kuwait 1982, s. 394-406.
15. Münâ Ebû Zeyd, “Ebû’l-Kâsım ez-Zehrâvî: Râ’idü’l-cirâhati’l-‘Arabiyye”, ed-Dirâsâtü’l-İslâmiyye, XXVI/1-2, İslâmâbâd 1991, s. 411-430.
16. G. Lewis, “The Surgery of Albucasis”, IC, LXXII/1 (1999), s. 21-36.

Masakra e Srebrenicës e vitit 1995 në Bosnje e Hercegovinë në dritën e shtypit shqiptar në Kosovë (1)

Nuridin Ahmeti

HYRJJE

Lufta e Bosnjës e viteve 1992-1995, krahasuar me luftërat e zhvilluara në ish-Jugosllavi, të shkaktuara nga regjimi i Millosheviçit, u vlerësua si me e tmerrshmja për nga dëmet e shkaktuara në aspektin njerëzor dhe infrastrukturor.

Brenda një lufte të zhvilluar, janë humbjet njerëzore që prekin në ndërgjegjen e çdokujt dhe, në rastin e luftës në Bosnje, dëmet njerëzore ishin më të dukshme. Kjo është edhe arsyeja, pse kjo luftë cilësohet si më e tmerrshmja në Evropë pas Luftës së Dytë Botërore. Por, ajo që e veçon këtë luftë krahasuar me të tjerat në ish-Jugosllavi, është masakra e Srebrenicës e korrikut të vitit 1995.

Kjo masakër është vlerësuar me epitete të ndryshme nga analistë, redaktorë gazetash, politikanë etj., si: “Masakra më e madhe pas Luftës së Dytë Botërore në Evropë”; “Turpi i Evropës dhe Botës”; “Holokausti i dytë në Evropë” etj.. Këto janë vetëm disa fraza që na ka rënë t’i lexojmë dhe dëgjojmë për masakrën e Srebrenicës, të kryer nga forcat ushtarake dhe policore serbe në Bosnje.

Sigurisht se ka edhe shumë fraza të tjera të përdoruar për këtë masakër, me cilësime më

Brenda një lufte të zhvilluar, janë humbjet njerëzore që prekin në ndërgjegjen e çdokujt dhe, në rastin e luftës në Bosnje, dëmet njerëzore ishin më të dukshme.

të ashpra, sepse kjo ngjarje ishte edhe një shprehje e mllefrit, e atyre që e kuptuan se kjo ngjarje kishte ndodhur në praninë e atyre që kishin marrë detyrë për t’i mbrojtur civilët boshnjakë myslimanë, pra forcave ndërkombëtare.

Mediat në disa vende të Evropës dhe botës, po jepnin lajme rreth kësaj ndodhie, të shkaktuara nga forcat serbe, në prani të forcave ndërkombëtare. Shtypi i disa vendeve të Evropës shkruante se çka ndodhi në Srebrenicë dhe humbjet e shkaktuara në anën myslimane. Kësaj ngjarje i bëri jehonë edhe shtypi shqiptar i Kosovës, me theks të veçantë gazeta e njohur “Bujku”,¹ e cila botohej në Prishtinë dhe ishte gazeta e vetme zyrtare e përditshme në gjuhën shqipe në Kosovë, pas ndalimit nga regjimit serbë të gazetës “Rilindja”. Kjo ngjarje, në shtypin shqiptar në Kosovë, u trajtua edhe pas vitit 2000, varësisht nga jehona që kishte në aspektin ndërkombëtar, andaj ne, këtë ngjarje e kemi hulumtuar në shtypin shqiptar në Kosovë deri në ditët e sotme. Pas vitit 2000 në Kosovë për këtë aspekt më së shumti ka shkruar e përditshmja “Koha Ditore”,² andaj edhe fokusi ynë ka qenë kryesisht në këtë gazetë.



BOMBA DHE NDIHMA HUMANITARE MBI SREBRENICË

Në muajin mars të vitit 1993, shtypi shkruante se aeroplanët serbë e bombarduan Bosnjën, në mesin e fshatrave të bombarduara janë edhe fshatrat e rrethinës së Srebrenicës, por forcat ndërkombëtare u kishin deklaruar mediave, se aeroplanët nuk janë identifikuar dhe “Kombet e Bashkuara vërtetuan sot lajmin se tre aeroplanë bombarduan të shtunën e kaluar fshatrat myslimane në Bosnjën Lindore, gjë që paraqet shkeljen e Rezolutës së Kombeve të Bashkuara për ndalim-fluturimin mbi territorin e Bosnjës. Në këtë lajm, që e transmetoi RFI, pohohet se tre aeroplanë hodhën bomba mbi fshatrat myslimane në rrethinën e Srebrenicës dhe pastaj u kthyen në drejtim të Serbisë. Përfaqësuesi zyrtar i Kombeve të Bashkuara tha se aeroplanët nuk janë identifikuar. Nga burimet e tjera merret vesh se ishte fjala për aeroplanë të lehtë, të ngjashëm me ata që përdoren për plehërimin e tokës dhe bombat u hodhën nga ata, faktikisht, me dorë. Këtë e pohoi në OKB edhe Lordi Dejvid Ouen.”³

Në faqen e parë të gazetës “Bujku”, citohet një deklaratë e komandantit të forcave të UN-PROFOR-it në Bosnjë-Hercegovinë, gjenerali Filip Morion në lidhje me operacionin e njohur humanitar “Parashuta” se në Srebrenicë janë dërguar ekspertë amerikanë që po i sinjalizojnë aeroplanët për të hedhur ndihma humanitare dhe sipas tij operacioni “është shumë preciz dhe efikas”⁴, dhe se gjatë këtij operacioni janë hedhur 36 tonelata ndihma,⁵ kryesisht ushqim dhe barna. Edhe në muajt në vijim të këtij vitit, theksohet ndihma humanitare nga ajri.⁶

Por, sa i përket ofrimit të ndihmesë për popullatën e Srebrenicës në aspektin tokësor, njoftohet se kolonat me

ndihma të dërguara nga Komisariatit i Lartë i OKB-së për Refugjatë, afro 150 kamionë janë bllokuar, deklaronte koloneli Bern Forn, përgjegjës për këtë kolonë, “tani plot gjashtë ditë mbi 150 kamionë, mes të cilëve gjenden edhe ata të forcave mbrojtëse të OKB-së, edhe më tej po presin lejen serbe në Zvornik që të kalojnë Drinën për në Srebrenicë. Forcat serbe për të satën herë premtojnë se kolona mund të niset për në Srebrenicë, mirëpo, pas pak kohe ata i ndërrojnë qëndrimet e tyre dhe nuk lejojnë shkuarjen e kësaj kolone kaq të pritur për të uriturit në Srebrenicë” - shkruante në mes të tjerash shtypi i Kosovës, i cili për këtë lajm i referohej agjencisë së njohur të lajmeve Frans Press.⁷ Krahas ndihmave humanitare të dërguara nga Komisariatit i Lartë i OKB-së për Refugjatë, zjarri i forcave serbo-malazeze po vazhdonte rreth Srebrenicës, andaj forcat e UN-PROFOR-it insistonin që të arrihet një marrëveshje për armëpushim me gjeneralin serb të Bosnjës Ratko Mladiq.⁸ Në vitin 1994, revista e njohur për trajtimin e çështjeve arsimore dhe pedagogjike që dilte në Prishtinë “Shkëndija”,⁹ botoi një vështrim të një Tv-reportazhi të i shfaqur në televizionin turk TGRT dhe përgatitur po nga ky televizion, që flet për Gorazhdën. Artikulli i botuar në këtë revistë mbante titullin “Vdekja e Gorazhdës-sonte/?!/” dhe ku në mes të tjerash shkruante “nuk e di a do të vdes sonte Gorazhda, apo do të mbijetojë dhunën serbe, por atë që e beri programi TGRT- i Turqisë, redaksia dhe reporterët e tij- të shtunën mbrëma, 9 prill 1994, më së paku mund të quhet solidaritet me tragjedinë e saj, por, gjithsesi mund të quhet mbrojtje e këtij qyteti boshnjak, e popullit boshnjak, dhe përpjekje që më punën e tyre të zgjojnë atë natë ndërgjegjen e terë njerëzimit”.¹⁰ Më transmetimin e këtij reportazhi në Turqi, thuhet se të nesërmen kishte gjithandej protesta në solidarizim të popullit mysliman boshnjak, por autorja edhe përmes këtij vështrimi nuk e fsheh qëllimin se ka dëshirë ta sensibilizojë edhe opinion shqiptarë për atë që po ndodhte në Bosnje.

FORCAT E KB U DËSHMUAN SE NUK JANË TË ZONJAT TA MBROJNË SREBRENICËN

Kështu, shkruante në mes të tjerash lideri i boshnjakëve Ali Izetbegović, në një letër dërguar kryetarit të ShBA-ve Bill Clinton dhe kancelarit të Gjermanisë Helmut Kol, në prag të pushtimit Srebrenicës nga forcat serbe.¹¹

Në fillimet e muajit korrik të vitit 1995, forcat serbe, kishte intensifikuar sulmet rreth Srebrenicës dhe dëshironin marrjen e saj, pavarësisht se Sreberinca nga Këshilli i Sigurimit ishte shpallur rajon sigurie. Serbët kishin kaluar zonën e sigurisë dhe kishin marrë pengë ushtarë holandezë.¹² OKB, shkruante shtypi, ua ka tërhequr vërejtjen serbëve se mund të përdorën forcat e NATO-s nëse ata vazhdojnë me kalimin e zonës së sigurisë. Por, në të njëjtën faqe shtypi shkruante se forcat serbe ishin para pushtimit të Srebrenicës

dhe se “serbët e Bosnjës kanë ndërmarr një ofensivë të gjerë ndaj zonës së sigurisë, Srebrenicës të shpallur nga KB, ku njësitë tankiste kanë arritur 1 km larg qendrës së qytetit. Një sulm i rrufeshëm serb, vazhdoi edhe sot herët në mëngjes, me ç ‘rast nga tanket e topat po bombardohet edhe qendra e qytetit. Deri më tani që nga e diela kur filloi kjo ofensivë serbe, thuhet se u vranë mbi 100 dhe u plagosën edhe shumë të tjerë. Forcat serbe po sulmojnë edhe në zonën tjetër të sigurisë Zhepë, Bihaq, Sarajevë e Orashje”.¹³ Duke e parë rrezikun që po i kanosej Srebrenicës dhe neglizhencën e KB që ta mbrojnë Srebrenicën, lideri boshnjak Ali Izetbegović i shkruante letër kryetarit të ShBA-ve Bill Clinton dhe kancelarit të Gjermanisë Helmut Koln që të ndërmarrin masa në mbrojtje të popullatës në Srebrenicë. “Forcat e KB-ve u dëshmuar se nuk janë të zonjat ta mbrojnë Srebrenicën”, shkruante në mes të tjerash në letrën e liderit boshnjak dërguar liderëve Clinton e Koln. Ali Izetbegović, i kishte kërkuar, përmes telefonit edhe nga presidentit të atëhershëm të Turqisë Sylejman Demirel, që të kërkojë nga liderët botëror që ta ndalojnë sulmin e forcave serbe në Srebrenicë dhe, në lidhje me këtë shtypi shkruante se Demirel, u kërkoi liderëve si Klintonit, Shirakut, Jelcinit, Mejxherit, Kolit, Mubarakut dhe mbretërve Hysein, Hasan, Fahdi “që të ndërmarrin çdo gjë që është e mundur për ta ndaluar agresionin serb mbi Srebrenicë”.¹⁴ Ndërsa, kryeministri boshnjak Haris Silajxhiq, në një deklaratë të tij e quante dështim të plotë misionin e Kombeve të Bashkuara për ta parandaluar gjenocidin në Bosnje. Silajxhiq, në deklaratën e tij, që i referohet shtypi në gjuhën shqipe, kërkonte armë dhe ushtarë nga qeveritë e botës për t’u mbrojtur dhe evidencim të zyrtarëve të KB në Bosnje, të cilët sipas Silajxhiqit janë përgjegjës për gjenocidin në Bosnje.¹⁵

Më 12 korrik, shtypi shkruante se forcat serbe vazhdojnë sulmet në Srebrenicë, për ultimatumin që forcat serbe u kanë dhënë forcave ndërkombëtare që ta lëshojnë Srebrenicën dhe se aeroplanët e NATO-s kanë bombarduar disa caqe serbe.¹⁶

Për pushtimin e Srebrenicës nga forcat serbe, Silajxhiq fajëson Kombet e Bashkuara,¹⁷ ndërsa Këshilli i Sigurimit po debatonte për votimin e një rezolute që “të kërkojë nga Sekretari i Përgjithshëm Butros Gali që të përdorë të gjitha mjetet që posedon në mënyrë që t’i rikthehet statusi i Srebrenicës, ashtu siç është definuar në prill 1993, me një marrëveshje për demilitarizim midis serbëve dhe

Më 12 korrik, shtypi shkruante se forcat serbe vazhdojnë sulmet në Srebrenicë, për ultimatumin që forcat serbe u kanë dhënë forcave ndërkombëtare që ta lëshojnë Srebrenicën dhe se aeroplanët e NATO-s kanë bombarduar disa caqe serbe.

myslimanëve, e cila nuk u respektua plotësisht nga asnjëra palë”.¹⁸

Nga data 13 korrik, lajmet e botuara njoftonin se serbët e kanë pushtuar Srebrenicën dhe tani po kanoset një katastrofë humanitare mbi popullatën e këtij vendi. Për ta qetësuar gjendjen forcat ndërkombëtare kishin kërkuar nga lideri i serbëve të Bosnjës Radovan Karaxhiq tërheqjen e forcave serbe nga Srebrenica, por një deklaratë e tillë ishte refuzuar nga ky i fundit. Në të gjitha ato që po ndodhnin në Srebrenicë, Këshilli i Sigurimit i OKB-së po i dënonte në formë deklarative apo edhe duke nxjerrë ndonjë rezolutë.¹⁹

Historiani, shkrimtari dhe publicisti Jusuf Buxhovi, korrespondent nga Boni, shkruante se në Bosnje fitoi lufta, reagimet e fuqive vendimmarrëse ishin cinike dhe e gjithë kjo është pjesë e një skenari të njëanshëm. Sipas Buxhovit “rënia e Srebrenicës dhe reagimet tepër cinike të faktorit ndërkombëtar, veçmas atij të vendosjes, i cili e ka marrë përsipër mandatin e zgjidhjes së krizës në ish-Jugosllavi sikur vërtetuan dyshimet e një pjese të mirë të opinionit gjerman se ajo që po ngjan kohëve të fundit në Bosnjë-Hercegovinë nuk është tjetër pos pjesë e një skenari të njëanshëm, i cili duhet të akseptojë ndarjen e dhunshme të këtij vendi në tri pjesë etnike, “si një zgjidhje e vetme e mundshme”, së cilës e ashtuquajtura konfederatë e dyfishtë, që e propozoi Grupi i

Kontaktit, duhet t’i shërbejë si instrument i përkohshëm që Bosnja, më në fund, të shpërbëhet plotësisht sipas projektit tashmë të njohur serbokroat”.²⁰

Kur është fjala të Srebrenica, Buxhovi i përshkruante si skena të llahtarshme “të shoqëruara me zemërgjerësinë e gjeneralit Mladiq”, i cili, bashkë me ushtarët e vet u falte çokollata fëmijëve të lemëritur nga tmerri, para se ata t’i ndante nga prindërit, si dhe “manovrat solemne” të trupave franceze për “veprim të shpejtë” diku në Bosnjën Qendrore, te gjermanët përfundimisht hoqën dilemën rreth misionit të OKB-së në Bosnjë si “të domosdoshëm” dhe po ashtu sforcean bindjen se Evropa nuk është në gjendje të merret me problemet serioze”.²¹ shkruante në mes të tjerash Buxhovi.

Shtypi i 15 korrikut citonte edhe deklaratën e Uiliem Sefejzit, komentuesit të njohur amerikan të “Tajms”-it, i cili e kritikonte politikën toleruese të Presidentit Clinton ndaj serbëve. Sipas tij “për shkak të politikës ndaj Bosnjë-Hercegovinës, Klintoni e shndërroi Amerikën prej superfuqisë në nënfuqi - duke ndjekur politikën kapitulluese

KËSHILLI I SIGURIMIT DEBATON RRETH TËRHEQJES SË MENJËHERSHME NGA SREBRENICA

Ankth e shpresë në taborin boshnjak

Me rezolutën që pritet të miratohet KS i OKB-së do të kërkojë nga Gali që të përdorë të gjitha mjetet që të rikthehet Statusi i Srebrenicës

Nju-Jork, Kombet e Bashkuara, 12 korrik
Pas rënies së Srebrenicës në duart e serbëve, Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara pritet të miratojë një rezolutë me të cilën do të kërkojë tërheqjen e menjëhershme, ndërkaq zyrtarë të Administratës amerikane dhanë deklaratë jo shumë të qarta se si mund të reagojnë SHBA-të.

Rezoluta e Këshillit të Sigurimit do të kërkojë nga Sekretari i Përgjithshëm Butros Gali që «të përdorë të gjitha mjetet që pose-

don» në mënyrë që t'i rikthehet statusi i Srebrenicës, ashtu siç është definuar në prill 1993, me një marrëveshje për demilitarizim midis serbëve dhe myslimanëve, e cila nuk u respektua plotësisht nga asnjëra palë.

Sipas parashikimeve të zyrtarëve në OKB, ata presin që serbët të tërhiqen, popullata që ka ikur të kthehet vullnetarisht, ndërkaq detyrë e qeverisë boshnjake do të jetë që të demilitarizojë Srebrenicën.

Përfaqësuesi në Këshillin e Sigurimit, ambasadori i Francës,

Zhan Bernar Merime, ishte më i ashpër në gjykimin e serbëve dhe para gazetarëve aludoi në reagimin e mundshëm të forcës rapide të përbërë nga trupa franceze, britanike dhe holandeze.

«Qeveria franceze është e gatshme të reagojë ashtu si do të kërkojë situata. Jemi të gatshëm që të ofrojmë ushtarët francezë si pjesë e forcës rapide, të cilët tashmë janë në rajon. Ajo do të jetë në dispozicion dhe do të varet nga urdhrat e Sekretarit të Përgjithshëm», tha Merime.

I pyetur nëse kjo do të thoshte përdorim i forcës, Merime u përgjigj: «Nëse është nevoja, po». Mirëpo, sipas burimeve në OKB ende nuk kanë mbërritur të gjithë ushtarët e njësisë të forcës rapide në rajonet e destinuar.

Rezoluta për të cilën pritet të votohet sot është sponsoruar prej katër nga pesë vendet anëtare të përhershme të Këshillit të Sigurimit: Franca, Britania e Madhe, Gjermania dhe SHBA-të. Anëtarë i pestë, Rusia, aleatë e serbëve, (vijon në faqe 4)

të KB. Në vend të dënojë serbët pas rrëzimit të pilotit amerikan, kryetari ua ofroi faqen tjetër dhe kështu mori një shpullë në Srebrenicë....»²² Në këtë kohë mjaftë tronditëse për Bosnjën, Presidenti i Turqisë Sylejman Demirel e kishte përfunduar më 14 korrik një vizitë në Shqipëri e Maqedoni. Shtypi turk, të cilit i referohet edhe shtypi në Kosovë tërhiqte vëmendjen se pas Bosnjës radhën e ka Kosova, duke e ndërlidhur vizitën e Demirelit në Maqedoni e Shqipëri edhe miratimin e një amendamentin të projektligjit nga «Dhoma Përfaqësuese e Kongresit Amerikan...», të cilin e propozoi republikani Eliot Engël. Me të kërkohej krijimi i protektoratit ndërkombëtar për Kosovën, që është nën dominimin dhe represionin serb.²³ Frikën e përshkallëzimit të luftimeve në serbe në Kosovë e shfaqti edhe ish-Presidenti i Kosovës në një konferencë për shtyp kur deklaroi se «shkallëzimi i luftimeve në Bosnjë, natyrisht, rrezikon edhe sigurinë në pjesët e tjera të rajonit, prandaj kërkojmë që sa më shpejt të gjendet zgjidhje politike për Bosnjën dhe për të gjitha viset e tjera në ish-Jugosllavi. Të bëhet një presion më i madh i bashkësisë ndërkombëtare, përkatësisht i Perëndimit, për zgjidhjen e të gjitha problemeve në ish-Jugosllavi, duke përfshirë edhe Kosovën».²⁴

1 Gazetë e përditshme, në gjuhën shqipe që botohej në Kosovë. Numri i parë doli më 18 janar 1991. Kryeredaktorë ishin: Behlul Jashari, Avni Saphiu, Binak Kelmendi etj.. Ishte shtyllë e informimit në Kosovë. Gazeta vazhdoi me informimin në gjuhën shqipe deri në muajin shkurt të vitit 2002 kur edhe pushoi se botuari.

2 Gazetë e përditshme e pavarur në gjuhën shqipe në Kosovë. U themelua nga publicistit Veton Surroi. Numri i parë doli më 31 mars 1997 dhe vazhdon së botuari edhe sot e kësaj dite. Nga vitit 2019 vazhdon të dal vetëm në formë elektronike. *Fjalori Enciklopedik i Kosovës I*, AShAK, 2018, f. 492.

3 *Bujku*, 18 mars, Prishtinë, 1993, f. 1.

4 «Edhe preciz, edhe efikas», *Bujku*, 18 mars, Prishtinë, 1993, f. 1.

5 «Mbi Srebrenicë u hodhën 36 tonelata ndihma», *Bujku*, 18 mars, Prishtinë, 1993, f. 1.

6 *Bujku*, 12 maj, Prishtinë, 1993, f. 1.

7 *Bujku*, 18 mars, Prishtinë, 1993, f. 1.

8 *Bujku*, 11 prill, Prishtinë, 1993, f. 1.

9 «Revistë arsimore pedagogjike dhe shoqërore. Filloi të botohet në vitin 1971. Që nga numri i parë njoftonte se qëllimi kryesor i saj do të jetë analiza dhe zgjidhja «e çështjeve aktuale shkollërore dhe shoqërore-pedagogjike». Kjo revistë, me rubrikat e saj, u shndërrua në një tribunë të mendimit pedagogjik, të analizës dhe vlerësimit të gjendjes së arsimit në Kosovë dhe të shkëmbimit të pikëpamjeve të ndryshme për të gjitha çështjet profesionale dhe problemet e shkollës dhe të arsimit. Revista «*Shkëndija*» u shndërrua në doracak profesional për mësimdhënësit dhe drejtuesit e arsimit në Kosovë, sidomos për ata të arsimit fillor. Nisi si revistë dyjavore, por doli në intervale të ndryshme kohore. Pushoi së botuari në vitin 2010». *Fjalori Enciklopedik i Kosovës II*, AShAK, Prishtinë, 2018, f. 1412.

10 Nafije Latifi, «Vdekja e Gorazhdës-sonte?!», *Shkëndija*, nr. 3, prill, Prishtinë, 1994, f. 4.

11 «Izetbegoviçi u dërgoi apel Klintonit e Kolit», *Bujku*, 11 korrik, Prishtinë, 1995, f. 1.

12 «Kërcënime të serishme të OKB-së», *Bujku*, 11 korrik, Prishtinë, 1995, f. 1.

13 «Forcat serbe para pushtimit të Srebrenicës», *Bujku*, 11 korrik, Prishtinë, 1995, f. 1.

14 «Demireli u dërgoi mesazhe shumë burrave të shteteve», *Bujku*, 11 korrik, Prishtinë, 1995, f. 3.

15 *Bujku*, 11 korrik, Prishtinë, 1995, f. 3.

16 *Bujku*, 12 korrik, Prishtinë, 1995, f. 1.

17 *Bujku*, 13 korrik, Prishtinë, 1995, f. 1.

18 «Ankth e shpresë në taborin boshnjak», *Bujku*, 13 korrik, Prishtinë, 1995, f. 1.

19 *Bujku*, 13 korrik, Prishtinë, 1995, f. 4.

20 Jusuf Buxhovi, «Në Bosnjë fitoi lufta!...», *Bujku*, 15 korrik, Prishtinë, 1995, f. 1.

21 *Bujku*, 15 korrik, Prishtinë, 1995, f. 1.

22 *Bujku*, 15 korrik, Prishtinë, 1995, f. 3.

23 *Bujku*, 15 korrik, Prishtinë, 1995, f. 3.

24 *Bujku*, 15 korrik, Prishtinë, 1995, f. 2.

Muhaxhirët – bartës të historisë dhe kulturës

Refik Gërbeshi

MUHAXHERIA – PËRJETIM I POPUJVE TË ZGJEDHUR NGA ZOTI

Zoti i Gjithëfuqishëm është Krijuesi i njeriut, të cilin e nderoi si banori më i dalluar, dhe i cili është krijuar që ta njohë dhe besojë Atë. Përmes besimit, njeriu duhet të bëjë jo vetëm jetë, por edhe kulturë dhe qytetërim, traditë dhe identitet. Andaj nëse hasë në pengesa të ruajtjes së besimit, identitetit e traditës së tij, është i urdhëruar të migrojë, të largohet nga ai vendbanim i tij për të mos humbur besimin dhe qytetërimin e tij.

Njeriu, duke i qëndruar besnik misionit të tij të besimit, edhe mund të dëbohet me dhunë nga vendlindja, por kudo që të shkojë toka është e Zotit dhe ajo është e gjerë, andaj migrimi nuk do të thotë asimilim e devijim nga vetvetja, por qëndrim në misionin e tij të besimit dhe të adhurimit të Zotit Krijues. Zoti i Gjithëdhijshëm në këtë kontekst ka thënë: *“O robërit e Mi që besuat, toka Ime është e gjerë, pra vetëm Mua më adhuroni.”* (El Ankebut, 56)

Robi i Zotit i cili beson në Të është i vetëdhijshëm së toka është e gjerë dhe ajo është e Zotit, kudo që të jetojë apo të dëbohet e migrojë duhet që vetëm Atë ta adhurojë, ta zhvillojë jetën e tij sipas porosive të Tij dhe ta ruajë identitetin e vet.

Njeriu, duke i qëndruar besnik misionit të tij të besimit, edhe mund të dëbohet me dhunë nga vendlindja, por kudo që të shkojë toka është e Zotit dhe ajo është e gjerë, andaj migrimi nuk do të thotë asimilim e devijim nga vetvetja, por qëndrim në misionin e tij të besimit dhe të adhurimit të Zotit Krijues.

Muhaxheria është përjetim i popujve të shpalljes, gjegjësisht pasuesve të të zgjedhurve të Zotit, të cilët përjetuan dëbimin nga vatrata e tyre, por i qëndruan besnikë traditës dhe kulturës së tyre. Ky fenomen e ka përfshirë masovikisht edhe popullin shqiptar, por kanë kaluar gjenerata dhe ende nuk shuhet ky identitet.

Popujt besimtarë të cilët përjetuan hixhretin janë përmendur në Kuranin famëlartë, duke filluar nga njeriu i parë Ademi a.s., i cili u shpërngul prej Xhenetit në Tokë, pastaj shpërngulja e Nuhut a.s., dhe hixhreti i Ibrahimit a.s., i cili përsëritej nga Babilonia në Palestinë nga Palestina në Mekë.

Këto migrame ishin thjesht për t’iu ikur besimeve të kota, talljeve dhe persekutimeve të jobesimtarëve, si edhe për të përhapur besimin e pastër në Një Zot. I zgjedhuri nga Zoti, Musai a.s., bëri hixhretin me largimin nga Egjipti, duke ikur nga Faraoni, ai shkoi në Medjen, pastaj pas afër tetë viteve kthehet, pastaj detyrohet të bëjë hixhretin e radhës, për t’iu shmangur torturave të Faraonit, me ç’rast migroi nga Egjipti drejt Detit të Kuq, duke pasur për destinacion tokat e Shamit. Edhe Isai a.s. ishte i detyruar të shpërngulej nga një vend në një vend tjetër.

Kurse i zgjedhuri i fundit nga Zoti xh.sh., Muhamedi a.s. dhe shokët e tij gjithashtu përjetuan disa hixhrete-shpërngulje. Me zbri-tjen e shpalljes të Muhamedi a.s., së bashku



me të ka zbritur edhe urdhri për hixhretin (është përcaktuar të zbresë ky urdhër), me argument se, kur Muhamedit a.s., i erdhi shpallja në shpellën Hira dhe më pastaj, së bashku me bashkëshorten e tij Hatixhen r.a., kishin shkuar te Vereka bin Neufeli për t'i rrëfyer për ngjarjen që i kishte ndodhur, ai i kishte thënë: *“Ah sikur të isha gjallë, kur populli yt do të të largojë (do të të ndjekë jashtë vendlindjes)...”*. Kjo d.t.th. se hixhreti dihej qartë që do të ndodhte.

Fillimisht disa nga besimtarët u shpërngulën për në Abisini. Pasi që torturat dhe dhuna shtoheshin u dashtë të migronin për në Abisini për trajtimin e duhur dhe të barabartë.¹ Pastaj kur qëndrimi i myslimanëve në atdheun e tyre në Mekë u bë i pamundshëm për shkak të dhunës, ndodhi hixhreti për në Medinë. Edhe myslimanët e brezave në vijim përjetonin migrimin si trysni në vendin e tyre, këtë e përjetuan edhe populli shqiptar.

Zoti në Kuran thotë: *“O ju që besuat, nëse keni dalë (prej vendlindjes) për hir të luftës për rrugën Time, duke kërkuar kënaqësinë Time ndaj jush, mos e zini mik armikun Tim dhe armikun tuaj, duke shprehur ndaj tyre dashuri, kur dihet se ata mohuan të vërtetën që u erdhi*

“Migrimi i shqiptarëve është një dukuri e shpeshtë dhe e përsëritur për çdo shekull e gjeneratë andaj jemi “një popull mërgimtarë i shpërndarë në të katër anët e botës.”

juve. Ata e dëbojnë të Dërguarin dhe ju, sepse i besoni Allahut, Zotit tuaj, e ju fshehurazi u ofroni miqësi, po Unë më së miri e di atë që e keni fshehur dhe atë që e keni publikuar. Ai që punon ashtu nga pala juaj, ai e ka humbur rrugën e drejtë.” (El Mumtehine, 1).

HIXHRETET - MIGRIMET E SHQIPTARËVE

Pozicioni i shtrirjes gjeografike i atakon shqiptarët me kultura dhe besime të ndryshme, por edhe interesa të shumta, jo vetëm rajonale e fqinjësore, por edhe botërore. Ky atakim sillte edhe jo stabilitet. Gjendjet e luftërave që krijoheshin në këto troje nëpër kohë manifestonin vështirësi ekonomike kulturore e politike, gjë që i detyronte vendasit të largoheshin nga vatrat e tyre. *“Migrimi i shqiptarëve është një dukuri e shpeshtë dhe e përsëritur për çdo shekull e gjeneratë andaj jemi “një popull mërgimtarë i shpërndarë në të katër anët e botës.”*²

Trojet shqiptare ndër shekuj filluan të tkurren e zvogëlohen, të okupohen e popullohen me kolonë nga kombe të ndryshme, kryesisht serbë e grekë, andaj shqiptarët si autokton detyroheshin të migronin, të largoheshin nga

trojet e tyre. Interesat në këto troje ishin të shumta e të llojllojshme. “Në këto troje kishte depërtuar kapitali evropian, andaj Fuqitë e Mëdha ishin të interesuara për këto treva si treg për eksportimin e prodhimeve të veta industriale si edhe për shfrytëzimin e pasurive të këtyre vendeve.”³ Ardhjet dhe depërtimet e “të interesuarve” apo pretendimet për t’i okupuar tokat tona ishin ndër detyrimet e migrimit. Arsytet e shpërnguljes së shqiptarëve nga trojet e autoktonisë së tyre janë: trysnitë politike nga pushtuesit dhe fqinjët për detyrimin e shpërnguljeve e cila po vazhdohej në praktikë ku ndër shqiptarët ushtrohej dhunë e represion në mënyrë që ata të largohen nga trojet e tyre.⁴

Shkaqet apo motivet e mërgimit të shqiptarëve kanë qenë të lidhura në radhë të parë në faktorët e jashtëm, kryesisht fqinjë që i detyronin dhunshëm të shpërnguleshin. “Këto mërgime, mendoj duhej quajtur mërgime parësore përmasash masive që u shkaktuan nga përligjja e pabarazisë dhe e shtypjes kombëtare të shqiptarëve.”⁵

Termi i papërshtatshëm ‘diaspora’ shqiptare është term që përfshin të gjithë shqiptarët, të cilët jetuan dhe vepruan jashtë trojeve autoktone, të cilët nëpër të gjitha periudhat e zhvillimeve kishte pjesë masive të dëbuar, por hulumtimet për këtë fenomen shqiptar janë më të pakta në krahasim me fenomenet të tjera historiografike.

Duke qenë i vendosur në udhëkryqin e rrugëve që lidhin qytetërimin e Perëndimit me atë të Lindjes, populli shqiptar gjatë tërë historisë së vet të bujshme u gjend përball armiqve që ia rrezikuan identitetin dhe ia ngushtuan kufirin etnik, një pjesë e popullit tonë u dynd nga mëmëdheu dhe u ngulit në dhe të huaj.⁷ Asnjë njëri nuk largohet nga shtëpia e tij pa pas ndonjë trysni, qoftë kulturore ekonomike e politike familjare etj.. Trysnitë e llojeve të shumta ishin prezentë te shqiptarët. Për dallim nga popujt e tjerë, që u shpërngulën për të mbetur gjallë, shqiptarët i detyron fati historik, politik.⁸

Shqiptarët kudo që shkuan i integruan dhe i kontribuan vendit ku u vendosën, si në Perandorinë Osmane, Egjiptit, Amerikë dhe Evropë, duke mos harruar identitetin dhe kulturën, atdheun dhe familjen e tyre.

“Këto mërgime, mendoj duhej quajtur mërgime parësore përmasash masive që u shkaktuan nga përligjja e pabarazisë dhe e shtypjes kombëtare të shqiptarëve.”

Migrimet e popullit shqiptar janë të llojllojshme në dimensionin kohë e hapësirë, por populli gjithnjë mbante lidhjet me atdheun apo kulturën dhe traditën e tyre. Ata nuk janë diçka e hedhur, e gjuajtur dhe e harruar, prandaj nuk preferohet të përdoret kjo shprehje për mërgimtarët tanë, ngase ata nuk janë diçka e hedhur e gjuajtur, por pjesë e pandashme e kombit të cilët edhe i kontribuan në etapat e ndryshme historike. Mërgimtarët janë pjesë e pandashme e popullit dhe trojeve tona, ata luajtën rol të rëndësishëm në zhvillimet drejt lirisë e pavarësisë së Shqipërisë dhe të Kosovë.

Çështja e mërgatës shqiptare me rrënjë të lëshuara që nga koha e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit u krijua më shumë si pasojë e marrëveshjeve politike ndërmjet shteteve të mëdha dhe fqinjëve dhe më pak si pasojë e zhvillimeve të raporteve politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe fetare përbrenda etnisë dhe kombit shqiptarë.⁹

Hixhretet e shqiptarëve drejt tokave të tyre, apo më larg drejt tokave të huaja, qoftë në Lindje qoftë në Perëndim, pavarësisht periudhës kur u detyruan ta bëjnë, nuk ishte fetare por thjesht mbijetesë dhe ikje nga dhuna, persekutimi e gjenocidi. Por, përmes migrimit, shqiptarët e kishin ruajtur edhe elementin fetar të tyre.

1 Thomas Arnold, *Historia e përhapjes së Islamit*, (Prishtinë, Dituria Islame, 2004), 30.

2 Pajtim Ribaj, *Strategjia kombëtare dhe diaspora, roli i mërgatës në shtetformim* M.D.K. SH.N. (Prishtinë, 2012), 231.

3 Shukri Rrahimi, *Gjurmime historike të Rilindjes Kombëtare*, I.A.P. (Prishtinë, 1986), 164.

4 Zamir Shtylla, *Shpërnguljet e shqiptarëve gjatë shekujve*, Libri I, (Prishtinë, 1992), 206.

*Strategjitë dhe projektet e tyre “akademike” ishin; Strategjia Megali Idhea greke dhe Naçertania sllave.

5 Pajazit Nushi, *Letërsia Shqipe dhe Mërgimi*, (Prishtinë, 1997), 12.

6 Fjala diasporë është e lashtë dhe fillimisht përdorej për etni religjioze si p.sh. Jevrejtë. (nga greq. διασπορά=shpërndarje). Kjo fjalë te shqiptarët përdoret që nga shekulli i XIX për popuj apo grupe etnike që lëshuan vendlindjen e tyre tradicionale dhe u shpërndanë nëpër botë. Ky term nuk është adekuat për mërgimtarët tanë.

7 Jahja Drançolli, *Disa njoftime për letrat tona humaniste në mërgim*, Në: I.A.P. “Letërsia Shqipe dhe Mërgimi”, (Prishtinë, 1997), 93.

8 Rexhep Qosja, *Letërsia dhe mërgimi*, f. 8.

9 Pajazit Nushi, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit 129-vjet, Përmbledhje e kumtesash nga tryeza shkencore*, 12 qershor 2007, (Prishtinë, 2010), 20.

Reportazh nga Haxhi 2025

Haxhi - përjetime dhe emocione të paharrueshme të besimtarëve nga Kosova

Bashkësia Islame e Kosovës, ashtu sikurse edhe viteve të kaluara, edhe këtë vit me sukses ka arritur që ta organizoi haxhin. Përgatitjet për këtë ibadet kishin filluar qysh herët, me përkushtimin më të madh dhe me synimin e qartë, që t'u ofrohet haxhilerëve tanë një përvojë dinjitoze dhe e paharrueshme në vendet e shenjta të Islamit. Më 6 maj 2025, udhëheqësit e Drejtorisë së Haxhit, organizuan një takim me udhëheqësit e haxhilerëve nga Këshillat e BI-së. Në këtë takim, i pranishëm qe edhe kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i cili porositi udhëheqësit që të rrisin edhe më tej përkushtimin e tyre në shërbim të haxhilerëve dhe të jenë të gatshëm që t'u përgjigjen me përgjegjësi të gjitha kërkesave dhe nevojave që ata mund të kenë gjatë këtij rrugëtimi të rëndësishëm shpirtëror.

Pas kësaj mbledhje, në të gjithë Këshillat e BI-së anekënd Kosovës, u organizua duaja e haxhit, në të cilën u shfrytëzua rasti që të mbaheshin edhe ligjërata të shkurtra rreth vlerës dhe përgatitjeve të duhura para nisjes drejt vendeve të shenjta.

Grupi i parë i besimtarëve u nis më 24 maj, për të vazhduar edhe me tri grupet e tjera, më 25, 26 dhe 27 maj.

Sapo arrinin në Xhide, udhëheqësit e Drejtorisë së Haxhit, i orientonin drejt Mekës, për t'i akomoduar pastaj në hotele, ku për ta ishte organizuar pritje madhështore me ilahi dhe kaside. Pas kësaj, në grupe-grupe, të udhëhequr nga udhëheqësit e haxhilerëve të Këshillave, niseshin drejt Qabesë për t'i kryer ritualet e urmes dhe për t'u liruar nga ihrami.

Ndjenja të pa përshkruara, emocione që kurrë më parë nuk i kishin përjetuar, shikimi i Qabesë i magjepshte, e lutjet dhe kërkim falja nga Allahu shoqëronin çdo haxhi. Ndjesitë e para me pamjen e Qabesë u shkruan thellë në zemrat e tyre, aty ku përzihej loti me lutjen, heshtja me mallin dhe mirënjohja me falënderimin ndaj Allahut.

Pas përfundimit të tavafit, haxhilerët falnin dy rekate pas Mekami Ibrahimit, e më pas fillonin ecjen ndërmjet kodrave Safa dhe Merva, duke kujtuar plot mallëngjim Haxheren, e pas përfundimit të ecjes së shtatë, çlodheshin me ujë Zemzemi, e më pas qethnin flokët dhe liroheshin nga ihrami.



Gjatë qëndrimit të haxhilerëve tanë në hotel, Drejtoria e Haxhit ishte kujdesur që të organizonte ligjërata nga hoxhallarët tanë, ashtu që të shpjegoheshin dhe të mësonin edhe diç më tepër rreth vlerës, obligimit dhe ritualeve të haxhit. Përveç këtyre, edhe mualimet e Departamentin të Gruas, kujdeseshin që të mbanin ligjërata për gratë.

Përveç këtyre, haxhilerët tanë, gjatë qëndrimit në Meke, vizituan edhe vendet historike të Mekës, përfshirë këtu edhe



shpellën Hira, aty ku Pejgamberit, paqja dhe mëshira e Zotit qofshin mbi të, i zbritën ajetet e para nga Kurani fisnik. E pranë kësaj shpelle, caktimi i Zotit që i tillë që të ndërronte jetë një prej haxhilerëve tanë. Haxhi Avdi Jusufi nga Vushtrria ia dorëzoi shpirtin Krijuesit të Tij në vendin më të shenjtë. Ai vdiq më 1 qershor, teksa namazi i xhenazes iu falë me prezencën e miliona besimtarëve në namazin e drekës në Qabënë e bekuar. Ai u varros në varrezat e Mekës, nën përcjelljen edhe të udhëheqësve të haxhit nga Bashkësia Islame e Kosovës.

Për të shkuar gjithçka sipas planifikimit, udhëheqësit e Haxhit, mbajtën takime të kohëpaskohshme me udhëheqësit e haxhilerëve, e një të tillë e mbajtën edhe më 3 qershor, pak ditë para ditës së Arafatit. Gjatë këtij takimi udhëheqësit u njohën me përgatitjet e deritanishme për qëndrimin e haxhilerëve tanë në Arafat, si dhe për mënyrat dhe të vepruarit me haxhilerët e sëmurë. Ata po ashtu u njohën edhe me organizimin e programit fetar në Arafat.

Në mbrëmjen e datës 4 qershor, haxhilerët tanë, të veshur me ihrame, me telbije dhe tekbire, u nisën drejt Arafatit, aty ku do të qëndronin gjatë gjithë ditës së enjte, pra datës 5 qershor, për të përmbushur kështu njërin nga farzet kryesore të haxhit. Përgatitjet rreth qëndrimit në Arafat ishin kryer qysh kohë më parë. Namazi i drekës dhe ai i ikindisë u falën të shkurtuar dhe të bashkuar, ashtu siç jemi porositur nga mësimet e Pejgamberit, *paqja dhe mëshira e Zotit qofshin mbi të*. Këtyre namazeve iu priu kryeimami i Bashkësisë Islame të Kosovës, Vedat ef. Sahiti, teksa më pas, sekretari i Përgjithshëm i Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, Ahmet ef. Sadriu, mbajti ligjëratën me tematikë haxhi. Pas kësaj u bë edhe dua e haxhit nga imami Ekrem ef. Ahmeti.

Pas kësaj, haxhilerët tanë vazhduan ditën me lutje, këndim Kurani dhe ibadete të tjera, derisa perëndoi dielli i asaj dite, për të vazhduar më pas drejt Muzdelifes, aty do të qëndronin për një kohë dhe ku do të falnin namazin e akshamit dhe të jacisë të bashkuar. Pas namazeve, ata filluan që t'i mblidhnin guralecët, me të cilët në mënyrë simbolike do ta gjuanin shejtanin e mallkuar, fillimisht me 7 në ditën e Bajramit te

Xhemreja e Madhe, e më pas edhe me nga 21 të tjerë në dy ditët e ardhshme të Bajramit, në 3 xhemeratet.

Pas një kohe të qëndrimit në Muzdelife, haxhilerët tanë u nisën drejt Minas, ku edhe kryen ritualin e hedhjes së gurëve, e më pas vazhduan rrugëtimin për në hotel. Dita e Kurban Bajramit i gjeti haxhilerët të bashkuar në hotel, duke uruar njëri-tjetrin për këtë festë dhe për pranim të haxhit. Në mbrëmje, ata, të udhëhequr nga hoxhallarë e tyre, u nisën drejt Qabesë për ta kryer tavafin e haxhit, e pas kësaj, të

nesërmen dhe të pasnesërmen, pra ditën e dytë dhe të tretë të Bajramit, kryen edhe ritualet e hedhjes së guralecëve në xhemerate, e më pas, një ditë para nisjes drejt Medinës, kryen edhe tavafin e lamtumirës, për t'u përshëndetur kështu me Qabënë e bekuar.

Më 10 qershor 2025, haxhilerët tanë lanë Mekën dhe u nisën drejt Medinës së ndritshme të Pejgamberit, paqja dhe mëshira e Zotit qofshin mbi të. Posa u akomoduan në hotele, ata të bashkuar nga grupe-grupe, u nisën drejt vendit ku pushon trupi i të Dërguarit, *paqja dhe mëshira e Zotit qofshin mbi të*. Të përhumur mes emocioneve për takimin me të dhe me dy shokët e tij besnikë, sikur po i thoshin se ja ku jemi o i Dërguar, për të ta dhënë edhe një herë besatimin se do t'i qëndrojmë besnikë rrugës tënde deri në ditën kur do të takohemi para Krijuesit tonë.

“O Allah, më bëj mua pasues të denjë të shembullit të njeriut më të përkryer të njerëzimit dhe shokëve të tij të nderuar. O Allah, ma bëj të mundur shefatin e Tij në ditën e gjykimit e më ringjall si ymet i Tij!”

Pas kësaj, ata falën dy rekate në Reuda, në bahçen e Xhenetit, e cila gjendet në mes shtëpisë dhe minberit të të Dërguarit.

Organizimi i vizitave në vendet historike të Medinës vazhdoi me kodrën e Uhudit, Xhaminë Kuba dhe Xhaminë e Dy Kibleve, në të cilat vende, haxhilerët tanë u njohën me historikun, rëndësinë dhe ngjarjet që janë zhvilluar në këto vende.

Më 16 dhe 17 qershor 2025, haxhilerët tanë lanë Medinën dhe u nisën drejt Kosovës, me lutjet për pranim të duave dhe ibadeteve që kanë kryer gjatë kohës së kanë qëndruar në vendet e shenjta, në Meke dhe Medine. Ata me vete sollën dritën e Qabesë, ndjesinë e Arafatit, paqen e Medinës dhe dashurinë për Islamin e pastër.

Lusim Zotin e Madhëruar që haxhilerëve t'ua ketë pranuar haxhin dhe të gjitha ibadetet që i kanë kryer!

Bajram Zeqiri

MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM SHEFEN E UNMIK-UT, ZNJ. CAROLINE ZIADEH

Më 12 qershor, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur në takim shefen e Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), znj. Caroline Ziadeh.

Gjatë këtij takimi miqësor dhe konstruktiv, znj. Ziadeh i ka përcjellë Myftiut Tërnavë urimet e përzemërta me rastin e festës së Kurban Bajramit, duke theksuar njëkohësisht vlerësimin e lartë për rolin e Bashkësisë Islame në promovimin e paqes, mirëkuptimit, tolerancës dhe harmonisë ndërfetare në vend.



Nga ana e tij, Myftiu Tërnavë e ka falënderuar znj. Ziadeh për urimet e singerta dhe për bashkëpunimin e

vazhdueshëm dhe korrekt të UNMIK-ut me institucionet fetare në Kosovë, e që do të vazhdojë edhe në të ardhmen.

MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM AKADEMIKUN FETI MEHDIU

Më 19 qershor 2025, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Naim ef. Tërnavë, ka pritur në takim akademikun Feti Mehdiu.

Me këtë rast akademikun i dhuroi Myftiut Tërnavë një kopje të përkthimit të Kuranit, të përkthyer nga vetë ai, si dhe kompletin e përkthyer të “Sahihut të Buhariut”.

Myftiu Tërnavë e përgëzoi akademikun për botimin e këtyre veprave, duke i uruar jetë të begatshme dhe punë të frytshme në shkrimin dhe përkthimin e veprave me rëndësi për besimtarët myslimanë.



MYFTIU TËRNAVA VIZITOI PËR NGUSHËLLIME FAMILJEN E HAXHI AVDI JUSUFIT



Më 3 qershor 2025, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i shoqëruar nga

bashkëpunëtorët e tij, vizitoi për ngushëllime familjen e haxhi Avdi Jusufit nga Vushtrria, i cili ndërroi jetë

në Qabënë e bekuar, ku kishte shkuar për ta kryer haxhin.

Myftiu Tërnavë me këtë rast tha se vdekjet si e haxhi Avdiut janë për t'u marrë lakmi, duke kujtuar kështu hadithin e Pejgamberit a.s., i cili ka thënë se në Ditën e Gjykimit, besimtarët e tillë do të ringjallen duke shprehur telbijen: “Lebejjke Allahume lebejjk – Të përgjigjem o Allah, të përgjigjem!”

“Ne si besimtarë jemi të bindur në caktimin e Zotit për momentin e dorëzimit të shpirtit. Prandaj edhe ne, bashkë me ju familjarët, kemi ndier

dhimbje e mërzi për vdekjen e familjarit tuaj. Lusim Zotin e Madhëruar që rahmetliun ta ketë marrë në mëshirën e Tij dhe që ta gradojë me Xhenetin Firdeus!” – tha ndër të tjera Myftiu Tërnavë.

Edhe familjarët e haxhi Avdiut falënderuan Myftiun Tërnavë për vizitën, si dhe udhëheqësit e Drejtorisë së Haxhit për trajtimin e veçantë që kanë pasur për babanë e tyre.

MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM HAFËZET RINETA DHE FATIME NITAJ

Më 5 qershor 2025, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, priti në takim mësueset e Akademisë së Kuranit “Hifdh Kids”, hafëzet Rineta dhe Fatime Nitaj.

Myftiu Tërnavë i uroi ato për certifikimin me ixahezet në dhjetë kiraetet e Kuranit fisnik me zinxhir transmetimi deri te Muhamedi a.s., duke i përgëzuar për punën që po bëjnë me nxënësit e “Hifdh Kids”.

Hafëzet falënderuan Myftiun për përkrahjen e vazhdueshme dhe shprehën përkushtimin për vazhdimin e mësimdhënies së Kuranit për fëmijët.

Ato janë certifikuar në kiraetet: Nafi el Medenij, Ibën Kethir el Medenij, Ebu Amër el Basrij, Ibën Amir esh Shamij, Asim el Kufij, Hamze el Kufij, Kisaij el Kufij, Ebu Xhafer el Medenij, Jakub el Basrij dhe Half el Ashir el Bezi, si dhe në mutunet: “Mutn esh Shatibijeh”, “Mutn ed Durrah el Mudijeh”, “El Mukadimeh el Xhezerijeh” dhe “Et Tuhfetu el Etfeli Wel



Gilmen”. Pas certifikimit, ato morën titullin “Shejha të dhjetë kiraeteve të Kuranit fisnik” nga Al Az’hari Sherif i Egjiptit.

BESIMTARËT MYSLIMANË FESTUAN KURBAN BAJRAMIN

Më 6 qershor 2025, besimtarët myslimanë në Kosovë dhe mbarë botën festuan festën e Kurban Bajramit. Manifestimi qendror u mbajt në Xhaminë e Madhe në Prishtinë.

Ceremonia e Kurban Bajramit filloi në orët e para të mëngjesit me faljen e namazit të sabahut. Më pas, u mbajt ligjërata tematike kushtuar festës nga dr. Besnik Llumnica. Namazit të Kurban Bajramit i priu Hetem ef. Sopjani, kryetar i Këshillit të Bashkësisë Islame të Prishtinës, ndërsa, hytben e Bajramit, me mesazhe paqeje dashurie, solidariteti, mirëkuptimi për njëri-tjetrin, e mbajti Myftiu i Kosovës, Naim ef. Tërnavë.

“Festa e Kurban Bajramit është ditë gëzimi, por edhe reflektimi. Është ditë kur rikujtojmë mëshirën e Zotit, faljen dhe begatinë që Ai na dhuron. Është ditë kur ne si besimtarë, por edhe si shoqëri, i kthejmë sytë edhe më shumë drejt njëri-tjetrit me dhembshuri, solidaritet dhe përgjegjësi. Kurban Bajrami është ditë e madhe, ditë adhurimi, sakrifice dhe solidariteti. Është kujtim i gjallë i sakrificës së madhe të pejgamberit Ibrahim a.s., i cili, me bindje të plotë ndaj urdhrat të Zotit, ishte i gatshëm që ta flijonte djalë të tij Ismailin a.s.”

Në mesazhin e hytbes së Kurban Bajramit nga Myftiu Tërnavë, ai foli edhe për rënien e natalitetit të Kosovës për siç tha ai për shkaqet të pasigurisë financiare.

“Në këto kohë, Kosova po përballë me një rënie serioze të natalitetit. Familjet e reja ngurren të lindin më shumë se një apo dy fëmijë për arsye të ndryshme, shpesh ekonomike, por



edhe për shkak të frikës dhe pasigurisë. Disa po migrojnë nga Kosova dhe vendet e tjera shqiptare, disa edhe në këtë kohë kur ne po flasim, në shtetet përreth nesh po asimilohen duke e humbur gjuhën shqipe si gjuhë të nënës, dhe ne kemi ngelur vetëm si spektatorë pasivë. Por le të kujtojmë se parimet e fesë sonë nxisin që ne të kemi familje të madhe dhe të mos frikësohemi për riskun e tyre, ngase atë e ka garantuar Krijuesi ynë.”

Festa e Kurban Bajramit vjen pas kryerjes së haxhit, si dhe shoqërohet edhe me therje të kurbanit nga besimtarët që kanë mundësi.

BIK HAP DYERT PËR URIME PËR FESTËN E KURBAN BAJRAMIT

Më 6 qershor 2025, me rastin e festës së Kurban Bajramit, në selinë qendrore të Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës u organizua pritja tradicionale, ku Myftiu i Kosovës Naim ef. Tërnavë me bashkëpunëtorë pritën mysafirë të shumte, të cilët erdhën për të uruar festën e Kurban Bajramit, e përmes tij për të uruar edhe gjithë besimtarët myslimanë.



Kryeminsitri në detyrë, z. Albin Kurti, bashkë me kabinetin qeveritar, në vizitë urimi te Myftiu i Kosovës, Naim ef. Tërnavë me rastin e Kurban-Bajramit



Anëtar i Kryesisë së PDK-së, z. Abelart Tahiri



Kryetari i LDK-së, z. Lumir Abdixhiku



Kryetari i AAK-së, z. Ramush Haradinaj



Sekretari i Kuvendit të Kosovës, z. Ismet Krasniqi



Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, z. Gazmend Hoxha



Ambasadori i OSBE-së në Kosovë, z. Gerard McGurk



Ambasadori i Turqisë në Kosovë, z. Sabri Tunç Angili



Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, z. Gazmend Hoxha

MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM DELEGACIONIN E KISHËS SË JEZU KRISHTIT TË SHENJTORËVE TË DITËVE TË MËVONSHME



Më 11 qershor 2025, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu i Kosovës, Naim ef. Tërnavë, ka prituri në takim një delegacion të Kishës së Jezut Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të

Mëvonshme, të kryesuar nga Elder Gerrit W. Gong, anëtar i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve të kësaj Kise. Gjatë këtij takimi u diskutua për rëndësinë e bashkëpunimit ndërfetar si

një mjet thelbësor për forcimin e mirëkuptimit, tolerancës dhe paqes në shoqëri. Myftiu Tërnavë theksoi se Kosova është

një shembull i bashkëjetesës ndërfetare dhe se institucionet fetare luajnë një rol të rëndësishëm në ruajtjen e harmonisë sociale dhe respektit të ndërsjellë.

Nga ana e tij, Elder Gerrit W. Gong, falënderoi Myftiun Tërnavë për mikpritjen dhe theksoi rëndësinë e dialogut dhe bashkëpunimit mes komuniteteve fetare për një të ardhme më të mirë për të gjithë.

MYFTIU I KOSOVËS VIZITON PANAIRIN E LIBRIT NË PRISHTINË

Më 12 qershor 2025, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, vizitoi Panairin e Librit në Prishtinë. Gjatë vizitës, ai ndaloi në stendën e Shtëpisë Botuese "Dituria Islame", ku u prezantuan botimet më të fundit me karakter fetar, kulturor dhe edukativ.

Më pas, Myftiu vizitoi edhe stendat e tjera të botuesve pjesëmarrës, duke zhvilluar biseda të frytshme me botues dhe autorë lidhur me rolin e librit në jetën shoqërore dhe fetare, sfidat që



përballon sot botimi i librit, si dhe rëndësinë e prezantimit dinjitoz të

trashëgimisë sonë kulturore dhe shpirtërore përmes fjalës së shkruar.

MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM NJË DELEGACION NGA KOMUNA OSMANGAZI E BURSËS

Më 18 qershor 2025, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka prituri në takim një delegacion nga komuna Osmangazi e Bursës, të kryesuar nga kryetari z. Erkan Aydin.

Gjatë këtij takimi u diskutua për format dhe mundësitë e thellimit të bashkëpunimit ndërmjet Bashkësisë Islame të Kosovës dhe komunës Osmangazi.

Myftiu Tërnavë shprehu falënderimet e tij për përkrahjen e vazhdueshme që ka dhënë shteti i Turqisë për Bashkësinë Islame të Kosovës. Ai shprehu gatishmërinë e tij dhe të institucionit të Bashkësisë Islame të Kosovës që të vazhdojë dhe të intensifikohet edhe më tej bashkëpunimi me komunën Osmangazi.



MYFTIU TËRNAVA VIZITOI PUNISHTEN NË NDËRTIMIN E XHAMISË NË SHKABAJ TË OBILIQIT

Më 18 qershor 2025, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka vizituar dhe ka parë nga afër punimet në ndërtimin e xhamisë në Shkabaj të Obiliqit.

Myftiu Tërnavë me këtë rast u nda i kënaqur me ecurinë dhe mbarëvajtjen e punimeve, duke shprehur kështu përkushtimin e Bashkësisë Islame të Kosovës për të krijuar kushte sa më të mira infrastrukturore për besimtarët tanë. Gurthemeli i kësaj xhamie është vënë të premten e datës 22 nëntor 2024.



MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM NËNKRYETARIN E FUSHË KOSOVËS, Z. BESNIK OSMANI

Më 20 qershor 2025, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Naim ef. Tërnavë, ka pritur në takim nënkryetarin e Fushë Kosovës, z. Besnik Osmani.

Gjatë këtij takimi u diskutua rreth bashkëpunimit të mirë që ka institucioni i Bashkësisë Islame të Kosovës, veçanërisht Këshilli i BI-së së Fushë Kosovës me Komunën, si dhe për format dhe mundësitë e intensifikimit dhe thellimit të këtij bashkëpunimi.

Myftiu Tërnavë ofroi mbështetjen e tij dhe të institucionit që ai drejton për



projektet që janë me interes për qytetarët e Fushë Kosovës, dhe të cilat

ndihmojnë në përmirësimin e kushteve për qytetarët e atjeshëm.

MYFTIU TËRNAVA VIZITOI INSTALACIONIN ME KRISTALE NË SHTËPINË E GAZETARËVE

Më 23 qershor 2025, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i shoqëruar nga bashkëpunëtorët e tij, ka vizituar instalacionin me kristale në Shtëpinë e Gazetarëve, i cili u mbajt me rastin e 100-vjetorit të minierave të Kosovës.

Në këtë instalacion u ekspozuan mbi 500 kristale të nxjerra nga thellësia e nëntokës, të cilat dëshmojnë për pasurinë e madhe që Zoti ia ka dhuruar këtij vendi. Ky instalacion është një homazh për mijëra minatorë të Trepçës dhe minierave të tjera, të cilët me mund, djersë dhe sakrificë mbajtën gjallë ekonominë, dinjitetin dhe shpresën e Kosovës.



FSHATI TORINË BËHET ME XHAMI TË RE

Më 29 qershor 2025, në fshatin Torinë të Lipjanit, me pjesëmarrjen e kryetarit të Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiut Naim ef. Tërnavë me bashkëpunëtorë, kryetarit të Lipjanit, z. Imri Ahmeti, udhëheqësve të Këshillit të BI-së së Lipjanit, donatorëve të xhamisë, imamëve lokalë dhe besimtarëve të shumtë nga fshati dhe rrethina, u bë solemnisht përrurimi i xhamisë së re. Ceremonia nisi me leximin e pjesëve nga Kurani fisnik, duke krijuar një atmosferë shpirtërore.

Në fjalën e tij, Myftiu Tërnavë uroi dhe përgëzoi banorët për hapjen e xhamisë, duke shprehur përkushtimin e institucionit të Bashkësisë Islame për të qenë gjithmonë pranë besimtarëve. Ai theksoi rëndësinë e xhamive si qendra të besimit, edukimit dhe bashkimit të komunitetit. Myftiu falënderoi edhe kryetarin e Lipjanit për bashkëpunimin dhe ndihmën në ndërtimin e xhamisë, si dhe adresoi falënderime të veçanta për donatorët nga Londra, duke lutur



Zotin që t'i shpërblejë me të mirat e Tij në këtë dhe botën tjetër.

Kryetari i Lipjanit, z. Imri Ahmeti, falënderoi Bashkësinë Islame për punën dhe kontributin e vazhdueshëm, duke theksuar se Torina do të jetë gjithmonë mirënjohëse ndaj tyre dhe donatorëve që mundësuan ndërtimin e xhamisë, e cila tashmë do t'i shërbejë komunitetit si vend adhurimi dhe tubimi.

Ndërkaq, kryetari i Këshillit të BI-së së Lipjanit, Zaim ef. Baftiu, tha se kjo xhami është e 35-ta në Lipjan, duke theksuar se numri i tyre po rritet vazhdimisht për shkak të shtimit të komunitetit dhe nevojave fetare. Ai njoftoi se së shpejti do të inaugurohet edhe xhamia e re në qendër të qytetit, me kapacitet më të madh dhe hapësira për aktivitete fetare dhe edukative.

SEKRETARI SADRIU PRITI NË TAKIM IMAMIN BUNJAMIN LIMANI

Më 23 qershor 2025, sekretari i Përgjithshëm i Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, Ahmet ef. Sadriu, së bashku me drejtorin e Diasporës në Kryesinë e BIK-ut, Ekrem ef. Simnicën, kanë pritur në takim imamin e xhamisë "Dituria" në Dyseldorf, Bunjamin ef. Limanin.

Gjatë këtij takimi u diskutua për format dhe mundësitë e thellimit të bashkëpunimit ndërmjet Bashkësisë Islame të Kosovës dhe qendrave dhe xhamive në diasporë, për çka nikoqirët shprehën gatishmërinë e tyre për të kontribuar në këtë drejtim.



Në fund të këtij takimi, drejtori Simnica, i dhuroi imamit Limani një

fletëfalënderim me rastin e dorëzimit të mjeteve për therjen e kurbaneve.

U MBAJT FORUMI I DYTË I PAQES NË BALLKAN

Më 15 qershor 2025, në Koper të Sllovenisë u mbajt Forumi i Dytë i Paqes në Ballkan, organizuar nga Konferenca e Ipeshkvijve Sllovenë (SŠK), me pjesëmarrjen e udhëheqësve

fetarë nga 15 vende të rajonit. Qëllimi ishte nxitja e dialogut ndërfaqet dhe forcimi i bashkëjetesës paqësore.

Ceremonia e hapjes në Sallën e Shën Françeskut mbledhi figura të larta të

jetës politike dhe shoqërore sllovene, si presidentja dr. Nataša Pirc Musar, ish-presidenti Borut Pahor dhe përfaqësues të trupit diplomatik. Presidentja Musar theksoi rolin e udhëheqësve fetarë në

ndërtimin e paqes dhe në përballimin e sfidave si rënia demografike, emigrimi i të rinjve dhe pabarazia sociale, duke vlerësuar kontributin e komuniteteve fetare për kapërcimin e ndarjeve politike e etnike.

Në Forum morën pjesë udhëheqës të kishave katolike, ortodokse dhe bashkësive islame nga Ballkani. Kosovën e përfaqësoi z. Besim Mehmeti, shef i kabinetit të Myftiut Naim ef. Tërnavë, i cili foli për modelin e bashkëjetesës ndërfetare në Kosovë dhe angazhimin e Bashkësisë Islame për promovimin e vlerave universale në nivel lokal dhe ndërkombëtar



PËRFUNDOI ME SUKSES THERJA DHE SHPËRNDARJA E MISHIT TË KURBANIT

Bashkësia Islame e Kosovës me sukses ka përfunduar therjen dhe shpërndarjen e kurbanit për këtë vit. Afro 19.000 kurbane janë therur dhe janë shpërndarë këtë vit te kategoritë e ndryshme të shoqërisë, duke filluar nga jetimët, rastet sociale, invalidët e luftës, familjet me gjendje të rëndë ekonomike, si dhe të moshuarit pa përkujdesje. Ky mish është shpërndarë përmes koordinatorëve të Shoqatës Humanitare Bamirëse “Bereqeti” anekënd Kosovës, teksa një pjesë e këtij mishi është dhuruar edhe për Medresenë “Alaudin” në Prishtinë, si dhe për paralelet e saj në Gjilan dhe Prizren, për të mbështetur ushqimin e nxënësve që ndjekin mësimet atje.

Me mishin e kurbanit furnizohen gjithashtu dy gjellëtoret humanitare të “Bereqetit” në Pejë dhe Mitrovicë, të cilat përgatisin çdo ditë ushqim të ngrohtë për afër 500 persona në nevojë, duke përfshirë të pastrehët dhe familjet me të ardhura të pakta. Ky mish i kurbanit po ashtu shfrytëzohet për organizime të ndryshme fetare dhe kombëtare, ku veç të tjerash përgatiten edhe iftare gjatë muajit të Ramazanit, si dhe në aktivitete të tjera humanitare e sociale që zhvillon Bashkësia Islame.

I gjithë procesi i therjeve të kurbaneve është monitoruar nga Komisioni i Bashkësisë Islame të Kosovës, për të garantuar që gjithçka të realizohet në mënyrë të rregullt dhe sipas normave fetare islame. Përveç saj, është monitoruar edhe nga certifikuesit “Hallall” të thertores, duke siguruar që standardet higjieno-sanitare dhe fetare të jenë të respektuara në çdo hap të procesit. Kjo traditë e therjes dhe shpërndarjes së kurbaneve ka një rëndësi të madhe shpirtërore dhe sociale, duke ndihmuar në përmirësimin e mirëqenies së shumë familjeve dhe individëve në nevojë në mbarë vendin.



FJALA

(REFLEKTIM MBI PESHËN E TË SHPREHURIT)

Fjala është fryma e shpirtit të zgjuar,
dridhje në telat e brendësisë, që lë gjurmë në kujtesën e
jetës,
vulë e padukshme e vetëdijes mbi faqet e kohës.
Është tingulli i qenies kur ajo guxon të dalë nga hijet e
mendimit e të vishet me kuptim.
Një zë që ngjitet prej thellësisë së ndërgjegjes dhe kërkon
të marrë formë në sipërfaqe.

Në atë që lë pas,
fjala është dritë ose hije,
çlirim ose shtrëngim,
jetë ose varr,
bekim që lulëzon,
ose mallkim që thërrmon.
Përmes saj u formësua vetë qenësia.

Fjala është një fije e mprehtë zëri:
ajo lidh ose ndan zemrat,
shpon heshtjet,
ndez dashuri ose nxit urrejtje,
bëhet urë që bashkon brigje të largëta,
ose humnerë që gëlltit gjithçka.

Parajsa fitohet me një fjalë;
ferri ndizet për një tjetër.
Fjala është mburojë e lirisë,
embleme e përgjegjësisë.

Kur njeriu flet,
nuk dëgjohe vetëm zëri,
por zbulohet pesha e shpirtit që ai bart.

Fjala krijon realitete,
formëson të vërteta,
lëndon ose shëron,
ngre ose rrënon.

Dhe në fund...
njeriu mbetet kujtim
në fjalët që ka thënë...
dhe në heshtjet që ka zgjedhur.

Fjala që thuhet – ruhet,
dhe, e mira nuk venitet,
por thellë rrënjohet
dhe në qiell ngjitet.

Valon Myrta

PËRULEM

*Në heshtjen që mbart shpirti im,
kur fjala s'ka më vend,
e zemra rrah si drithma e erës mbi ujë,
aty të kërkoj, Krijues i dritës.*

*Kam vetëm një mall që më dhe Ti Vetë,
një thirrje që s'ndalet, që s'ka nevojë për zë:
Kërkoj falje për çdo gjurmë mëkati
Kërkoj nga Ti...*

*Jo stoli, jo lavdi, jo ngjyra që veniten,
por bukurinë që lind nga e vërteta,
që s'ka frikë nga nata e as nga koha.
Një bukuri që është pranë edhe kur s'shoh asgjë.*

*Ti që nuk largohesh kur unë largohem,
Ti që rri edhe kur të harroj,
Ti që e kupton mallin tim më mirë se unë vetë –
më bëj të ndaloj së kërkuari jashtë
atë që vetëm pranë Teje mund të gjendet.*

*Përulem,
jo për të kërkuar më shumë,
por për të gjetur paqen në atë
që Ti tashmë më ke dhënë.*

*Përulem, sepse në Ty gjendet qetësia
që s'vjen nga heshtja, por nga pendimi
Në Ty, lutja bëhet prehje.
Në Ty, fjala shuhet për t'u bërë dritë.*

*Përulem !
Madhështi!
Me shpirti të hapur,
Pa asnjë kërkesë tjetër,
vetëm me nevojën për të ndjerë praninë Tëndë,
Përulem dhe lë çdo shqetësim të shkojë,
për të mbetur vetëm me Ty.*

*Në çdo frymë që marr, ndjej thirrje,
si rikujtim i një shtëpie ku ende s'kam qenë.
Në çdo dritë që përplas syrin tim,
Më rikujto se jam vetëm një udhëtar...*

*E unë vij, zbrazët nga botët që shuhen,
përplot me etjen që Ti Vetë e mbjelle,
Përlur do ngrysem Madhështi...
Si drithma e erës mbi ujë...*

Përlur me turp frikë e dashni!

Zejnije Shkodra

URIMI I MYFTIUT TË KOSOVËS, NAIM EF. TËRNAVA, ME RASTIN E VITIT TË RI HIXHRI 1447



Në emër të Bashkësisë Islame të Kosovës, të të gjitha institucioneve të saj dhe në emrin tim personal, me rastin e fillimit të Vitit të Ri Hixhri 1447, u shpreh urimet më të sinqerta të gjithë besimtarëve myslimanë në vendin tonë dhe në mbarë botën islame.

Fillimi i vitit të ri mysliman është kujtesë e një ngjarjeje madhore në historinë islame – Hixhretit të Pejgamberit Muhamedit a.s. nga Meka në Medinë. Ky udhëtim i bekuar nuk ishte vetëm një shpërngulje fizike, por një akt i thellë besimi, përkushtimi dhe sakrifice për hir të Allahut Fuqplotë.

Pejgamberi a.s. ka thënë: “Veprat vlejné sipas qëllimit, dhe çdo njeri do ta ketë shpërblimin sipas qëllimit të tij...”

Ky hadith na kujton se çdo hap dhe përpjekje jona merr vlerë nga sinqeriteti dhe drejtësia e qëllimit me të cilin e bëjmë.

Hixhreti mbetet një mësim i përhershëm për vlerën e durimit në sprova, për nevojën e vendimeve të mençura në kohë sfiduese dhe për ndërtimin e një shoqërie të bazuar në drejtësi, mëshirë dhe solidaritet.

Lusim Allahun e Madhëruar që ky vit të sjellë paqe, mirësi, shëndet dhe begati për të gjithë ne, pa dallim race, vendi apo përkatësie, dhe të jetë vit i përparimit shpirtëror, moral dhe shoqëror për mbarë njerëzimin.

Me hair, begati dhe harmoni Vit i Ri Hixhri!

*Me respekt,
Myftiu i Kosovës
Naim ef. Tërnavë*



□ Shtëpia Botuese “Dituria Islame” sjell titullin më të ri:

“Bazat e thirrjes islame - urtësia dhe mesatarja”, të autorit, Prof.Ass.Dr.Rexhep Suma.

Ky libër trajton themelet e urtësisë në thirrjen islame, rolin e Kuranit dhe Sunetit në ndërtimin e metodave të komunikimit me myslimanë dhe jomyslimanë, si dhe sfidat dhe mundësitë e përdorimit të mjeteve moderne në përhapjen e mesazhit të Islamit.

Librin mund ta siguroni në librarinë “Dituria Islame” në Prishtinë (<https://www.facebook.com/libriadiituriaislame>).

□

DITURIA ISLAME • Nr. 416 KORRIK 2025